
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti IV (XVIII) - Nr. 14 (167) ISSN: 2305-655X

SHKËNCIA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

14

2016

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI IV (XVIII) 2016 NR. 14 (167)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2016

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI IV (XVIII), janar, shkurt, mars 2016 nr. 14 (167)

Nën kujdesin e kryetarit të KMSH-së: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Ali Zaimi
Prof. dr. Ayhan Tekinesh
Prof. dr. Ferdinand Gjana
Prof. dr. Hajri Shehu
Prof. dr. Njazi Kazazi
Prof. dr. Qazim Qazimi
Prof. dr. Rahim Ombashi
Dr. Brikena Smajli
Dr. Fahredin Ebibi

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame
Tefsir
Hadith
Fikh
Sociologji
Filozofi
Gjuhësi
Letërsi
Psikologji
Histori
Kulturë
Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Xhamija e Gjin Aleksit, Delvinë

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. "George W. Bush", Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al
www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Një vështrim i përgjithshëm mbi besimin në jetën e përtejme,
Ali Zaimi, KMSH5
2. Qëndrimi i Ebu Hanifes gjatë zhvillimeve politike të kohës,
Dorian Demetja, KMSH21
3. Muhamedi a.s., shembull për t'u ndjekur,
Muhamed Sytari, Myftinia Shkodër28

Studime

4. Njolla në Biografi,
Fatos A. Kopliku MS/MA, Washington, DC, SHBA33

Letërsi

5. Poema “Erveheja” - botë e katërt që sublimoi mungesën e jetës shqiptare,
Prof. dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër54

Studime ndërfetare

6. Liria e besimit dhe dialogu ndërfetar në Shqipëri,
Vlash Plepi, Akademia Teologjike Orthodhokse, Durrës69

Shkenca Komunikimi

7. Imazhi i fesë islame në median shqiptare -
Qani Sulku74

Histori

8. Moderniteti dhe ideologjia në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane –
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë86
9. Roli i klerikëve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar,
Dr. Mois Kamberi96

Përkthime

10. Kur'ani, shpirti i umetit mysliman,
Prof. dr. Shahid Bushihi, Marok105

Personalitete

11. Hfz. Bajram ef. Agani, nismëtar dhe projektues i riorganizimit të Bashkësisë
Islame në Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore (1947-1951),
Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës115

12. Abstracts in English123

13. Rregullat e shkrimit129



Një vështrim i përgjithshëm mbi besimin në jetën e përtejme

Ali Zaimi

Abstrakt

Është gati e pamundur që njeriu, i cili nuk beson se do të japë llogari për ato çfarë kryen, ta ketë jetën të drejtë. Ndërsa jeta e njeriut që nuk e beq nga mendja se do të dalë një ditë përpara Allahut e do të japë llogari një më një, është e shoqëruar me vetëdijen e llogaridhënies dhe rrjedhimisht e drejtë. Natyrisht, njeriu do të jetë i tillë në raport edhe me vetëdijen për llogarinë përtej. Besimi se do të shpërblehet një ditë e motivon njeriun e mirë për punë; ideja e ndëshkimit për mëkatet e frenon të jetë dhunues e i shkujdesur; frika e llogaridhënies e frenon të bëjë keq edhe atje ku askush nuk mund ta shikojë; besimi se do të takohet përsëri në botën tjetër e ngushëllon një fëmijë që ka humbur një të afërm apo një të moshuar që është, si i thonë, me një këmbë në atë botë, etj.

Ajo, ringjallja në botën tjetër, është e vërtetë aq sa edhe kjo botë është e vërtetë.

Lajmi i parë është sihariq për të gjithë, për besimtarët, mohuesit, politeistët e zullumçarët. Pavarësisht nëse besojnë apo jo, të gjithë njerëzit do të ringjallen pas vdekjes, për të jetuar përjetësisht dhe kjo si pasqyrim i mëshirës së pafundme të Krijuesit, Rrahmanit (Gjithmëshirshmit), i Cili

ka hedhur krahët e mëshirës mbi gjithçka. Lajmi i dytë, që njerëzit do të gjykohen sipas veprave, është edhe i mirë edhe i keq. I mirë për besimtarët që do të shkojnë në Xhenetet e amshuara të Allahut, i Cili si Rrahim (Mëshirëbërës) që është, do t'i gostisë ata me lumturi të pafundme dhe i keq për mohuesit, politeistët e zullumçarët, që do të përballen me dënimin e merituar në jetën e përtejme.

Pas çdo rasti vdekjeje, ne, me vetëdije ose jo, mendojmë për pasvdekjen. Besimtarët besojnë që ka një jetë tjetër, sikurse kjo jetë, madje edhe më e kompletuar, ndërkohë që ateistët pretendojnë që me vdekjen mbaron gjithçka për njeriun. Po si e shikon besimi islam çështjen e ringjalljes dhe të jetës së përtejme?

Kreu dhe baza e Islamit është besimi i palëkundur tek Allahu i Madhëruar dhe tek e vërteta hyjnore. Pas besimit në një Zot të vetëm, ajo çka e rregullon jetën dhe e vendos atë në një regjim të caktuar për të siguruar qetësinë kolektive e të përgjithshme të njerëzimit, është pikërisht besimi në ringjallje dhe llogaridhënie në jetën pas vdekjes.

Besimi në jetën e përtejme është edukuesi më i mirë i rinisë, është shpresa më e madhe e fëmijëve, e pleqve, e të sëmurëve, është ngushëllimi i të dhunuarve dhe është frenuesi i zullumqarëve, i tiranëve e diktatorëve të mundshëm.

Është gati e pamundur që njeriu, i cili nuk beson se do të japë llogari për ato çfarë kryen, ta ketë jetën të drejtë. Ndërsa jeta e njeriut që nuk e heq nga mendja se do të dalë një ditë përpara Allahut e do të japë llogari një më një, është e shoqëruar me vetëdijen e llogaridhënies dhe rrjedhimisht e drejtë. Natyrisht, njeriu do të jetë i tillë në raport edhe me vetëdijen për llogarinë përtej. Besimi se do të shpërblehet një ditë e motivon njeriun e mirë për punë;

ideja e ndëshkimit për mëkatet e frenon të jetë dhunues e i shkujdesur; frika e llogaridhënies e frenon të bëjë keq edhe atje ku askush nuk mund ta shikojë; besimi se do të takohet përsëri në botën tjetër e ngushëllon një fëmijë që ka humbur një të afërm apo një të moshuar që është, si i thonë, me një këmbë në atë botë, etj.

Në terminologjinë islame Ahireti është jeta e dytë, që do të fillojë pas kiametit dhe do të vazhdojë pafundësisht, ku përfshihen të gjitha ngjarjet dhe etapat e quajtura ringjallja, grumbullimi, llogaridhënia, peshorja, ura, parajsja (xheneti) ose ferri (xhehenemi).

Në fakt, me vdekjen e njeriut, fillon për të ahireti i tij, i cili vazhdon pafundësisht. Sipas kësaj, ndërsa një pjesë e njerëzve jetojnë dimensionin jetësor të kësaj bote, një pjesë tjetër kanë hyrë dhe ndodhen në dimensionin jetësor të ahiretit.

Në këndvështrimin islam, jeta pa ringjalljen do të ishte e papërsosur dhe e padrejtë. Vetëm besimi në jetën e përtejme e mundëson perfeksionin përfundimtar dhe u jep përgjigje pyetjeve që aq shumë i preokupojnë mendjet e njerëzve që prej kohërave më të hershme e deri sot.

Vendbanimi i shpirtit pas ndarjes prej trupit dhe prej botës tokësore quhet *berzah*, që do të thotë ndërmjetësi, vend ndërmjet botëve. Në jetën e berzahut, shpirtat trajtohen sipas punëve që kanë bërë në këtë botë, nga ku kuptojnë

se ku do të shkojnë pas ringjalljes, vendbanim me trup dhe me shpirt.

Jeta e berzahut vazhdon deri në ardhjen e Ditës së Gjykimit, kur engjëlli Israfil i bie britit dhe njerëzit që të gjithë do të ringjallen dhe do të dalin nga varret. Shpirtrat do të bashkohen me trupat dhe njerëzit do të mblidhen në pritje të Gjyqit Suprem.

Myslimanët besojnë në Ditën e Gjykimit, kur do të vendosen peshoret, në të cilat do të peshohen veprat e njerëzve: “Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshore të drejta, e askujt nuk i bëhet asnjë padrejtësi”¹.

Ata që nuk e besuan Allahun dhe i bënë shok Atij, pas Gjyqit do të çohen në Xhehenem, ku do të zënë shkallë të ndryshme në varësi të peshës së mëkateve. Besimtarët do të shpihen në Xhenet, por që të mbërrijnë deri aty, do t’u duhet të kalojnë nëpër Urën (Sirat), që varet mbi greminën, poshtë së cilës ndodhet Xhehenemi e matanë së cilës ndodhet Xheneti. Ata që nuk i kanë bërë shok Allahut, por që kanë kryer mëkate, nuk mund të kalojnë dot nëpër këtë Urë, ata do të bien në Xhehenem, por nuk do të qëndrojnë aty përgjithmonë. Falë fisnikërisë së Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, këta do ta braktisin Xhehenemin dhe pas vuajtjes së dënimit do të hyjnë në Xhenet.

1. Enbija, 21: 47.

Mbështetur në Kur’an, koha se kur do të bëhet Gjykimi nuk dihet, atë e di vetëm Allahu, sepse një dije e tillë nuk është në fuqinë e krijesave. “Ty të pyesin për kiametin: “Kur do të ndodhë ai?” Po në çfarë gjendje je ti që t’ua përkujtosh atë? Vetëm te Zoti yt është dijenia për të”².

Disa arsytetime mbi ringjalljen dhe jetën e përtejme

Argumenti dhe garancia më e madhe mbi jetën e ahiretit është premtimi i Zotit për robërit e Vet. Duke theksuar në shumë vende se çdo frymë do të vdesë, nuk mund të shmanget vdekja, Allahu është ai që e jep vdekjen dhe se, në fund, kthimi do të jetë tek Ai, Kur’ani bën të ditur se ringjallja pas vdekjes është domosdoshmëri e premtimit të Allahut. Kështu çdokush që beson Allahun dhe Kur’anin si fjalë të Tij, i beson edhe ringjalljes pas vdekjes, sepse Zoti nuk ka asnjë mangësi që të mos e përmbushë dot premtimin.

“S’ka dyshim se ajo që u premtohet është e vërtetë e sigurt. Dhe se shpërblimi (gjykimi për vepra) do të ndodhë patjetër”³.

Ai që i jep njeriut ndjenjën e përjetësisë, padyshim që ka krijuar edhe një vend ku njeriu do të mbesë i përjetshëm. Ne shohim që Zoti ka dhënë urinë, por ka dërguar ushqime, ka dhënë etjen, por ka dërguar ujën, ka dhënë dëshirën e

2. Naziat, 42-44.

3. Dharijat, 51: 5-6.

fortë për përjetësi, e do ta japë edhe përjetësinë...

Zoti, që i jep përgjigje lutjes së çdo krijese, nga milingona tek elefanti, që me dhembshuri e bën nënën shërbyese të foshnjës së saj, a do ta linte pa përgjigje dëshirën për përjetësi të njeriut, që është më i vlerësuar në univers?!

Rezultati më i rëndësishëm i krijimit të universit është jeta. E vetë jeta nuk mund të përkufizohet vetëm te kjo jetë kalimtare, e shkurtër, e mangët dhe e mundimshme e kësaj bote. Ai që beson se Zoti është i Drejtë, i Mëshirshëm, i Gjithëpushtetshëm dhe i Gjithëditur, nuk mund ta pranojë se vdekja është asgjësim total për njeriun. Kjo është kundër drejtësisë, urtësisë e mëshirës hyjnore. Të mohosh ringjalljen, do të thotë t'i atribuosh Zotit dobësi, do të thotë të mohosh cilësitë dhe emrat e Tij.

Zoti në këtë botë, me gjithë ndarjen në klasën e të bindurve dhe kryengritësve ndaj normave të Tij, çdo njeriu i jep mirësi. Pra do të ketë një vend tjetër ku do të shpërblehen të bindurit e do të ndëshkohen kryengritësit, me qëllim që të përmbushet drejtësia hyjnore.

Shumë tiranë e diktatorë vazhdojnë tiraninë e tyre deri në vdekje, e madje disa edhe varrosen me ceremoni. Drejtësia dhe urtësia hyjnore kërkon që të ketë një vend ku ata të gjykohen siç e meritojnë.

Për çdo vlerë të kësaj bote e që ekziston në këtë botë, është vënë

një njësi llogaritëse, një kriter ose etalon që të mund ta masë. Por jo për mendjen, shpirtin, ndjenjën, arsyen dhe përfundimet e tyre. Ne nuk kemi në dorë ndonjë kriter që të mund ta masë produktin e mendjes. Për shembull, mendjet e mëdha si Shekspiri apo Hygoi, Imam Gazaliu apo Bediuzamani, nuk e kanë marrë dot në këtë botë produktin ose shpërblimin e mendjes së tyre. E le të mendojmë pastaj zgjuarsinë e një profeti. Për shembull, le të mendojmë produktet e mendjes dhe të ndjenjave transcendentale të profetit Muhamed (a.s.). Veçanërisht le të mbledhim bashkë ndjenjat e të gjithë profetëve dhe të kemi parasysh se për këta nuk është vënë ndonjë kriter apo peshore. Ky mendim dhe meditim do të na çojë në këtë përfundim: Do të vihet një peshore ku do të peshohen këto ndjenja. Po të mos bëhet këtu kjo, padyshim se do të bëhet në një botë tjetër.

“Ditën e kiametit, Ne do të ngremë peshoret e drejtësisë dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Njeriu do të marrë shpërblimin e punës së tij edhe sikur ajo të jetë sa një grimcë. Ne mjaftojmë si llogarimarrës!”²⁴

Njerëzit më të zgjedhur të Zotit, profetët, jetojnë në këtë botë mes brengave dhe vështirësive të mëdha. Drejtësia, Urtësia dhe Shenjtëria e Allahut kërkon të ketë një vend ku ata të vlerësohen e të shpërblehen.

4. Enbija, 21/47.

E pikërisht kjo është jeta e Ahiretit.

Pesë shtyllat e besimit, së bashku me të gjitha provat e tyre, tregojnë dhe bëjnë të domosdoshme ekzistencën e ringjalljes dhe të botës tjetër.

Kur Ubej bin Halef, këmbëngulës në mohim, duke i treguar Profetit tonë një kockë të thatë e pyet: “Këtë kush do ta ringjallë?” përgjigjen Profeti ia jep nga Kur’ani: “Kush i dha jetë në fillim, Ai do ta ringjallë.”

Zoti, që e krijoi njeriun nga hiçi, a pyetet se si do ta ringjallë pasi të dekompozohet e të shpërbëhet?!

Ndërkohë që Allahu ruan informacionin gjenetik të një peme të madhe në një farë të vogël, a mund të dyshohet se nuk i ruan dot shpirtat e trupat e atyre që vdesin?!

Ringjallja në Kur’an

Argumentimi më i shkëlqyer i jetës së përtejme është pikërisht argumentimi kur’anor. Gati një e treta e këtij libri hedh dritë mbi argumentet, specifikat dhe veçoritë e botës tjetër, duke na ftuar në besimin në të, por ndërkohë edhe duke na përgatitur për udhëtimin përtej. Zoti në Kur’an nuk është mjaftuar vetëm me njoftimin se, ringjallja pas vdekjes do të ndodhë patjetër. Ai ka sjellë argumente kategorike që e vërtetojnë ringjalljen pas vdekjes dhe grumbullimin (hashr), e duke i parashtruar argumentet në fjalë, ka dhënë shembuj të gjallë që hedhin poshtë kundërshtimet e mohuesve.

Le të japim vetëm disa shembuj:

“Ai që i ka krijuar qiejt dhe tokën, a nuk është i aftë t’i krijojë të ngjashmit e tyre? Sigurisht që është. Ai është Krijues i Gjithëditur.”⁵

“A krijimi juaj është i vështirë, apo krijimi i qiellit, të cilin Allahu e ka bërë dhe e ka ngritur?”⁶

A krijimi juaj është i vështirë, apo krijimi i të gjitha sistemeve, përfshi njerëzit dhe xhindet? Allahu që ka ngritur pallatin e gjithësisë, a nuk mundet të shpikë dhe të ngrejë për ju në parajsë pallate më të vegjël?

“Nga argumentet e Tij është edhe toka që ti e sheh të thatë, të plasaritur e të tkurrur. Por kur lëshojmë shi mbi të, ajo fillon të dridhet e të fryhet. Allahu që e ringjall atë, pa dyshim që i ringjall edhe të vdekurit. Ai ka mundësi për çdo gjë.”⁷

Ju e shihni tokën të tharë, të tkurrur, të mbaruar nga thatësira, e shihni si një njeri të përkulur me respekt para Allahut dhe i kërkon shpëtim. Pikërisht atëherë Allahu lëshon shi nga qielli dhe ajo fillon të gjallërohet. Farërat mbijnë dhe filizat e rinj nxjerrin kryet jashtë. Toka kthehet në blerim. Ja pra, Allahu që e ringjall tokën çdo pranverë, kështu do t’i ringjallë edhe të vdekurit. Allahu që ju tregon çdo pranverë ringjalljen e bimësisë, edhe të vdekurit do t’i ringjallë.

5. Jasin, 36/81.

6. Naziat, 79/27.

7. Fussilet, 41/39.

“O njerëz! Po qe se dyshoni në ringjalljen tuaj pas vdekjes, dini se Ne ju krijuam në fillim nga dheu, pastaj nga sperma, pastaj nga embrioni, pastaj nga një copë mishi pa formë që t’ju tregojmë haptas fuqinë tonë. Sipas dëshirës sonë, ju mbajmë një kohë në mitrën e nënës, pastaj ju nxjerrim që atje si foshnjë. Pastaj ju rrisim që të bëheni të fortë e të aftë. Pastaj dikush vdes duke qenë ende fëmijë, kurse dikush rron gjer në pleqëri të thellë kur të mos dijë e të mos kuptojë asgjë (duke u kthyer përsëri në gjendjen fëminore kur s’dinte asgjë). E shihni edhe tokën se si është tharë e ka vdekur. Por kur i lëshojmë ujë sipër, lëviz, dridhet, fryhet dhe prej saj mbijnë çifte bimësh nga të gjitha llojet!”⁸

Me anë të këtyre ajeteve, Allahu na paraqet së pari shenjat e vdekjes e të ringjalljes në tokë dhe sikurse i ringjall në pranverë farat e rëna përdhe dhe të mbetura ashtu gjatë dimrit të gjatë të vdekjes, ashtu do t’i ringjallë edhe njerëzit në pranverën e dytë të tyre.

Parë nga ky këndvështrim, edhe sikur çështja të trajtohet nga një shkencëtar apo filozof, edhe nga një çoban apo bujk, nuk mund të bëhet më e qartë se sa ç’bëhet me këtë metodë bindëse të Kur’anit. Përfshi edhe hadithet e profetit Muhamed a.s. lidhur me këtë çështje, të gjitha ç’janë thënë, janë shtjellime dhe komente të thënieve të Kur’anit.

8. Haxh, 22/5.

Duke e provuar ringjalljen e madhe me argumente subjektive dhe duke na i kthyer shikimet në botën subjektive, Kur’ani i përfiton çështjes qartësi me këta shembuj:

“Siç ju krijoi në fillim, përsëri tek Ai do të ktheheni!”⁹

Ashtu siç ju krijoi në fillim nga dheu, nga sperma, nga gjaku i mpiksuar dhe nga një copë mishi pa formë, përsëri, do t’i mbledhë atomet tuaja thelbësore, do të bëjë një sintezë dhe do t’ju krijojë nga e para.

“A nuk e di njeriu se e kemi krijuar nga një spermë që tani na u bë armik i hapur? Dhe, duke e harruar krijimin e vet, na paraqiti Ne argument: “Kush do t’i ringjallë këto eshtra të kalbura?” Thuaju: “Do t’i ringjallë Ai që i krijoi për herë të parë. Ai njeh çdo lloj krijimi.”¹⁰

Edhe mohuesi i shekullit të parë, edhe mohuesi i fundit i shekullit të njëzetën thonë të njëjtën gjë: “Kush do t’i ringjallë këto eshtra të kalbura të bëra hi?”

Kur’ani u përgjigjet atyre kështu: “Kush ta ketë dhënë jetën në fillim, Ai do t’i ringjallë!”

Me të njëjtën metodë, Kur’ani e vërteton ringjalljen duke na shfaqur para syve edhe mikrobotën e përbërë prej atomeve dhe grimcave më të vogla:

“O njerëz! Po qe se dyshoni në ringjalljen tuaj pas vdekjes, dini se ne ju krijuam ju në fillim nga

9. Araf, 7/29.

10. Jasin, 36/77-99.

dheu, pastaj nga sperma, pastaj nga embrioni, pastaj nga një copë mishi pa formë që t'jua tregojmë haptas fuqinë tonë. Sipas dëshirës sonë, ju mbajmë një kohë në mitrën e nënës, pastaj ju nxjerrim që atje si foshnjë. Pastaj ju rrisim që të bëheni të fortë e të aftë. Pastaj dikush vdes duke qenë ende fëmijë, kurse dikush rron gjer në pleqëri të thellë kur të mos dijë e të mos kuptojë asgjë (duke u kthyer përsëri në gjendjen fëminore kur s'dinte asgjë). E shihni edhe tokën se si është tharë e ka vdekur. Por kur i lëshojmë ujë sipër, lëviz, dridhet, fryhet dhe prej saj mbijnë çifte bimësh nga të gjitha llojet!”¹¹

Po qe se keni dyshim në ringjalljen, vëzhgoni dukurinë që ndodh në natyrën tuaj dhe analizoni këtë argument. Në fillim, Allahu (xh.xh.) ju krijoi nga dheu. Përbërja juaj thelbësore është prej një sere elementesh të marra nga sipërfaqja e tokës. Pastaj elementët janë përzierë dhe prej tyre është formuar një ekstrakt proteinik. Një shkallë më tej, domethënë në nivelin e gjallesës, përbërja juaj ose ekstrakti proteinik u bë një pikë uji. Pastaj, një droçkë gjaku dhe, më tej, një copë mishi me formë a pa formë. Pasi arrin në këtë gjendje, njeriu ose krijohet, ose nuk krijohet; ose dështon, ose zhvillohet më tej sipas farës që ndodhet në përbërjen e tij për t'u bërë një qenie e përsosur e quajtur njeri. Pastaj Zoti e mban në mitër të nënës sa të

11. Haxh, 22/5.

dojë dhe ose dështon disa ditësh ose muajsh, ose lind gjashtë, shtatë ose nëntë muajsh.

Dhe ju, që ju sollli në gjendjen e një fëmije të njomë, pastaj përpiqeni të rriteni e të bëheni të aftë gjer në një pikë të caktuar. Dikush nga ju vdes pa u pjekur, kurse disa të tjerë nga ju arrijnë gjer në pleqëri të vonë. Mund të liheni në jetë gjersa t'ju thyhet mes, të mos ju mbajnë dot këmbët e koka t'ju bjerë në gjoks, gjersa t'ju thinjen flokët dhe të plakeni aq shumë, sa, pas gjithë atyre që ju kanë ndodhur në jetë, të mos mbani mend asgjë. Kështu, e filloni jetën si fëmijë dhe, më në fund, po si fëmijë, por mjekërbardhë, ikni e mërgoni nga kjo botë.

Apelin e pabërë në këtë botë të të mirëve dhe të të këqijve, do ta bëjë në anën tjetër Allahu, i Drejti Absolut, që do t'u drejtohet kështu grupit të të këqijve dhe mizorëve:

“Veçohuni sot o ju fajtorë!”¹²

Ja, kjo ndarje dhe ky apel nuk bëhet praktikisht në këtë botë. Mirëpo mes të gjitha llojeve të tjera të materies, i miri dallohet nga i keqi, i përsosuri nga i mangëti qysh në këtë botë. Ndërkaq, nuk mund të mendohet që qenia më e përsosur, më e mrekullueshme e gjithësisë dhe esenca e saj, njeriu, të përjashtohet nga rregulli. Meqë ndarja, dallimi dhe apeli për njeriun nuk bëhen këtu, do të thotë se do të bëhen në një botë tjetër.

12. Jasin, 36/59.

Në lidhje me çështjen e ringjalljes, mohuesit e quajnë të pamundur, duke thënë kështu: “Le ta pranojmë mundësinë e një jete të re vegetative pas vdekjes; si do të mund të fillojë jeta jonë njerëzore pasi të na jenë prerë lidhjet e ndjenjave dhe vetëdijes me trupin?” Përballë këtij kundërshtimi të mohuesve, Kur’ani ka kujtuar gjumin, një përvojë të përditshme. Gjendjet e gjumit dhe zgjimit që ndjekin njëra-tjetrën, përbëjnë për ne një shembull të bukur për çështjen e jetës pas vdekjes. Për vërtetimin e ringjalljes nuk kërkohet një forcë bindëse më tepër se kaq. Në Kur’an thuhet kështu:

“Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t’ju njoftojë gjithçka që keni bërë.”¹³

Allahu jua kompenson dhe rinovon në gjumë, pa e ditur ju, pjesët e trupit që ju janë dëmtuar ose që ju kanë vdekur dhe, duke jua kthyer përsëri në mëngjes vetëdijen dhe aftësinë njohëse që jua pati marrë, ju ringjall dhe ju zgjon me jetën tuaj materiale e shpirtërore të mëparshme. Vetëm atëherë ju i dalloni ditën dhe natën, i njihni vetët dhe arritjet tuaja sikur të mos i kishit humbur fare, sikur të mos kishte ndodhur asnjë ndërprerje. Të dyja jetët materiale-shpirtërore që ka

13. Ena’m, 6/60.

njeriu, ndodhen çdo ditë e çdo natë, madje, çdo çast në një “ringjallje” të tillë materiale-shpirtërore. Edhe nëse shumë njerëz e pranojnë këtë si një ringjallje me kuptim të figurshëm, po që se çështja shihet seriozisht me një sy shkencor, del në shesh se kjo është një ringjallje me kuptimin e vërtetë të fjalës.

Këto ajete shpjegojnë ngjasimin mes vdekjes dhe ringjalljes, domethënë, ngjasimin mes zgjimit nga gjumi dhe ringjalljes pas vdekjes. Gjumi është një vdekje e lehtë dhe e vogël, kurse vdekja, një gjumë i madh dhe i rëndë. Në të dyja gjendjet ndodh kalimi i shpirtit të njeriut nga një jetë në një jetë tjetër.

Ngjashmëria mes rënies në gjumë-zgjimit dhe vdekje-ringjalljes është theksuar edhe në hadithet profetike. Për shembull, në një deklaratë profetike është dhënë kjo porosi: “Kur të bini për të fjetur, thoni “Allahu im, me emrin Tënd vdes dhe ringjalle.” dhe, kur të ngriheni nga gjumi, thoni “Lavdi Allahut që na ringjall pas vdekjes.”

Allahu i Lartë, Krijuesi i ngjarjes së gjumit dhe zgjimit, edhe me anë të realitetit të “ëndrës”, e cila ndodh mes këtyre dy gjendjeve, u hap mendimeve tona një horizont të veçantë për shpërndarjen e dyshimeve mbi këtë çështje. Duke na i hequr ndjenjat nga një botë për të na i lidhur me zërat dhe ngjyrat e një bote tjetër e për të na shëtitur në të, i tregon njeriut, duke e bërë t’i jetojë

personalisht, ekzistencën edhe të botëve të tjera të ndryshme nga kjo botë. Njeriu, i cili kridhet çdo natë në gjumin, që është një “vëlla” i vogël i vdekjes, dhe i cili çdo mëngjes hap sytë në këtë botë sikur të ringjallej, do të thotë se i vëzhgon çdo ditë shenjat e kiametit dhe ringjalljes.

Nuk mund të mendohet që Allahu t'i lërë pa shpërblyer aktet e robërve të Tij të mirë, sepse kjo do të thotë shfaqje e një situatë që s'përputhet me urtësinë e Tij:

“A ka shpërblim tjetër për të mirën, veç të mirës?”¹⁴

Gjithashtu, me këtë rast, në suren Murselat, Allahu i Lartë e ka deklaruar kështu faktin se atyre që e kanë kryer detyrën e robit ndaj Zotit, sipas qëllimit dhe orientimit të krijimit, do t'u jepet xheneti me të gjitha të mirat dhe bukuritë e tij si shpërblim për sjelljen e tyre:

“Kështu i shpërblejmë Ne ata që bëjnë vepra të mira...”¹⁵

Kështu mund të themi se jeta e ahiretit do të ndodhë patjetër, së pari si një mirësi hyjnore, e më pas, si shpërblim i adhurimit të kryer nga njeriu dhe marrje prej tij e vlerës së vërtetë të akteve dhe veprimeve të tij, ashtu dhe si realizim i qëllimeve dhe synimeve të krijimit.

“Atë Ditë, njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre!”¹⁶

14. Rrahman, 55/60.

15. Murselat, 77/44.

16. Zelzele, 99/6.

Kur'ani, i cili na e vë në lëvizje mendimin/arsyetimin, duke na e tërhequr vështrimin në rregullin e pashoq që sundon në gjithësi dhe përsosmërinë që shfaqet në të, na e bën të ditur se çdo pjesë e ekzistencës është e krijuar mbi një të vërtetë, gjithashtu, se krijimi dhe ngritja mbi të vërtetën të bën të mendosh e të besosh mbi ekzistencën e një jete të re pas vdekjes. Kjo specifikë të cilës një ajet i jep përparësi, shprehet kështu në të:

“Allahu është Ai që qiejt i ka ngritur me shtylla, të cilat nuk mund t'i shihni e më pas është ngritur mbi Fron. Ai ka nënshtruar Diellin dhe Hënën; të gjitha këto rrotullohen gjer në një kohë të caktuar. Ja, kështu i tregon Ai provat e Tij!”¹⁷

Ndërkaq, ne shohim se kjo botë është e paqëndrueshme, e ndryshueshme dhe kalimtare. Hyjniteti i shkëlqyer dhe i përjetshëm i Allahut të Lartë, Zotit të botëve, sundimi madhështor dhe gjithëpërfshirës i Tij nuk mund të ngrihet e të qëndrojë mbi një botë të tillë. Domethënë se duhet një botë tjetër e përhershme, e qëndrueshme, e pashkatërrueshme, e përsosur dhe e shkëlqyer, që të jetë e denjë për Të. Prandaj themi se Allahu i Lartë ka një vend tjetër të përhershëm dhe për të e vë në punë njeriun.

Si përfundim, nuk mund të mendohet që kjo botë, e cila nuk

17. Rad, 13/2.

e kënaq dhe nuk e ngop njeriun as me aspektin e saj material, t'u japë përgjigje kapaciteteve dhe mundësive të tij që e përfshijnë gjithësinë, siç është imagjinata dhe dëshira e përjetësisë. Prandaj, njeriu që nuk e gjen përgjigjen e kësaj ndjenje në këtë botë, do ta gjejë në një botë tjetër.

Etapat e Jetës së Ahiretit

Jeta pas vdekjes do të realizohet në dy faza. E shprehur ndryshe, pas vdekjes, njeriu do të kalojë nëpër dy botë. E para, bota e varrit, e cila, si kjo botë, do të marrë fund; ndërsa tjetra është bota e ahiretit, e cila nuk do të marrë fund në asnjë formë.

Pas kiametit, ringjalljes dhe grumbullimit në fushën e quajtur mahsher, njerëzve u shpërndahen "librat e punëve" ku janë shënuar të gjitha punët që kanë bërë dhe fjalët që kanë thënë para se të vdisnin. Këta libra, cilësia e të cilëve nuk na bëhet e ditur, shpjegohen kështu në Kur'an:

"Dhe Libri (i veprave të tyre) do t'u vihet përpara, e do t'i shohësh gjynahqarët se si do të tmerrohen nga ato që gjenden në të dhe do të thonë: "Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar?" Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt."¹⁸

Kur'ani bën të ditur se librat e punëve do t'u jepen njerëzve të caktuar për në xhenet nga e djathta, 18. Kehf, 18/49.

ndërsa njerëzve të caktuar për në xhehenem nga e majta ose nga pas.

Pas shpërndarjes së librave fillon procesi i llogaridhënies. Në vendin e grumbullimit (mahsher), njerëzit do t'i japin llogari Allahut pa ndërmjetës. Në hadithet profetike bëhet e ditur se ndërsa besimtarët do t'u përgjigjen pyetjeve me lehtësi, mohuesit do të kalohen përmes një hetimi dhe llogarimarrjeje të imët.

Gjatë hetimit dhe llogaridhënies, përveç librit të punëve, po të duhet, për njerëzit do të dëshmojnë edhe organet e trupit të tyre, edhe toka. Gjatë llogaridhënies ku ai që ka bërë të mirë qoftë edhe sa grimca, do ta marrë shpërblimin e të mirës së tij, dhe kur ai që ka bërë të keqe qoftë edhe sa grimca, do ta marrë ndëshkimin e të keqes së tij, njerëzit nuk do të lihen pa u përgjigjur për këto pesë gjëra: Ku e kanë shpenzuar jetën? Si e kanë kaluar rininë? Në ç'rugë e kanë përdorur diturinë dhe si kanë vepruar me të? Ku e kanë fituar dhe ku e kanë shpenzuar pasurinë? Ku e kanë përdorur dhe konsumuar trupin?

Pas llogaridhënies veprat e njerëzve peshohen në mijzan (peshore) cilësinë e të cilit e di vetëm Allahu. Në këtë peshim të imët të veprave, ata që do t'u rëndojnë më shumë të mirat, do të shpëtojnë, kurse ata, të mirat e të cilëve do të vijnë lehtë, do të shkojnë në xhehenem. Lidhur me peshoren, në Kur'an thuhet:

“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa peshë e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje!”¹⁹

Më pas vjen Sirati. Sirati është një urë mbi xhehenem ku do të kalojë gjithkush dhe ata që s’do të mundën të kalojnë, do të bien në xhehenem. Megjithëse nuk dimë shumë mbi cilësinë e siratit, në hadithet profetike njoftohet se ata që do të kalojnë të parët mbi sirat do të jenë Profeti Muhamed (a.s.) dhe umeti, bashkësia e tij, dhe gjatë këtij kalimi, njerëzit do të kenë vështirësi apo lehtësi sipas punëve të tyre në këtë botë.

Këtë urë mjaft të lehtë për t’u kaluar nga besimtarët dhe ata që kanë bërë punë të mira, por mjaft të vështirë për t’u kaluar nga mohuesit dhe mëkatarët, mund ta interpretojmë edhe si “urë të ndërtuar nga njeriu gjatë gjithë jetës së tij në këtë botë me anë të punëve të tij të mira apo të këqija”. Punët e këtushme të njeriut i vihen para atij si një urë. Duke u nisur nga kjo konsideratë, ndërsa punët e mira do të kryejnë funksionin e një ure të shëndoshë që ka për ta nxjerrë atë në bregun e shpëtimit (xhenet), punët e këqija do të kryejnë funksionin e një ure të kalbur që do të bëhet shkak për rrëzimin e tij në xhehenem. Të

19. Enbija, 21/47.

vërtetën vetëm Allahu e di.

Në ditën e kiametit, çdo Profeti do t’i përkasë një hauz. Ndërkaq, uji i hauzit që do t’i jepet Profetit Muhamed (a.s.), do ta ketë ngjyrën më të bardhë se qumështi dhe aromën më të këndshme se parfumi. Kush do të pijë prej tij, nuk do të ketë më etje kurrë. Profeti Muhamed (a.s.) do të jetë i pari, i cili në ditën e kiametit, do të pijë ujë në këtë lumë, pastaj, me radhë, besimtarët që janë përpjekur në rrugën e Allahut dhe që i kanë shërbyer Islamit.

Fjala “*keuther*” që përmendet në Kur’an në ajetin e parë të sures Keuther, ku thuhet: “Pa dyshim, Ne të dhamë ty Keutherin”²⁰, në librat e tefsirit është komentuar, përgjithësisht, si lumë. Prandaj, për lumin e Profetit (a.s.) në kiamet është thënë “Lumi Keuther”.

Një tjetër ngjarje e madhe që vijon në ditën e ringjalljes është çështja e shefaatit (ndërmjetësimit). Fjala “*shefaat*” në terminologjinë fetare shpreh shfaqjen e mëshirës së Allahut në një dimension tjetër përmes përdorimit prej Tij, si pretekst, të Profetëve, dijetarëve, dëshmorëve dhe besimtarëve sipas gradës së tyre për faljen në jetën e pasme të mëkateve të besimtarëve mëkatarë dhe për lartësimin në gradë të besimtarëve jomëkatarë.

“Atë ditë nuk do të bëjë dobi shefaati (ndërmjetësimi) i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i

20. Keuther, 108/1.

jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala!” Ky ajet tregon se shefaati përmendet në Kur’an.

Ajetet e Kur’anit lidhur me shefaatin thonë se “nga askush s’do të pranohet ndërmjetësim”, nuk mund të paraqiten si argumente se nuk do të ketë ndërmjetësim për falje, sepse këto ajete sillen në ato vende të Kur’anit ku bëhet fjalë për fundin e mohuesve. Me këtë theksohet se mohuesit (qafirët), politeistët (mushrikët) dhe hipokritët (munafikët) mbeten jashtë shefaatit, ndërmjetësimit për falje.

Në një hadith, Profeti (a.s.) ka thënë se do të ndërmjetësojë për faljen e atyre personave nga bashkësia e tij që kanë bërë mëkate, ndërsa në një hadith tjetër ka bërë të ditur se për çdo profet ka një lutje të posaçme që i pranohet, kurse lutjen e tij ai do ta bëjë në ahiret për të ndërhyrë për falje për umetin e vet. Gjithashtu, në një hadith tjetër, Profeti (a.s.) ka thënë se, ndërsa në Mahsher njerëzit do të jenë duke pritur të vuajtur e të emocionuar që të merren në pyetje, ai do t’i lutet Allahut që gjykimi dhe llogaridhënia të mbarojnë një çast e më parë.

Nisur nga kjo, ajo që i bie si detyrë njeriut për të merituar një shefaat të tillë, është të jetë i vëmendshëm në kryerjen e detyrimeve të kërkuara nga Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe, duke pasur frikë nga ndëshkimi i Allahut, t’i kërkojë ndihmë Atij!

Xheneti, Xhehenemi dhe Araf

Xheneti dhe Xhehenemi janë dy përfundime të rëndësishme. Emrat dhe atributet e Zotit i bëjnë të dyja të nevojshme e të domosdoshme. Për besimtarët, edhe Xheneti, edhe Xhehenemi, në njëfarë mënyre, janë mëshirë. Në suren Rrahman thuhet:

“Mbi të dy dërgohet flakë zjarri e përhapur dhe një tym krejt i kuq (ose bakër i shkrirë), kurse ju nuk mundeni ta mbronni veten. Dhe, tani cilën nga të mirat e Zotit tuaj e mohoni?”²¹

Fjala xhenet terminologjikisht mbart emërtimin e vendit të shpërblimit të jetës tjetër, të pajisur me të mira e dhunti të papritura, ku besimtarët do të mbeten përjetësisht.

Xheneti dhe jeta në të janë të pafund. Besimtarët nuk do të ndjejnë aty asnjë mërzi apo të velen nga mirësitë pa fund, sepse xheneti është vend i të mrekullive. Ata që do ta meritojnë këtë jetë, do të zhvishen nga ndjenjat negative si urrejtja, neveria dhe mërzitja, të ngulitura në krijimin e tyre tokësor mbështetur mbi disa urtësi të caktuara.

Për shembull, specifika e pastrimit të zemrës nga urrejtja shprehet kështu në Kur’an: “Në xhenet, ndërsa nën ta do të rrjedhin lumenj, Ne do t’ua shkulim prej zemre tërë urrejtjen!”²² Kështu, ata do ta jetojnë çdo çast në lumturi dhe hare.

21. Rrahman, 55/35, 36.

22. Araf, 7/43.

Krahas përshkrimeve të ajeteve të Kur'anit, që tërheqin vëmendjen me shumë veçori të xhenetit, edhe kjo shprehje e Profetit (a.s.) lidhur me xhenetin është një sihariq mjaft emocionues për ata që e besojnë: "Allahu urdhëron: "Për robërit e mi të mirë, Unë kam përgatitur gjëra që nuk i kanë parë sytë, që nuk i kanë dëgjuar veshët dhe që e kapërcejnë përfytyrimin e njeriut!"

Po qe se do ta shprehnim me një fjali të shkurtër, Xheneti është vendi i të papriturave dhe shfaqje e mëshirës dhe favorit të pakufishëm të Allahut për robërit e Tij. Nisur nga kjo, asnjë njeri nuk mundet ta fitojë të drejtën për aty me punën e vet. Pra, punët e bëra nga njeriu kurrë nuk mjaftojnë për ta fituar xhenetin. Për më tepër, adhurimet e një njeriu jo vetëm s'mjaftojnë për xhenetin, por s'mjaftojnë as për t'iu përgjigjur një të mjtës së mirësive dhe dhuntive që ia jep Allahu në këtë botë.

Në një hadith profetik tërhiqet vëmendja mbi këtë specifkë në këtë mënyrë:

"Kur i Dërguari i Allahut tha se "asnjë punë e njeriut nuk mund ta bëjë atë që të hyjë në xhenet", sahabet e pyetën: "A edhe puna jote s'të fut dot ty në xhenet, o i Dërguari i Allahut?" Atëherë, i Dërguari i Allahut iu përgjigj: "Po të mos ishte mëshira dhe falja gjithëpërfshirëse e Allahut, as puna ime mua!"

Dhuntia dhe lumturia më e madhe që mund të meritojnë ata që

ndodhen në xhenet, do të jetë kur Allahu t'ua tregojë veten atyre. Këtë situatë, Allahu (xh.xh.) e lajmëron personalisht vetë: "Ka fytyra që atë ditë do të vezullojnë plot dritë dhe do ta shikojnë Zotin e tyre!"²³ Kurse në një transmetim autentik që e mbështet domosdoshmërinë e kuptimit në këtë mënyrë të këtij ajeti, Profeti (a.s.) thotë: "Pa dyshim, siç e shihni këtë hënë, do ta shihni edhe Zotin tuaj si dhe nuk do ta dëmtoni njëri-tjetrin për shkak të grumbullimit të madh aty!"

Në fakt, kjo shprehje ka për qëllim të mënjanojë, me anë të një përgjigjeje të prerë, ndonjë dyshim mbi çështjen e shikimit të Allahut, pra, është një shprehje që thekson se Allahu do të shihet patjetër, por nuk ka kuptimin se njerëzit do ta shohin/perceptojnë Individualitetin Hyjnor të Allahut siç është. Një mendim të tillë nuk e lejon as ajeti që thotë se "shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë, kurse Ai i përfshin shikimet"²⁴, sepse krijesa kurrë nuk mund ta përfshijë Krijuesin. Në këto kushte, çdo besimtar në xhenet do ta shohë Allahun - në një mënyrë të panjohur për ne - në atë masë sa ç'e ka zhvilluar besimin dhe afrimin ndaj Allahut në këtë botë. Sipas kësaj, shikimi i Allahut nga një besimtar kushdo do të jetë i ndryshëm nga shikimi i Allahut prej Profetëve.

23. Kijame, 75/22-23.

24. En'am, 6/103.

Xhehenemi

Me fjalën xhehenem terminologjikisht kuptohet vendi i ndëshkimit në jetën e pasme, ahiret, ku mohuesit do të mbeten përgjithmonë, kurse besimtarët mëkatarë do të qëndrojnë sa të lajnë mëkatet që kanë bërë.

Në Kur'an, për të tërhequr vëmendjen për aspekte të ndryshme të xhehenemit, ai është përmendur me emërtime të ndryshme, si nar (zjarr), xhehim (zjarr me shtresa, një shtresë e xhehenemit), havije (vendi më i frikshëm, shtresa e shtatë e xhehenemit), sair (flakë, shtresa e dytë e xhehenemit), ledha (zjarr, shtresa e gjashtë e xhehenemit), sakar (ferr) dhe hutame (shtresa e pestë e xhehenemit). Ky ndëshkim do t'i rrethojë përjetësisht ata që e kanë mohuar Allahun me vetëdije. Kurse besimtarët mëkatarë nuk do të qëndrojnë aty përjetësisht, por, pasi ta vuajnë dënimin, do të vendosen në xhenet.

Në këtë mes, në mendje mund të vijë një mendim i tillë: Ndëshkimi me një vuajtje të përjetshme i mohimeve dhe kundërshtimeve të kufizuara në një jetë të kufizuar nuk mund të shpjegohet me drejtësinë dhe mëshirën e Allahut.

Është një e vërtetë e njohur se çdo qenie ose krijesë ka një vlerë të madhe të fituar në sajë të Krijuesit. Çdo gjë, si një vepër arti e pashoqe e Allahut, i shpall pa pushim me gjuhën e vet të posaçme ekzistencën,

unitetin dhe emrat e bukur të Allahut. Ja pra, njeriu i cili e ka bërë profesion mohimin, i zbret nga pozita e lartë këto qenie-nëpunës (të ngarkuar me detyrë) të Allahut dhe i rrëzon në një gradë pa detyrë e pa kuptim. Ndërsa çdo qenie ekzistente thotë me gjuhën e saj: "Allahu ekziston, është një, është Zoti i çdo gjëje, kurse ne jemi nëpunës të ngarkuar me detyrë të Tij që lëvizim e veprojmë me urdhrin, lejen dhe fuqinë e Tij, jemi letra të shkruara që shprehin kuptime të gjera e që bartin mesazhe të gjera", mohuesi (qafiri), duke e mohuar një të vërtetë të tillë, kryen një faj të tmerrshëm.

Edhe pse një fyerje e tillë mund të ndodhë brenda një kohe të kufizuar, meqë rezultati i saj është një krim i madh, edhe dënimin dhe ndëshkimin e ka të këtyre përmasave. Për shembull, dënimi i dikujt që, duke e shkelur këmbëzën e armës vetëm dy sekonda, vret dy njerëz, nuk është një ndëshkim prej vetëm dy sekondash, por që zgjat një jetë të tërë. Kurse faji i mohuesit është një mijë herë më i tmerrshëm se krimi i vrasjes, sepse me mohimin e tij ai kryen krimin e asgjësimit të kuptimeve dhe mesazheve të përfaqësuar dhe të shpallura nga qenie të panumërta. Shkurt, meqë çdo mohim i mohuesit është mohim i një të vërtete të përjetshme, do të rezultojë privimin e tij të përjetshëm nga mëshira e Krijuesit të Lartë.

Një specifike tjetër që duhet

theksuar në lidhje me xhehenemin, është kjo: Siç mund të kuptohet lehtësisht nga tablotë konkrete të vizatuara si nga Kur'ani, ashtu dhe nga hadithet profetike, ndëshkimin dhe vuajtjen e xhehenemit do ta heqë shpirti bashkë me trupin. Ndërkaq, ne nuk mund ta dimë plotësisht aspektin e brendshëm të ndëshkimit të zjarrit, sepse edhe nëse kjo botë për të cilën na flitet ne, mund të ketë ndonjë ngjasim me botën ku jetojmë, është jashtë çdo diskutimi se nuk është identike me të.

Arafi

Araf do të thotë interval, vend në mes. Me kuptimin që del nga versetet kur'anore, ai ndodhet mes xhenetit dhe xhehenemit, por mbi cilësinë e tij nuk kemi asnjë njohuri. Lidhur me ata që ndodhen në Araf, në Kur'an thuhet kështu:

“Një mur do t'i ndajë ata, ndërsa në lartësitë e tij do të ndodhen njerëz, të cilët i njohin të dyja palët sipas tipareve. Ata do t'u thërrasin banorëve të Xhenetit: “Paqja qoftë mbi ju!” Ata nuk do të kenë hyrë ende në Xhenet, ndonëse shpresojnë. E kur t'i kthejnë sytë nga banorët e zjarrit, do të thonë: “O Zoti ynë! Mos na hidh midis këtyre njerëzve të këqij!”²⁵

Në Kur'an paraqiten tre tablo të veçanta dhe, në këtë mes, bëhet fjalë për njerëzit që ndodhen në Araf.

Në pjesën e parë, zë vend pyetja

25. Araf, 7/46-47.

e banorëve të xhenetit për banorët e xhehenemit. “Banorët e xhenetit pyesin: “Ne e pamë se premtimi i Zotit tonë për ne ishte i vërtetë. Po ju, e patë të vërtetë premtimin e Zotit tuaj për ju?” Kësaj pyetjeje, banorët e xhehenemit i përgjigjen “Po!”

Mu në këtë mes, një thirrës thotë: “Mallkimi i Allahut rëntë mbi mohuesit!”²⁶

Në tablonë e dytë e marrin fjalën banorët e Arafit. Ata shohin nga banorët e xhenetit dhe u thonë: “Paqe juve!” Pastaj i hedhin vështrimet nga banorët e xhehenemit dhe thonë: “Zoti ynë, mos na vendos bashkë me grupin e mizorëve!”

Pastaj ua kujtojnë parësisë që njohin nga banorët e xhehenemit, fjalët që kanë thënë në këtë botë dhe ua përplasnin syve faktin se atyre s'u kanë sjellë dobi as pasuria, as fëmijët. Duket sikur kjo skenë ndërron dhe dëgjohen këto fjalë të banorëve të Arafit për banorët e xhenetit: “Hyni në xhenet se për ju nuk ka më frikë dhe ju s'keni për t'u dëshpëruar!”²⁷

Kurse në tablonë e tretë, banorët e xhehenemit u luten banorëve të xhenetit t'u japin edhe atyre nga të mirat që u janë dhënë: “Lëshonani edhe ne nga uji ose të mirat që ju ka dhënë Allahu!” Kurse banorët e xhenetit u japin këtë përgjigje: “Allahu ua ka bërë haram (ua ka ndaluar) këto mohuesve.”²⁸

26. Araf, 7/44.

27. Araf, 7/49.

28. Araf, 7/50.

Kjo do të thotë se banorët e Arafit, nga njëra anë janë në marrëdhënie me banorët e xhenetit, nga ana tjetër, me banorët e xhehenemit. Që të dy palët i njohin e i dinë nga afër.

Sipas disa mendimeve, këta njerëz që shohin xhenetin dhe mbushen me shpresë, shohin xhehenemin dhe rrëqethen nga frika, janë persona që, për t'u bërë plotësisht të gatshëm për të hyrë në xhenet, duhet të shijojnë për një farë kohe një shqetësim dhe dëshirim të tillë.

Ndërsa disa mëkatarëve u bëhen dëmshpërblim shqetësimet që kanë

hequr në këtë botë, disa të tjerëve u bëhet dëmshpërblim mundimi i varrit që i pastron ata nga mëkatet. Kurse ata që s'pastrohen me këto dy mënyra, në jetën e pasme do të kalojnë nëpër një proces të tillë pastrimi.

Një grup prej këtyre do të vazhdojnë të jetojnë në Araf me shpresën e xhenetit dhe frikën e xhehenemit. Kjo formë jetese do të jetë për ta dëmshpërblim dhe pastrim nga mëkatet. Pastaj, me mëshirën dhe bujarinë e Allahut, do të hyjnë në xhenet.

Allahu e di të vërtetën dhe aspektin e brendshëm të çdo gjëje.

Qëndrimi i Ebu Hanifes gjatë zhvillimeve politike të kohës

Dorian Demetja

Abstrakt

Njerëzit e mëdhenj që shënon historia, dalin në pah pikërisht në kohën kur çrregullimet në shoqëri arrijnë kulmin. Për të vënë rregull në botën e jashtme, njeriu në fillim duhet të vendosë rregull dhe ekuilibër brenda vetes së vet. Parë në këtë këndvështrim, Ebu Hanifja ishte njeri i rrugës së mesme dhe para së gjithash ishte një personalitet me ekuilibër e vendosmëri të lartë. Po të analizojmë kohën në të cilën ai jetoi, do të gjendemi përballë problemeve të mëdha politike e shoqërore, për më tepër përplasje dhe konflikte ndërmjet grupeve të besimeve e sekteve të ndryshme fetare. Ai shumë mirë mund t'i binte shkurt duke u bërë palë por që nga fillimi, ai nuk e ndryshoi asnjëherë vijën e rrugës së vet duke sakrifikuar shumë për tek e drejta, si dhe duke u përpjekur që t'ua jetësonte edhe të tjerëve këtë të drejtë. Nisur nga kjo, nuk është gabim të themi se Ebu Hanifja jetoi ashtu si mendoi e besoi, si dhe besoi ashtu si jetoi e mendoi.

Sipas pikëpamjes së përgjithshme, një dijetar nuk është ekspert vetëm në një fushë të caktuar të disiplinave fetare. Për të qenë i tillë, ai jo vetëm që është hulumtues në të gjitha shkencat e fesë, por duhet të njësohet me të gjitha këto dituri. Krahas kësaj, që një dijetar në kuptimin e plotë të fjalës, do të ishte ai që përveç asaj që u përmend më lart, di të marrë

mesazhe nga historia e popujve të kaluar, di të lexojë kohën në të cilën jeton dhe ka largpamësi për të ardhmen.

Duke iu referuar hadithit të Profetit Muhamed (a.s.): “Përqendrohuni në rrugën e drejtë, por do ta keni të vështirë”¹, dëshmohet se qëndrueshmëria në rrugën e drejtë mund të arrihet vetëm nga njerëzit

1. Ebu Daud; Ahmed Ibn Hanbel.

e mëdhenj, sepse qëndrueshmëria në rrugën e drejtë nuk pranon devijime dhe lëkundje. Ajo arrihet vetëm duke u sforcuar mbi mundin e zakonshëm dhe duke qëndruar para Allahut të Madhëruar me sinqeritet të vërtetë.² I këtyre përmasave ishte edhe Imam Adham, Ebu Hanife.

Numan bin Thabit bin Zuta bin Mah, i njohur si Imam Adham Ebu Hanife, ka lindur në Kufe të Irakut në vitin 699/80 hixhri, gjatë kohës kur sahabet më të rinj ishin ende gjallë. Ebu Hanife rridhte nga një familje me gjendje të mirë ekonomike dhe në fillimet e tij është marrë me tregti, duke ndjekur gjurmët e të atit. Kufa dhe Bagdadi ku jetoi Ebu Hanifja, ishin qytete me shumë kultura religjioze, rryma dhe ideologji të ndryshme, si dhe ndër qendrat më të mëdha të botës islame, ku diskutohej jo vetëm rreth çështjeve të fesë, por edhe atyre sociale e politike.

Ebu Hanifja ishte një person shumë i zgjuar, mendjemprehtë dhe me forcë argumentuese racionale. Për dhuntitë logjike të tij Imam Shafiu thotë: *“Nuk ka lindur nëna një njeri më të zgjuar se Imam Adhami”*. Metodot e fik’hut ai i mbështeste në traditat logjike që përfaqësonin disa sahabet të mëdhenj si Hz. Omeri, Hz. Aliu, Abdullah ibn Mesudi dhe Ibn Abasi (r.a.). Ebu Hanifja nuk ishte vetëm një dijetar i zgjuar, ai jetonte me të vërtetat e jetës shoqërore, ishte

2. El Feshnij, Ahmed bin Shejh Hixhazi, *Kuvendet e Ndrisshme*, Tiranë 2004, f. 191.

social dhe tregonte shumë interes për marrëdhëniet ndërnjerëzore. Ai na del përpara si një personalitet që e vlerëson mendimin e të tjerëve dhe si një njeri i dijes që vazhdimisht prodhon ide e krijimtari.³

Mënyra se si është rritur e edukuar Ebu Hanifja, na tregon qartë lidhjen dhe respektin që ai kishte ndaj autoriteteve fetare e politike, por njëkohësisht tregon edhe ndjenjën e fortë për liri e pavarësi. Lidhjen që ka pasur me autoritetet, e ka mbështetur në drejtësi e logjikë dhe kurrsesi në besim të verbër. Këtë qëndrim ai e ka treguar edhe në marrëdhëniet me nxënësit e vet apo në shprehjet e tij fetare e politike. Ebu Hanifja nuk ua ka imponuar nxënësve mendimet e tij, nuk ka dashur ta imitojnë qorrazi dhe asnjëherë nuk është paraqitur para tyre si një autoritet i pagabueshëm. Ai besonte se problemet e kohës kërkonin përgjigje të rrahura jo nga një mendje, por nga shumë mendje dhe për këtë arsye ai u mësonte nxënësve të tij mënyrat e gjykimit dhe jo përgjigjet e gatshme. Imami dëshironte që ata të shtrydhnin mendjen e mendimet dhe të dilnin vetë në përfundimet e drejta.⁴

Ebu Hanifja ka jetuar 52 vjet nën qeverisjen Emevite dhe 18 vjet

3. Hökelekli, Hayati, *İmam-ı Azam Ebu Hanife'nin kişilik yapısı, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri)*, Bursa 2005, V. I, f. 104-105.

4. Hökelekli, *Po aty*, f. 109.

nën qeverisjen Abaside. Ai mbi të gjitha, është një personalitet që ka bërë një jehonë të madhe në botën islame për ndërtimin e një sistemi mendimi dhe formimin e një shkolle juridike. Mirëpo, përveç kësaj, ai ka dhënë një kontribut shumë të madh gjatë zhvillimeve politike të asaj kohe dhe është shquar për reagimet e tij ndaj praktikave të jashtëligjshme të sunduesve Emevi dhe Abasidë. Ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë pozicionin e tij, janë praktikat totalitare të sunduesve Emevi dhe Abasidë, si dhe qëndrimet e tyre të padrejta ndaj Ehlit Bejtit.

Dijetari i njohur Xhessas (v. 370/980) thotë: “*Sipas Ebu Hanifes, midis gjykatësit dhe halifes nuk ka ndonjë ndryshim dhe tek të dy këta kërkohet një kusht i përbashkët, që është drejtësia. Siç nuk mund të bëhet një mëkatar halife, ashtu dhe nuk bëhet dot gjykatës*”.⁵ Edhe Ibn Hazmi (v. 456/1064), mbështetur në vijën e kësaj teorie, mendon se, nëse nuk ka rrugë tjetër për ‘emri bil maruf ue nehji anil munker’⁶, duhet të ndërhyhet fizikisht.⁷

Ky është koncepti fetar e shoqëror i Ebu Hanifes, i cili ka përkrahur haptazi dhe ka ndihmuar në fetva e materialisht Zejd bin Ali Zejnelabidin kundër dhunës së halifes së shtetit Emevi, Abdulmelik

bin Mervan (v. 86/705). Madje midis kësaj ngjarjeje dhe luftës së Bedrit ka formuar një lidhje shpirtërore. Po ashtu, ai ka ndihmuar në fetva dhe materialisht Muhamed Nefszekije në Medine dhe vëllain e tij Ibrahimin në Basra, kundër udhëheqjes tirane Abaside.⁸

Me të vërtetë Ebu Hanifja ishte i mendimit dhe e shihte si detyrë që ndaj një pozite, e cila ka një karakter tiran dhe e cila ka humbur legjitimitetin, duhet bërë diçka. Ai besonte bindshëm se e drejta në vazhdimin e Hilafetit i përkiste djemve të Hz. Aliut dhe për këtë arsye e ka kritikuar hapur udhëheqjen Emevite. Ndërkaq, me vrasjen e djemve të Hz. Aliut nga Emevitët, pakënaqësitë dhe kritikën e ashpra të shtresave të ndryshme të shoqërisë, bënë që të lëkundet shumë udhëheqja Emevite. Për të sheshuar këto revolta, Halifja Abdulmelik bin Mervan, mori disa masa duke thithur në gjirin e shtetit disa dijetarë me influencë në popull.

Emevitët, duke parë diturinë e thellë dhe rrethin e gjerë të ndikimit në popull të Ebu Hanifes, menduan ta tërhiqnin pas vetes duke i propozuar postin e gjykatësit. Këtë propozim, nga Emevitët, e ka bërë guvernatori i Irakut Omer bin Hubejra (v. 132/750). Këtë gjë Ibn Hubejra e bëri edhe me disa dijetarë të tjerë, të

5. Xhessas, Ebu Bekir, *Abkamul- Kur’an*, Beirut 1993, 1/99.

6. Urdhërimi në të mirë dhe largimi nga e keqja.

7. Ibn Hazm, *el-fisal fil-milal ve’l-ehvai ve’n-nihal*, Beirut 1985, V, 20-23.

8. Yaman, Ahmet, *Ebu Hanife ve Reel Siyaset*, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri), Bursa 2005, V. II, f.32.

cilët, jo me shumë dëshirë, pranuan dhe morën disa poste në qeverisje. Mirëpo Ebu Hanifja e kuptoi qëllimin e dhënies së këtij posti dhe nuk e pranoi detyrën. Guvernatori u nxeh nga ky qëndrim dhe urdhëroi goditjen e imamit me kamxhik. Djali i Ebu Hanifes, Hamadi dhe studenti i imamit, Ebu Jusufi, tregojnë se Ibn Hubejra e torturoi Ebu Hanifen duke urdhëruar gardianin që për 10 ditë me radhë t'i gjuajnë atij me kamxhik 10 herë në ditë. Ka të dhëna që si rezultat i torturave koka e tij i është ënjtur dhe frymëmarrja i është vështirësuar. Atyre dijetarëve që pranuan postet (Ibn Ebu Lejla, Ibn Shubrume dhe Daud ibn Ebu Hind) që thonin: Mos rreziko veten, pranoje këtë detyrë, Ebu Hanifja u është përgjigjur kështu: *“Edhe sikur guvernatori të kërkojë prej meje një punë të thjeshtë si numërimin e dyerve të xhamisë, përsëri nuk do të pranoja. Si mund ta pranoj këtë detyrë?! Ai do të vendoste për ekzekutimin e një njeriu dhe unë u dashka ta miratoj! Betohem në Allah që nuk e mbaj mbi vete këtë përgjegjësi”*.⁹

Nisur nga kjo, respekti i popullit ndaj qeverisë, duhet përpjekur të fitohet jo me dhunën e nëpunësit të qeverisë, por me seriozitetin e qeveritarëve në sjelljet dhe veprimet e tyre, me sinqeritetin në punët dhe shërbimet e tyre. Gjer tani, me despotizmin e nëpunësve mizorë, apo me mashtrimin e masave, askush

nuk ka dalë i fituar. Sundimi i forcës është kalimtare. I përjetshëm është sundimi i së drejtës dhe drejtësisë. Edhe nëse jo sot, është jashtë çdo diskutimi se në një të ardhme të afërt, këta do të dalin fitues. Prandaj, politika më e madhe duhet kërkuar në anësinë ndaj së drejtës dhe drejtësisë, sepse drejtësia është një nga rrugët për të qenë pranë Zotit.

Pas këtyre ngjarjeve Ebu Hanifja e kuptoi që nuk mund të rrinte më në Kufe dhe u largua në Mekë duke qëndruar atje më shumë se 6 vjet, derisa erdhën në fuqi Abasidët. Me ardhjen e Abasidëve në fuqi, imami gëzohet duke shpresuar në mirëqeverisjen e tyre dhe në premtimin që ata dhanë në mbrojtjen e të drejtave të djemve të Hz. Aliut. Për këtë arsye së bashku me shokët e vet kthehet në Kufe dhe i japin besën halifes së shtetit Abasid Ebu'l Abas es-Safah.¹⁰ Sigurisht ky gëzim i tij nuk zgjati shumë, sepse edhe ata filluan të përndiqnin dijetarët dhe njerëzit fisnikë e me merita, duke u bërë padrejtësi apo edhe duke i vrarë. Për t'u mos u bërë vegël e së keqes dhe e padrejtësisë së tyre, Ebu Hanifja ndryshoi qëndrim duke këmbëngulur në rrugën që e konsideronte të drejtë, sepse në konceptin e Ebu Hanifes, ndaj diçkaje që duket e keqe, nuk ka bindje, qoftë fundi i këtij veprimi edhe burgosja.

10. Uzunpostalci, Mustafa, *Ebu Hanife*, TDV *İslam Ansiklopedisi*, İstanbul 1994, V. 10, f.133.

9. Yaman, *Po aty*, f.34.

Fetvatë civile të Ebu Hanifes kishin një pëlqim dhe miratim më të madh në popull se sa fetvatë e dijetarëve të pushtetit si Euzai apo Ibn Ebu Lejla. Për këtë arsye, halifja e Abasidëve Ebu Xhafer el-Mansur (v. 775), nuk ka ushtruar presion ndaj pikëpamjeve të tij fetare, me kusht që imami të mos ndërhyjë në udhëheqjen e qeverisë. Kur gjykatësit e tjerë i dhanë të drejtë halifes për shtypjen e rebelimit të popullit të Mosulit, Ebu Hanifja e kundërshtoi duke i bërë të ditur halifes se, gjaku i myslimanëve nuk mund të merret, sipas legjislacionin islam, përveçse në tre raste. Këtë imami e ka thënë haptazi duke iu përmbajtur edhe hadithit të Profetit (a.s.): “*Xhibadi më i mirë është të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran*”.¹¹ Megjithëse pa dëshirë, halifja ka pranuar mendimin e Ebu Hanifes për të mos dënuar popullin e Mosulit. Kjo ka qenë arsyeja përse gjykimet e Ebu Hanifes ishin të mirëpritura në popull, sepse ato ishin të ndërthurura në shumë dimensione me në krye drejtësinë.¹²

Për çdo njeri ka një lloj xhahadi që është ‘më i miri’. Kurse hadithi i lartpërmendur, *xhibadi më i mirë është të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran*, tërheq vëmendjen se pothuajse

për të gjithë ky lloj xhahadi është ‘më i vështiri’, sepse në xhahadin e zakonshëm (në luftë), del përballë armikut dhe ke shpresë të dalësh fitimtar. Ndërsa të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran, që zotëron të gjithë fuqinë dhe autoritetin, do të thotë të shkatërrosh vetveten, do të thotë t’i hysh një pune, përfundimi i së cilës është i ditur që në fillim. Por njëkohësisht me fjalën e drejtë, duke penguar një të keqe që mund të bëjë sunduesi, bën një dobi shumë të madhe dhe i shpëton njerëzit nga padrejtësia. Pra, të thuash të drejtën përballë sunduesit tiran është me rrezik për atë që e thotë dhe dobi për shoqërinë. Për këtë arsye është cilësuar si xhahadi më i madh, xhahadi më i mirë dhe xhahadi më fisnik.¹³

Njëherë halifja Ebu Xhafer el-Mensur dhe gruaja e tij kishin një mosmarrëveshje. Ai e pyeti atë se kë pranonte ajo si gjykues për këtë çështje? Ajo iu përgjigj: Ebu Hanifen. Halifja iu drejtua Ebu Hanifes duke i thënë: “Ebu Hanife kjo grua e lirë ka një mosmarrëveshje me mua. Më jep mua të drejtën time kundër saj”. Përgjigjja që i dha Ebu Hanifja kësaj çështjeje ishte më tepër në favor të gruas dhe halifja qëndroi i heshtur për një kohë të gjatë. Ebu Hanifja u largua. Kur imami arriti në shtëpinë e tij, gruaja e halifes i dërgoi atij një shërbëtor me para, rroba, një robëreshë etj. Ebu Hanifja e refuzoi dhuratën dhe i tha shërbëtorit:

11. Ebu Daud; Tirmidhi; Nesai; Ibn Maxhe; Ahmed; Beyhaki.

12. Uyanık, Mevlüt, İslam düşüncesinin teşekkül döneminde Ebu Hanife'nin siyasi duruşu, İmam-ı Azam Ebu Hanife ve Düşünce Sistemi (sempozyum tebliğ ve müzakereleri), Bursa 2005, V. I, f. 128.

13. Çakan, İsmail Lütfü, *Hadislerle Gerçekler*, İstanbul 1990, f. 255, 257, 259.

“Përcilli përshëndetjet e mia gruas së halifes dhe thuaji që dhurata rrezikon besimin tim. Unë mbrojta të drejtën dhe këtë e bëra për hir të Allahut duke mos pritur asgjë nga askush”.¹⁴

Tregohet që Ebu Hanifja u thirr nga halifja el-Mensur për ta bërë kryegjykatës, dhe ai e refuzoi. Halifja i tha: “Mos dëshiron atë që kemi ne?” Ebu Hanifja ia ktheu: “Jo, por unë nuk jam i përshtatshëm”. Halifja i tha: “Gënjen”. Imami tha: “Pra, ashtu si thoni edhe ju, një person që gënjen nuk mund ta marrë përsipër këtë detyrë, nëse unë them të vërtetën, atëherë nuk jam i përshtatshëm për këtë detyrë”.¹⁵ Kështu, duke përdorur zgjuarsinë e tij, imami refuzon t’i japë legjitimitet punëve të halifes. Në kohën kur jetoi Ebu Hanifja, ka pasur nga ata dijetarë fetvatë e të cilëve, për sa i përkasin fushave publike, janë ndikuar nga politika. Të njëjtën gjë nuk mund të themi për Ebu Hanifen. Nëse ai do të sillej politikisht, pra, duke dhënë fetva në favor apo në disfavor të një personi ose disa personave, atëherë fetvatë e Ebu Hanifes nuk do t’i rendisnim nën devizën ‘emri bil maruf ue nehji anil munker’. Në këtë kontekst, me fetvatë civile apo individuale, imami ka qenë në kërkim të së drejtës dhe drejtësisë duke

mbrojtur në këtë mënyrë strukturën shoqërore.

Ashtu si ka kritikuar halifen, Ebu Hanifja ka kritikuar edhe gjykimet e gabuara të dijetarëve dhe gjykatësve të kohës, si për shembull, vendimet e gjykatësit të Kufes, Ibn Ebu Lejla. Ebu Hanifja së bashku me nxënësit e tij, i kanë diskutuar në mësimet dhe organizimet shkencore duke kritikuar ato vendime të gabuara. Madje, për të kuptuar dimensionet e pikëpamjeve të ndryshme mes Ebu Hanifes dhe Ibn Ebu Lejlës, është me vlerë të përmendim librin e shkruar nga nxënësi i imamit, Ebu Jusufi me temë: ‘Ihtilafu Ebi Hanife ue Ibn Ebi Lejla’^{16,17}

Megjithëse ishte oponent, besueshmëria e imamit ishte rritur aq shumë, sa që i ishte propozuar edhe përgjegjësia e thesarit të shtetit, por Ebu Hanife nuk ka pranuar duke zgjedhur mësimin dhe rrugën e diturisë. Madje, halifja El-Mensur e mbështeti imamin duke i dhënë atij dhurata, por Ebu Hanifja i refuzonte me etikë. Ky qëndrim i imamit ishte shumë produktiv duke ndikuar jashtë mase te njerëzit. Duhet të theksohet që këto zgjedhje kanë qenë personale dhe nuk kanë ndikuar te nxënësit e vet. Këtë e shohim më vonë kur nxënësit e imamit kanë marrë detyra shtetërore.¹⁸

Mirëpo të gjitha këto ngjarje

14. Ebu Zehra, Muhamed, *Ebu Hanife* (perkth. O. Keskioglu), Konya 1981, f. 57-61.

15. Ebu Zehra, *Po aty*, f. 13.

16. Ndryshimet në pikëpamje mes Ebu Hanifes dhe Ibn Ebi Lejla.

17. Uzunpostalci, *Po aty*, f.134.

18. Uyanik, *Po aty*, f. 124.

nuk do të kalonin lehtë për imamin, sepse do të kishte edhe nga ata dijetarë fanatikë, që do të shpreheshin negativisht për të. Mund të përmendim këtu Ebu Hatim bin Hiban El-Busti, i cili për të ulur imazhin në popull të Ebu Hanifes, e akuzoi atë sikur ka dalë nga feja dhe për këtë duhet të pendohej. Kemi edhe raste të tjera ku Ebu Hanifen kanë dashur ta vënë në pozitë të vështirë përballë halifes me raportime në disfavor të tij, por imami nuk iu është përgjigjur me të njëjtën monedhë duke u munduar të qëndrojë larg çdo lloj përgojimi. Një rast tjetër është ai i Ebu'l-Abas Tusit, i cili e provokon Ebu Hanifen në prezencë të halifes duke i thënë: “Nëse kryetari i shtetit kërkon prej nesh ta ekzekutojmë një njeri pa pyetur shkakun, a është e lejuar ta bëjmë këtë”? Duke kuptuar qëllimin e keq të tij, Ebu Hanifja me mendjemprehtësi ia kthen: “Apliko të drejtën, mos pyet arsyet”. Për këtë sulm dhe dredhi kundër tij, Ebu Hanifja do të shprehet: “Tusi donte të më zinte ngushtë, mirëpo unë e lidha fort atë”. Pra, shohim se edhe në këto raste të vështira imami nuk iu është ndarë të vërtetës dhe të drejtës.¹⁹

Njerëzit e mëdhenj që shënon historia, dalin në pah pikërisht në kohën kur çrregullimet në shoqëri arrijnë kulmin. Për të vënë rregull në botën e jashtme, njeriu në

fillim duhet të vendosë rregull dhe ekuilibër brenda vetes së vet. Parë në këtë këndvështrim, Ebu Hanifja ishte njeri i rrugës së mesme dhe para së gjithash ishte një personalitet me ekuilibër e vendosmëri të lartë. Po të analizojmë kohën në të cilën ai jetoi, do të gjendemi përballë problemeve të mëdha politike e shoqërore, për më tepër përplasje dhe konflikte ndërmjet grupeve të besimeve e sekteve të ndryshme fetare. Ai shumë mirë mund t'i binte shkurt duke u bërë palë por që nga fillimi, ai nuk e ndryshoi asnjëherë vijën e rrugës së vet duke sakrifikuar shumë për tek e drejta, si dhe duke u përpjekur që t'ua jetësonte edhe të tjerëve këtë të drejtë. Nisur nga kjo, nuk është gabim të themi se Ebu Hanifja jetoi ashtu si mendoi e besoi, si dhe besoi ashtu si jetoi e mendoi.

Është i padiskutueshëm fakti që bota islame sot dhe përgjithmonë ka nevojë të jashtëzakonshme për njerëz si Ebu Hanifja. Duke mbështetur mendjen njerëzore me traditën profetike, trashëgimia që ai la pas, është një burim reference për të mbajtur qëndrim të drejtë ndaj fenomeneve dhe një mesazh për mënyrën e të gjykuarit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ebu Hanifja ndërroi jetë në vitin 767/150 H në Bagdad. Vetë falja e namazit të xhenazes, gjashtë herë, nga një numër shumë i madh njerëzish, tregon qartë për pozitën dhe autoritetin e tij të lartë në popull.

19. Uyanik, *Po aty*, f. 127-128.

Hz. Muhamedi a.s., shembull për t'u ndjekur

Imam Muhamed Sytari

Abstrakt

Traditat e tij në të folur e në të vepruar plotësojnë njëra-tjetrën. Duket sikur çdo kërkesë prej kërkesave shpirtërore është paracaktuar dhe parallogaritur. Çdo gjë, me të cilën përballlet njeriu në jetën e tij, shfaqet në pasqyrën e jetës së tij a.s.

Ndërkohë, Zoti i gjithësisë, me mirësinë e Tij ndaj nesh, e dërgoi Hz. Muhamedin a.s., si Vulën e të dërguarve të Tij të mirë, udhërrëfjesin dhe plotësuesin e mirësive, për të cilat ka nevojë realisht bota e sotme.

Allahun e Madhëruar e falënderojmë për mirësinë e madhe dhe kreun e dhuntive hyjnore, me të cilën e lartësoi racën njerëzore drejt rrugëve të perfeksionit, teksa shpalli në Kur'anin Famëlartë lajmin e përbotshëm: “Mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët u ruben (mëkateve), e japin zekatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona; të cilët e pasojnë të dërguarin (Muhamedin), profetin analfabet, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij) në Tevrat dhe në

Inxhil, që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që u zbrit me të, TË TILLËT JANË TË SHPËTUARIT!”¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhamedit a.s., përshkrimin e të cilit e ka qëndisur kaq bukur zonja e nderuar nomade

1. Kur'ani, A'rafë: 156-157.

dhe gruaja e urtë Ummu Ma'bed, kur thotë se, Pejgamberi a.s: “Ishte një njeri me shkëlqim të dukshëm, me fytyrë të ndritshme, me moral të lartë... Me fytyrë të bukur, shumë të bukur, me sy të zinj... Me flokë të zinj, me qafë të dukshme e mjekër të dendur. Kur heshte, kishte prezencë e kur fliste, bukur... fliste ëmbël e qartë... Më i bukur i njerëzve nga larg, më i ëmbli dhe më i miri i tyre nga afër... Mesatar, jo i gjatë, as i shkurtër, si degë në mes dy degësh... Kur fliste e dëgjonin, e kur urdhëronte, vraponin për ta zbatuar...”²

E di mirë se jam i paaftë t'ia jap hakun e plotë, të flas për Hz. Muhamedin (a.s.) si shembull për t'u ndjekur në jetë. Megjithatë, në këto rreshta, do të përpiqem të prek disa nga cepat e kësaj teme të gjerë e të thellë, me qëllimin dhe dëshirën e mirë të përfitimit dhe dobisë.

Po lexoja me kënaqësi të madhe librin me titull: “Shembulli më i lartë ndër Profetë”, të autorit Hoxha Kemaluddin, një britanik që ka pranuar Islamin para shumë dekadash.

Ndër të tjera, tërheq vëmendjen me këto rreshta: “Këtu shfaqet vlera e Muhamedit (a.s.) mbi të tjerët dhe kjo na bën të themi se ai ishte shembulli më i lartë në mesin e profetëve, sepse regjistrimi i fjalëve

2. Dr. Mervan Shejhulerd, “Es-sirretun-nebevije”, f. 310, nga “Et-Tabakat” të Ibni Sa'dit, 1/231.

dhe i veprave të tij është i plotë, pa mangësi!

Traditat e tij në të folur e në të vepruar plotësojnë njëra-tjetrën. Duket sikur çdo kërkesë prej kërkesave shpirtërore është paracaktuar dhe paralogaritur. Çdo gjë, me të cilën përballlet njeriu në jetën e tij, shfaqet në pasqyrën e jetës së tij (Muhamedit a.s.).

Unë, nga pozita e myslimanit, nuk mund të them se profetët e tjerë nuk e kanë kryer me plotësi misionin e tyre, por ajo që dua të them është se në krejt atë që është trashëguar prej tyre, nuk gjejmë vetëm se fare pak prej mësimëve dhe zgjidhjeve për të cilat ka nevojë njeriu.

Padyshim që ata e kanë kryer si duhet misionin e tyre, për të cilin ishin dërguar, por historianët e tyre nuk u dhanë hakun që meritojnë!”³

Këtu e ndala leximin dhe m'u kujtua ajo që kishte shkruar Hoxha im, H. Vehbi S. Gavoçi në një prej librave të tij: “*Duranti*”⁴ në librin e tij «Historia e civilizimit» ka shkruar se, nëse e madhërojmë njeriun për çka bërë dhe çka u ka sjellë njerëzve, mund të themi se Muhamedi (a.s.) ka qenë më i madhi i të mëdhenjve të historisë, se ai lartësoi gjendjen shpirtërore e mirësjelljen e një populli të një

3. Hoxha Kemaluddin, “El-Methelul-a'la fil-Enbija”, botimi i parë, Bejrut, 1989, f. 54-55.

4. Will Durant (1885-1981), filozof, historian dhe shkrimtar i shquar amerikan, autori i veprës voluminoze: “Historia e civilizimit”. Për më shumë të shihet: https://it.wikipedia.org/wiki/Will_Durant.

veni të prapambetur...⁵⁵

Në mars të vitit 2013, me disa prej vëllezërve të dashur e të afërt, na qe shkruar nga Zoti i gjithësisë të ishim miqtë e Tij në Qaben e Madhnueshme, në një Umre të paharruar. Natyrshëm, një pjesë e gdhendur në zemër nga ai udhëtim njëjavor, ishte edhe qëndrimi në Medinën e Ndriçuar.

Në librin e kujtimeve të asaj Umreje, kam regjistruar edhe këto fjalë, prej ku, dua të hyj në thelbin e temës sime dhe ta përfundoj: “Tashmë, pas selamit më të fuqishëm e më të përmallshëm, zemra dhe shpirti janë më të paqtë, si vetë selami i Resulull-llahut... Ndërkohë dora vijon të shkruajë e të dëshmojë ah-atet e mallit, që prej shumë vitesh e priste këtë moment, feksimi i të cilit ndriçoi me bukurinë e selamit, duke i dhënë zemrës ngjyrë *Selamesh* në kohë *Pranimesh*.”

Aty, para dritares më fatlume në botë, vetja të duket i vogël, shumë i vogël, por njëkohësisht krenar, shumë krenar. Aty, teksa me zemër përpiqesh të bashkohesh e të bëhesh një me të Dashurin, vitet e shekujt, dija dhe njohuria, malli e loti, vijnë e bashkohen, bëhen një e koha sikur ndalet... Kthehet pas nëpërmjet dijes e njohurisë, mallit e lotit.

Ato momente sikur përsërisin *Bej’atu Resulin*, e ti, në atë përshpirtësi bëhesh pjesë e një Bese, e një

5. Vehbi Sulejman Gavoçi, “Mirësjellja Islame”, Shkodër, 1998, f. 210.

Dorëzimi, pas së cilit krejt bota bëhet e jotja, ndonëse ti nuk ia hedh sytë, nuk ke pse ta bësh. Ke prekur nga afër *Dorën e Besës* dhe ke marrë dëshminë e të qenurit *Ehli-Bejt...*⁵⁶

Shpesh, në momente të caktuara, më kujtohet ajo orë e begatë, kur i kam shkruar këto rreshta, bri minberit Sherifë, në pjesën më të begatë të kësaj toke, në “Kopshtin e Xhenetit”.

Shpesh, edhe sot e kësaj dite, largohem nga bota ime dhe udhëtoj drejt atij qoshku, ku teksa vështroj nga Minberi, Mihrabi dhe Varri, bri tyre, në gjuhën e dashnisë dhe mallit i drejtohem Resulull-llahut a.s. dhe i them:

Sejjidi, ja Resulall-llah, shpesh e kujtoj momentin kur dikush të pyeti: “O i Dërguar i Allahut, çfarë thua për një njeri, që e do një popull dhe nuk mund të jetë pranë tyre?” Dhe, me mirësinë tënde ia ktheve: “Njeriu do të jetë me atë që do!”⁵⁷

Shpesh, Zotëria im, e pyes veten, se a do jem një ditë i denjë të jem pranë teje, a të qëndroj në hallkën tënde? Unë e di mirë se me zemër të dua e dëshiroj të mos ndahem asnjë moment nga Thirrja e Udhëzimi, me të cilët u dërgove, duke e plotësuar amanetin e Zotit, por...

Nuk e di, o Zotëria im, e lexoj me vëmendje fjalën tënde: “*Shembulli*

6. Muhamed Sytari, “Dëshmitar në Sahar”, Shkodër, 2013, f. 7.

7. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, nga Ibni Mesudi (r.a.).

*im dhe shembulli juaj është si puna e një personi që ka ndezur një zjarr, në të cilin fluturat dhe karkalecat vijnë e hidhen në të, ndërsa ai i largon me dorë që të mos bien në të. Edhe unë mundohem t'ju largoj nga zjarri e ju më ikni nga duart*⁸ dhe frikohem...

E lexoj dhe jua them edhe njerëzve udhëzimin tënd: “*Kush nuk mëshiron nuk mëshirobet dhe kush nuk fal nuk falet*”⁹ dhe nuk e di sesa i aftë jam unë të mëshiroj e të fal, në gjurmët e shembullit tënd të përkryer.

E lexoj dhe jua them edhe njerëzve dritësimin tënd: “*Kush e beson Allahun dhe ditën e gjykimit le t'i bëjë mirë komshiut të tij dhe kush beson Allahun dhe ditën e gjykimit le të nderojë mikun e tij dhe kush beson Allahun dhe ditën e gjykimit le të flasë mirë ose të beshtë*”¹⁰, por nuk e di, a jam unë në lartësinë e pasimit dhe dëshmimit të këtij shembulli të mrekullueshëm, në marrëdhëniet e mia me të tjerët, duke u dëshmuar si pasuesi yt besnik?

E lexoj me vëmendje dhe mundohem ta përhap fjalën tënde: “*Më i miri ndër ju është ai që nuk e lë botën e ardhshme për këtë botë, as botën e tij për botën e ardhshme dhe ai që nuk bëhet i bezdisshëm për njerëzit*.”¹¹ dhe lutem me zemër të më bëjë Zoti prej tyre.

8. Transmetuar nga Ahmedî dhe Muslimi, nga Xhabiri (r.a.).

9. Transmetuar nga Ahmedî, nga Xheriri (r.a.).

10. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, Ahmedî, Nesaiu etj., nga Ebu Hurejra (r.a.).

11. Transmetuar nga Hatîbi, nga Enesi (r.a.).

E lexoj me zemër dhe jua them edhe të tjerëve, fjalën tënde, si balsam zemrash: “*I lumi ai që ruan gjubën (gojën) e tij, i mjafton shtëpia e tij dhe qan për gabimin e tij*”¹² dhe lutem që mos të ngelem pas në karvanin e atyre që të ndjekin në gjurmët e nënshtrimit, në këtë udhëzim shembullor...

E lexoj meditueshëm fjalën tënde: “*Nuk më ka besuar mua, kush fle i ngopur, ndërkohë që komshiu i tij është i uritur dhe ai e di*”¹³ dhe pyes veten, sa besimtar praktikant jam në këtë pikë?

E lexoj këtë hadith: “*Kërkimi i diturisë është detyrim për çdo mysliman dhe për kërkuesin e dijes kërkon falje çdo gjë, edhe balenat në det*.”¹⁴, ia lexoj edhe fëmijëve dhe miqve të mi, por nuk e di, se sa e shfrytëzoj kohën time, për të ecur në shembullin tënd, në këtë drejtim.

Lexoj e lexoj pa fund dhe, për një moment, ndalem te një thirrje e dalë nga zemra jote: “*Ata, që më së shumti më duan nga umeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinën e tij, vetëm të më shihte*”¹⁵ dhe, e di se unë dua të të shoh, të ta jap besën, të ta ndjek shembullin e të të bindem teksa

12. Transmetuar nga Tabaraniu dhe Ebu Nuajmi, nga Theubani (r.a.).

13. Transmetuar nga Bezzari dhe Tabaraniu, nga Enesi (r.a.).

14. Transmetuar nga Ibni Abdil-Berr, nga Enesi (r.a.).

15. Ahmedî në “El-Musned”, nga Ebu Dherri (r.a.).

thua: “Përhapni për mua, qoftë edhe një fjalë...”¹⁶

“Jeta e zbrazët, larg normave e moraleve fetare, jeta e dhënë pas qejfeve, luksit e veseve të ndryshme, pas mobimit të virtyteve, pas interesit personal, duke harruar të drejtat e detyrimet njerëzore e shoqërore ka ndikuar që vende, popuj, grupe njerëzish e individë të ballafaqohen, të përleshën, të përgjaken e të përpiqen për zhdrukjen e njëri-tjetrit.”¹⁷

Ndërkohë, Zoti i gjithësisë,

16. Transmetuar nga Ahmedi, Buhariu dhe Tirmidhiu nga Ibni Amr (r.a.).

17. Vehbi Sulejman Gavoçi, “Mirësjellja Islame”, Shkodër, 1998, f. 178.

me mirësinë e Tij ndaj nesh, e dërgoi Hz. Muhamedin a.s., si Vulën e të dërguarve të Tij të mirë, udhërrëfyesin dhe plotësuesin e mirësive, për të cilat ka nevojë realisht bota e sotme.

Si të thuash, modeli dhe shembulli që Zotëria ynë la të gjallë në mesin tonë, është përherë një garanci më shumë për një botë më të mirë, në paqe e në harmoni, në dije e në përkushtim, në dritë e në vëllazëri të sinqertë, ku njeriu është vëlla i njeriut e, ku besimi është përherë vlerë e burim sigurie!

Njolla në Biografi

Fatos A. Kopliku MS/MA
Washington, DC

Abstrakt

Diktatura e proletariatit kishte absurditete plot, dhe ajo e “njollës në biografi” është patjetër njëra prej tyre. Siç dihet, “njolla në biografi” ishte një damkosje e shekullit të XX-të që e ndiqte “të njollosurin” gjatë gjithë jetës, e bashkë me të edhe fëmijët e të afërmit, duke iu mohuar të drejtat e barabarta si qytetarë... Në fakt, gjuetia e “njollave” në biografi vazhdon dhe historia e tyre nuk ka mbaruar, çka dëshmon se ne shqiptarët akoma përballemi me pasojat e mentalitetit të latuar gjatë dekadave indoktrinimi sistematik masiv. Ka më se një çerek shekulli që shqiptarët, sipas disave, duhet të shqiten nga një tjetër njollë, ajo e Islamit. Narrativi ka kaluar stafetë me fare pak ndryshime në formë e aspak në thelb dhe na thotë se Islami na qenka arsyeja e prapambetjes, mentalitetit, mungesës së kulturës, apo deri edhe turbulluesi i dëlirësisë së gjakut arbëror...

Një retorikë e tillë të shtyn të besosh se “njeriu ynë ri, vepra më e ndritur e partisë” është akoma shëndoshë e mirë mes shqiptarëve dhe vigjilenca e gjuetia ndaj njollave, në thelb, nuk ka reshtur, thjesht ka ndryshuar trajtë. Diçka e tillë doemos që nuk mund të mos jetë shqetësuese.

Diktatura e proletariatit kishte absurditete plot, dhe ajo e “njollës në biografi”¹ është patjetër njëra prej

1. Absurditeti qëndron këtu: botëkuptimi ekskluziv materialist që shteti mbante (e impononte) zyrtarisht mohonte çdo realitet shpirtëror e metafizik, çdo gjë që nuk mund të matej e prekej. Në të njëjtën kohë konsideronte *a priori*

tyre. Siç dihet, “njolla në biografi”

bashkëfajtorë pasardhësit apo të afërmit e të “njollosurve”, duke njohur kështu praninë e një njolle që nuk matej e shihej tek ata. Një botëkuptim materialist logjikisht nuk mund të pranojë diçka të tillë pasi njeriu konsiderohet thjesht si produkt i mjedisit, e si rrjedhojë mund të lutohet kollaj, pavarësisht nga prejardhja (shih p.sh., Karl Marx, *Theses on Feuerbach* (1888)). Megjithatë, kjo është pikërisht çfarë ndodhi; papritmas

ishte një damkosje e shekullit të XX-të që e ndiqte “të njollosurin” gjatë gjithë jetës, e bashkë me të edhe fëmijët e të afërmit, duke iu mohuar të drejtat e barabarta si qytetar, e shoqëruar me një hije mosbesimi, akuzimi, e patjetër, edhe frike e tensioni. Njolla në biografi vinte në forma të ndryshme; arsimim jashtë shtetit, njohje e gjuhëve të huaja, shprehje e mendimeve ‘reaksionare’ ose ‘të prapambetura’ në ndonjë shkrim a libër... por ndoshta më e pafalshmja ishte prejardhja familjare.

Po pse është e kaq e rëndësishme kjo praktikë e së kaluarës? Në fakt, arsyeja është se gjuetia e “njollave” në biografi vazhdon dhe historia e tyre nuk ka mbaruar, çka dëshmon se ne shqiptarët akoma përballemi me pasojat e mentalitetit të latuar gjatë dekadave indoktrinimi sistematik masiv. Do të ndalemi te një nga ato pasoja, falë së cilës ka më se një çerek shekulli që shqiptarët, sipas disave, duhet të shqiten nga një tjetër njollë, ajo e Islamit. Narrativi ka kaluar stafetë me fare pak ndryshime

shteti vendosi se nuk ekzistojnë as zot, as engjëj, as djaj, por ekzistojnë njolla të padukshme që disi përcillen brez pas brezi. Breza të tillë të “infektuar” kështu duhet të identifikoheshin, izoloheshin, apo edhe eliminoheshin fizikisht nëse qe nevoja, për të mirën e shoqërisë. Dhuna e padrejtësia që përjetuan shumë familje shqiptare për dekada me radhë nga kjo gjueti shtrigash e kohëve moderne përbën një nga faqet më tragjike të historisë shqiptare të shekullit të XX-të.

në formë e aspak në thelb dhe na thotë se Islami na qenka arsyeja e prapambetjes, mentalitetit, mungesës së kulturës, apo deri edhe turbulluesi i delirësisë së gjakut arbëror... Një retorikë e tillë të shtyn të besosh se “njeriu ynë ri, vepra më e ndritur e partisë” është akoma shëndoshë e mirë mes shqiptarëve dhe vigjilenca e gjuetia ndaj njollave, në thelb, nuk ka reshtur, thjesht ka ndryshuar trajtë. Diçka e tillë doemos që nuk mund të mos jetë shqetësuese.

“Njolla” e Islamit

As edhe një historian, filozof, matematicien (apo edhe ndonjë fallxhor le të themi) nuk mund të parashikojë se pas 100 viteve cili shtet, komb, kontinent a qytetërim do të jetë më i fuqishmi, qoftë nga ana politike, ushtarake, ekonomike apo kulturore. Megjithatë, ka një akuzë disi të çuditshme karshi shqiptarëve që para pesë shekujsh (e në vijim) pranuan Islamin, sepse me këtë zgjedhje na privuan pjesëmarrjen në Evropë e në klubin perëndimor.

Por a qëndron një akuzë e tillë? Domethënë, a mund t’u kërkohet shqiptarëve para pesë shekujsh një llogari e tipit: “Po si nuk e kishit të qartë që pas tre-katër shekujsh osmanët nuk do të ishin më superfuqi, por do të ishin anglezët e francezët, prandaj ç’deshët me osmanët?” Askush s’e ka shprehur në këtë mënyrë, por, në thelb, këtu të çon logjika që përdoret kundrejt

shqiptarëve që pranuan Islamin nën sundimin osman². Askush nuk e di të ardhmen, e ndoshta pas 200 vitesh do të jetë Argjentina superfuqi. Do të ishte pa kuptim, për shembull, sugjerimi se sot nuk duhet të kemi marrëdhënie me SHBA-në apo NATO-n, pasi pas 200 vitesh qendra e botës do të jetë Buenos Airesi, bie fjala. Megjithatë, pak a shumë kështu akuzohen shqiptarët myslimanë, me një ton që duket sikur thotë: “Ç’bëtë që pranuat Islamin se na morët në qafë tani që Evropa e Perëndimi janë të pushtetshme!”

Gjithashtu, një qëndrim e akuzë e tillë tregon shqetësimin njëdimensional të atyre që ankohen, gjegjësisht, që nuk jemi në klubin e më “të fortëve” për faj të Islamit. Për njerëz të tillë, mundësia që një njeri, komunitet apo komb, mund të pranojë një fë për një arsye tjetër përveç asaj të interesit material, duket sikur nuk ekziston³. Në të njëjtën

kohë, forca e pushteti reduktohen në sferën ekonomike, politike apo ushtarake. Diçka e tillë si ‘forcë shpirtërore’ konsiderohet si iluzion apo fantazi foshnjore, e padenjë për të rritur, apo në funksion të politikës e pushtetit, në rastin më të mirë. Për një pjesë të mirë të të bezdisurve nga pranimi i Islamit nga shqiptarët, përqafimi i vlerave ka kuptim për sa kohë këto vlera i përkasin shteteve “të zhvilluara”.

Për shembull, xhaz-i e blues-i amerikan konsiderohen të pranueshme, të mirëpritura, dhe hapa integrimi, ndërsa muzika afrikano-perëndimore jo. Fakti se këto zhanre muzikore janë jehonë e origjinës së tyre nga brigjet perëndimore të Afrikës⁴ nuk para mbart shumë rëndësi për këtë kategori njerëzish. Pakkush nga të tillë është i interesuar në muzikën afrikane *për se*; vende

2. Kujtojmë se Islami ka ardhur të paktën një shekull para osmanëve në Ballkan.

3. Po ashtu nuk i jepet haku së vërtetës duke përsëritur formulën e 50 vezirëve e sadrazamëve shqiptarë në Perandorinë Osmane, a thua sikur shqiptarët përqafuan Islamin për të konkurruar për postet e Perandorisë. Shqiptarët dhanë mjaft figura intelektuale e shpirtërore; kujtojmë Sami Frashërin, Hasan Tahsinin (rektor i parë i Universitetit të Stambollit), apo deri edhe zotërues të titullit më prestigjioz të shkencave islame, atë të *shejh-ul islamit*, si Arnaut Ibrahim Efendiu (vd. 1797); po ashtu, Baba Rexheb Ferdiu (vd. 1995), themelues i vllaznisë dhe teqesë bektashiane

në Amerikë, vinte nga një traditë e gjatë udhëheqësish shpirtërorë e intelektualë myslimanë shqiptarë në Perandorinë Osmane.

4. Muzika e Malit, në veçanti, është dëshmi e gjallë e kësaj lidhjeje. Mjafton të dëgjohen meloditë e këngët nga Ali Farka Toure (vd. 2006), p.sh., një artist afrikano-perëndimor i njohur në mjaft vende të botës, dhe kjo lidhje bëhet e qartë; të qenët muzikolog s’është parakusht të bëjë këtë dallim. Të shihen Gerhard Kubik, *Africa and the Blues* (University of Mississippi Press, 1999); Gunther Schuller, *Early Jazz: Its Roots and Musical Development* (Oxford University Press, 1968). Shembulli që dhamë është vetëm për ilustrimin e argumentit tonë, asgjë më tepër.

si Mali apo Mauritania nuk kanë prestigj e pushtet global, e si rrjedhojë nuk kanë pse interesohen në kulturën e tyre, e cila nuk mund të jetë tjetër përveç se inferiore. Pra, ata që bezdisen nga trashëgimia e prania e Islamit shqiptar përdorin këtë logjikë: arti, kultura, sporti, vlerat, religjioni... kanë vlerë nëse vijnë nga shtete e kombe të fuqishme e me prestigj, i cili njehsohet me politikën, ekonominë ose fuqinë ushtarake. Një shtet që nuk i ka këto s'është i denjë t'i imitohet apo huazohet gjë. Këtyre Krishterimi u është i pranueshëm jo se është fé e Etiopisë⁵, Armenisë apo koptëve të Egjiptit – pra e disa prej komuniteteve më të lashta të krishtera në histori – por se është⁶ fé e popullatës së shteteve perëndimore. Është çështje përkatësie, identifikimi, nuk është çështje e lidhur me fenë si ushqim

5. Mbretëria e Abisinisë (Etiopisë) dhe ajo e Armenisë janë të parat mbretëri, fillimet e shekullit VI, që pranuan Krishterimin dhe e morën atë nën mbrojtje. Ndërkohë disa nga komunitetet më të lashta të krishtera janë arabe – qofshin në Egjipt, Palestinë, Siri, apo Irak. Ky fakt shpesh anashkalohet, siç dhe lihet në heshtje “mrekullia” se si kanë mbijetuar të krishterë arabë në mes myslimanëve arabë; ndërsa argumenti që kjo mbijetesë e minoriteteve është në sajë të Islamit, me ose pa qëllim, rrallë merret në konsideratë.

6. Në fakt, do të qe më e saktë që foljen “është” ta përdornim në kohën e shkuar sepse në Evropën Perëndimore sekularizmi, liberalizmi e të tjera –izma, ka kohë që e kanë zhvendosur Krishterimin në një rol periferik, që sa vjen e zvogëlohet.

shpirtëror e udhëzim jetik. Në këtë kontekst, Islami shihet si njollë që duhet të degdiset në periferi të sferës publike shqiptare, apo fshihet fare, mundësisht edhe nga historia jonë.

“Njolla” e prapambetjes

Pak fjalë janë më të ngarkuara me nënkuptime e presupozime sesa fjala “prapambetje”, fjalë e cila kërkon patjetër “zhvillimin” për të fituar kuptim. Por këto fjalë kërkojnë gjithashtu sqarim të mëtejshëm: zhvillim në çka, drejt çkaje? Ç'do të thotë prapambetje? A ka diçka të tillë si ‘mendësi e prapambetur’? A mund të quhet mentaliteti i sotëm i prapambetur 50 vjet në të ardhmen? Cila është pikë referimi për zhvillimin apo prapambetjen?

Sqarime të tilla rrallë kërkohen, e si rrjedhojë moria e presupozimeve dhe nënkuptimeve, sa herë që fjalët “zhvillim” ose “progres” shqiptohen, obligojnë njerëzit në bindje falë autoritetit që ato bartin⁷. Doemos çdo gjë që konsiderohet si pengesë e progresit demonizohet e përbuzet. Në Shqipëri, gjatë periudhës së monizmit, Islami u identifikua si fajtori i prapambetjes. Shembujt janë aq të shumtë sa referencat janë

7. Për një koment më të detajuar të shihet William C. Chittick, *Shkencë e Kozmosit, Shkencë e Shpirtit: Përshtatësia e kozmologjisë islame në kohët moderne*, shqip., parath. & shënimet Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2011), f. 51-56.

të tepërta, që nga librat shkollorë te deklaratat e një numri jo të vogël figurash publike, që, direkt apo indirekt, e përkrahin këtë pohim.

Fjala “progres” është e ngarkuar emocionalisht e politikisht. Kushdo që flet në emër të progresit, automatikisht vendoset në pozita autoritare. Ajo çka quhet “progres” apo “zhvillim” mund të thuhet se është një term eufemizëm për “industrializimin”. Domethënë, vendet e zhvilluara, SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, etj., janë praktikisht vendet e industrializuara. Tani, meqë fjala “industrializim” nuk tingëllon shumë ëmbël, sepse sjell ndërmend fabrika, uzina, oxhaqe, kompartamente të automatizuara e me radhë, fjala “zhvillim” i neutralizon këto, duke u vetëshpallur njëkohësisht si aspirata e gjithë globit. Vendet e zhvilluara, vendet në zhvillim dhe vendet e botës së tretë (që duhet të rendin drejt zhvillimit). Kështu ndahet bota sipas progresit.

Meqë nuk ka ndonjë shtet mysliman të industrializuar (të zhvilluar) plotësisht, gishti i akuzuesve drejtohet nga Islami, si pengesë e këtij industrializimi apo zhvillimi. Por argumenti është i cekët; të marrim, për shembull, shtete si Ekuadori, Angola, apo Argjentina, që nuk janë shtete me shumicë (apo edhe pakicë) myslimane, por që megjithatë nuk janë vende të industrializuara. Si e shpjegojmë këtë? Nëse ndjekim logjikën e akuzave ndaj

Islamit atëherë duhet t’ia hedhim përgjegjësinë Krishterimit, e në veçanti Katolicizmit në rastin e këtyre tre vendeve. Nëse konsiderojmë ish-Bashkimin Sovjetik, shohim se zhvillimi/industrializimi ndodhi vetëm pasi shteti sulmoi e neutralizoi rolin dhe ndikimin e Kishës Ortodokse. Prapë, me logjikën e akuzave ndaj Islamit, duhet të dalim në përfundimin se ishte feja ortodokse që deri më 1917-ën pat penguar zhvillimin e shtetit modern rus/sovjetik. Në mënyrë të ngjashme mund të flasim për prapambetjen e Kinës si pasojë e rolit e ndikimit të Konfucianizmit e Taoizmit, apo Indisë nga Hinduizmi...

Sidoqoftë, akuza të tilla nuk para dëgjohen, të paktën jo siç bëhet me rastin e Islamit. Prapambetja e Shqipërisë, në fakt e gjithë Ballkanit, i faturohet osmanëve, e rrjedhimisht Islamit. Po prapambetjen e Angolës, Haitit, Perusë, Butanit... kujt duhet t’ia faturojmë? Islami, të paktën deri disa dekada më parë, nuk ka pasur prezencë në këto vende, e kësaj s’mund të jetë përgjegjës për gjendjen e tyre të ashtuquajtur “të prapambetur”, apo “të pazhvilluar”. Atëherë në ç’bazë mund të qëndrojë akuza se Islami na qenka fajtor për prapambetjen e Shqipërisë, e madje gjithë Ballkanit? Nëse s’mund të fajësojmë Katolicizmin për fatin e, për shembull, Angolës apo Filipineve, atëherë s’mund të fajësojmë Islamin për gjendjen e

Shqipërisë. E dyta dhe nuk mund ta anashkalojmë këtë: a është të qenët vend i industrializuar parakusht apo identik me të qenët “i zhvilluar”?

Dy fjalë mbi zhvillimin

Le të zgjatemi e të flasim pak për industrializimin dhe njehsimin e tij me zhvillimin. Në çdo qytetërim me bosht shpirtëroren⁸, me âsht Realitetin⁹ prej të Cilit çdo gjë

8. Nuk flasim vetëm për qytetërimin islam apo të krishterë, por edhe atë budist, hindu, qytetërimet e antikitetit si ato të Egjiptit, Greqisë, Mesopotamisë, Persisë (fé si Zo-roastrianizmi janë akoma të pranishme dhe operative sot), e religjionet arkaike në vende të ndryshme të botës. Nga ky aspekt, siç thotë metafizikani dhe matematicieni René Guénon, qytetërimi i sotëm modern përbën një anomali sepse është i bazuar në linja ekskluzivisht materiale: të shihet, *The Crisis of the Modern World*, trans. Arthur Osborne, Marco Pallis, Richard C. Nicholson (1942), kreu VII.

9. Larmia e religjioneve është shpesh ofruar si argument kundër vërtetësisë së tyre. Ama askush s’mund të argumentojë se, për shembull, fjala ‘libër’ nuk mbart kuptim sepse nuk shkruhet e shqiptohet njësoj në gjuhë të ndryshme. Religjionet janë “gjuhët” e shpalosjes së të Vërtetës në kohë e vende të ndryshme. Veçanërisht për Islamin, shpalljen e fundit, larmia e feve jo vetëm që merret si diçka e qenë, por edhe mbrojtja e tyre është e sanksionuar me ligj (*sheri’at*). Kur’ani përmend mbi 20 profetë me emër e ka mjaft referenca mbi shumësinë e religjioneve, ndërsa Profeti Muhamed ka thënë se njerëzimi ka pasur 124,000 të dërguar. Kjo është temë që kërkon trajtim të veçantë. Për më gjatë, të shihet edhe kreu *Paths that Lead to the Same Summit* (Shtigje që Çojnë Tek e Njëta Majë) në librin nga

buron, përparësia nuk ka qenë tek industria, teknologjia apo armatimi – edhe pse nuk kanë munguar asnjëra – por te krijimi i një hapësire ku njerëzit të mund të punonin e jetonin me vetëdijen e plotë për rrugëtimin e vetëm që ka rëndësi, atë drejt Hyjnore. Në sajë të kësaj përparësie, çdo aspekt i jetës në një qytetërim tradicional, që nga arkitektura e urbanistika, veshja e muzika, ishte e tillë që nuk lejonte harrimin e Zotit, përkundrazi, shërbente për rikujtimin e Tij. Artet tradicionale, që nga poçaria e argjendaria, që nga punimi i armëve te qëndisja – në fakt edhe bujqësia, blegtoaria, praktikisht çdo veprimtari në një qytetërim tradicional, – e gjurmonin zanafillën e tyre te një burim vertikal frymëzimi, te një burim hyjnor. Qoftë, për shembull, në vendet myslimane, qoftë në ato të krishtera¹⁰, esnafët dhe gildat kanë qenë nën patronazhin shpirtëror të një pîri¹¹ ose profeti, duke i dhënë kështu këtyre zejeve e zanateve edhe rolin e një kanali të një hiri e bereqeti hyjnor. Kjo është e mundur, sepse çdo *traditë* është tërësia e parimeve që e lidhin njeriun me Zotin dhe

Ananda K. Coomaraswamy, *The Bugbear of Literacy* (London, 1947).

10. Kjo vlen edhe për vendet budiste, hindu, të antikitetit, etj.

11. *Pîr* do të thotë kryeplak, prijës, dhe zakonisht është titull që shoqëron evliatë, e në veçanti themeluesit e tarikateve. Shih edhe Tahir Dizdari, *Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe* (Tiranë: AIITC, 2005).

me të tjerët, dhe si e tillë tradita buron nga religjioni, e cila buron nga shpallja¹². Në të njëjtën kohë, bukuria është pjesë e pandashme e një arti tradicional, sepse “*Zoti është i Bukur dhe e do të bukurën*”¹³. Puna ishte me vokacion, e në të njëjtën kohë mënyrë për dëlirjen e shpirtit e qasjen ndaj Zotit. Zejtari punon e transformohet nëpërmjet artit të zanatit të vet, ndërsa vegla e punës – qoftë gjilpërë, daltë a çekan, – është tejjzgjatje e gjymtyrëve të tij. Ka një lidhje organike mes veglave e mjeteve tradicionale të punës e atij apo asaj që i përdor ato; mjetet i binden mjeshtrit, i cili me anë të tyre krijon, e në të njëjtën kohë laton vetveten. Kjo, ama, nuk është një interpretim romantik i së kaluarës¹⁴.

Mirëpo industrializimi i punës e përmbysi situatën – thamë se vegla¹⁵, mjeti, i bindet plotësisht

ustait – e kështu makineritë jo vetëm që punojnë vetë e nuk i binden njeriut, por edhe zëvendësojnë punën e tij. Është e vërtetë që prodhimi në masë shumëfishohet, por pakthyeshmërisht në dëm të cilësisë së prodhimit, ndërsa privon njeriun nga punë e zanate që ishin të integruara plotësisht në një univers religjioz e të mbryjtura me kuptim. Industrializimi modern nuk mund të lindte kurrë nga një qytetërim ku vetëdija shpirtërore e popullatës ishte e zgjuar¹⁶; një popullatë e tillë, me një botë të brendshme shpirtërore të pasur nuk mund assesi të prodhojë seritë industriale¹⁷, çfarëdo forme qofshin ato. Nuk është thjesht çështje papunësie, sepse kjo zhvendosje pati (e vazhdon të ketë) të tjera pasoja serioze për njerëzimin.

Kjo përmbysje e përparësive ishte një simptomë e një humbjeje të harmonisë së brendshme të njerëzve, humbje që doemos do të pasqyrohej

12. Shih Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (Albany, NY: State University of New York Press, 1989), kreu II (Çfarë është Tradita?). Vetë fjala ‘traditë’ nënkupton transmetimin (*tradere* në latinisht) e dijeve; ajo nuk d.m.th. një zakon apo besëtytni e mbetur, siç keqinterpretohet rëndom.

13. Hadith i Profetit Muhamed, transmetuar nga Muslimi, 131. Gjithashtu Platoni thotë se “Bukuria është shkëlqim i së vërtetës”.

14. Në lidhje me këtë të shihet eseja nga Ananda K. Coomaraswamy, Why exhibit work of art, *Studies in Comparative Religion*, Vol. 5, No. 3. (Summer, 1971).

15. Shih qasjen mjaft të goditur në lidhje me këtë problem nga filozofi e prifti katolik Ivan Iliç, *Tools for Conviviality* (Harper & Row, 1973).

16. “Njerëzit për nga natyra dëshirojnë të bukurën”, thotë Shën Bazili i Madh (vd. 379 e.s.). Kësisoj mund të thuhet së një qytetërim industrial është i mundur vetëm nga njerëz, natyra e vërtetë e të cilëve është mjegulluar, apo ndryshkur fare, duke u gjymtuar kështu dëshirën dhe aftësinë për të bukurën.

17. Mjafton t’u hidhet një sy qyteteve industriale; çdo gjë është e prodhuar në seri, hyrjet, mobilitet, pllakat. Po ashtu flasim sot për industri arti, muzike, argëtimi, etj. D.m.th., çdo gjë vjen e ambalazhuar dhe pakëtuar. Këtë panoramë industriale, poeti amerikan Thomas. S. Eliot e pat njehsuar me një djerrinë në poemën e njohur me po këtë emër, *Djerrina* (*The Wasteland*, 1922).

edhe jashtë¹⁸. Industrializimi ishte pasojë e kthimit të shpinës nga Perëndimi ndaj Krishterimit Klasik të Mesjetës dhe hyjnizimit të njeriut prometeian¹⁹, i cili harron, e pastaj mohon Qiellin, e i kthehet tokës ta zaptojë atë. Shkurtimisht mund të themi se kolonializmi perëndimor, falë shkencave faustiane²⁰, përfshirë teknologjinë ushtarake, vërshoi e zaptoi pjesën më të madhe të globit. Në pamje të parë ky duket si një triumf, por, në fakt, ky zaptim nuk ishte veç një shpërhapje, një vërshim i jashtëm i atyre njerëzve që donin të mbushnin e të kompensojnë zbrazëtinë e brendshme që kishte kapluar qenien e tyre, “zbrazëtinë në formën e Zotit”, siç do të shprehej Jean-Paul Sartre.

Le të imagjinojmë për një moment një njeri i cili vendos që në palestër të mos kalitë gjë tjetër veç muskujt e krahut, e neglizhon

18. Degradimi i kësaj harmonie do të reflektohej në arkitekturë, art, muzikë, marrëdhënie shoqërore, linguistikë, përfundimisht edhe në ambient, duke e sjellë njerëzimin në buzë të një katastrofe ekologjike.

19. Rreth prometeizmit rilindës, të shihet Nasr, *Knowledge and the Sacred*, kreu V, “Man, Pontifical and Promethean”; dhe Seyyed Hossain Nasr, *Religion and the Order of Nature* (NY: Oxford University Press, 1996), kreu V, “The Tragic Consequences of Humanism in the West”.

20. Te *Faust*-i, vepra madhore e Goethe-s, Fausti hyn në pazar me Mefistofelin, një demon, duke shkëmbyer shpirtin e tij për dije që do t’i jepte mbisundim mbi natyrën.

krejtësisht pjesën tjetër të trupit. Kjo soj kalitjeje është, në fakt, gjymtim sistematik, e herët a vonë trupi i një njeriu të tillë do të ketë disa muskuj jashtëzakonisht të zhvilluar, e pjesën tjetër të lënë pas dore – me pak fjalë një karikaturë. Është e vërtetë se muskujt e tij të krahut janë më të zhvilluar se ato të njerëzve të tjerë, por pjesa tjetër e trupit është në gjendje të vajtueshme.

Nëse e vazhdojmë më gjatë analogjinë, kështu është edhe me botën moderne sot; e gjithë vëmendja ka shkuar te zhvillimi i ‘muskujve të krahut’, te zhvillimi i teknologjisë e industrisë, në dëm të çdo gjëje tjetër. Ndërkohë trumbetarët e kësaj “mrekullie” nuk reshtin së na kujtuari se kjo duhet të jetë aspirata e njerëzimit, gara e teknologjisë e industrisë, e “zhvillimit”; pra të gjithë duhet të braktisin kalitjen e gjithë muskujve përveç atyre të krahëve. E në fakt kështu ka ndodhur; bota myslimane, e në fakt edhe pjesa dërrmuese e vendeve të botës, kanë flakur kalitjen e harmonisë për kalitjen fragmentare²¹. Fakti që qytetërimet predomoderne, të latuara nga botëkuptimi përkatës religjioz, me shekuj e patën ruajtur këtë harmoni, duke i vënë kufi

21. “[q]ytetërimi perëndimor është si një makinë në përshpejtim, që rend vërtik për në greminë dhe... bota myslimane po mundohet me sa forcë që ka që të mos i mbetet pas, e pavetëdijshme se kështu po i garanton vetes shkatërrimin”, Chittick, *Shkencë e Kozmosit*, f. 30.

qasjeve e shpërhapjeve fragmentare, denigrohet nga arsimi e mediat moderne si fazë e papjekur apo e pazhvilluar e njerëzimit.

Por, siç thotë edhe autori britanik Charles Gai Eaton, ky qëndrim që një soj ledhi rrëzë shkëmbinje²² buzë honit. Falë idesë së teuhīdit, Unitetit Hyjnor, që u qëndron myslimanëve si një diell dëshmues mbi kokë, e në krahasim me të cilin çdo gjë tjetër është një hije e zbehtë, rezistenca ndaj “zhvillimit” mund të thuhet se ka qenë edhe më e fortë se në religjionet e tjera. Kujtojmë se Islami është shpallja e fundit, domethënë edhe më e reja, e me shumë gjasë, providencialisht, edhe më e vështira fé për t’u sfiduar nga fetë e reja të *-izmave* e “progresit”. Duke këmbëngulur te harmonia e brendshme dhe e jashtme, harmonia me Zotin e me të tjerët, Islami ka ngadalësuar rrokullisjen e njerëzimit në hon, nëse përdorim analogjinë e z. Eaton. Atëherë, si mund të akuzohet Islami²³ se është pengesë e

22. Shih Gai Eaton, *King of the Castle: Choice and responsibility in the modern world* (Cambridge: Islamic Texts Society, 1991), f. 150.

23. Në fakt, jo veç Islami, por asnjë religjion s’mund të akuzohet si pengesë progresi; gjithmonë nëse flasim për progresin e vetëm që ka rëndësi, atë drejt Zotit, drejt Origjinës prej nga ka ardhur çdo gjë e do të kthehet. Ideja e progresit siç trumbetohet sot s’është tjetër veçse projektimi (i përçudnuar) horizontal i aspiratës vertikale të njeriut drejt Qiellit, Parajsës. Është ironike që disa të krishterë në Shqipëri thërassin shqiptarët

“zhvillimit”, kur ky “zhvillim” është galopi drejt vetëshkatërrimit?”

Megjithatë, dëmet e mësymjes e infiltrimit të *-izmave* e lloj-lloj ideologjive progresiste në universin e Islamit – e çdo religjioni tjetër në fakt – kanë qenë të pallogaritshme. Narrativi i apologjetëve myslimanë modernë e dëshmon këtë, narrativ i cili merr forma të tilla si: Islami ka vlerë sepse i dha Evropës dijen e antikitetit, pa të cilën s’do të kishte Rilindje Evropiane, pa të cilën s’do të kishte Perëndim modern; ose, Kur’ani është i vërtetë sepse ky apo ai varg kur’anor përkon me këtë apo atë zbulim a teori shkencore, e të tjerë shembuj të ngjashëm. Këto qëndrime finalizohen me përkrahjen pothuajse pa kushte të çdo gjëje që konsiderohet “moderne” apo e “kohës”.

Mirëpo, çdo gjë që e karakterizon modernitetin, nuk mund të thuhet assesi se është teuhīdi, kryeparimi i të menduarit islam; në fakt, është krejt e kundërta²⁴. Patjetër, ky karakterizim përfshin edhe shtetet moderne, të cilat janë të bazuara në këto premisa, e në veçanti atë të zhvillimit. Siç shprehet edhe prof. Chittick: “Veçanërisht habitëse ... është shkalla me të cilën myslimanët

drejt Perëndimit me shpresën, si duket, se kështu po i thërassin drejt Krishterimit. Pak kthjelltësi do të mjaftonte për të shikuar absurditetin e një ftese të tillë.

24. Për një përshkrim më të detajuar të këtij karakterizimi të modernitetit të shihet Chittick, *Shkencë e Kosmosit*, f. 48-51.

duket se mendojnë që shtetet moderne mund të imponojnë një rend islam, me aftësinë e tyre të paparë historike për të indoktrinuar e shtrënguar. Vetë përpjekjet për këtë tregojnë qartë se një shoqëri “islame” mund të kthehet kollaj në thjesht një tjetër version të totalitarizmave të përbindshëm, aq karakteristike për botën moderne”²⁵.

Këto qëndrime në shumë myslimanë sot nuk janë tjetër veçse simptoma të një ndjesie të thellë inferioriteti ndaj teknologjisë e “zhvillimit”. Ky inferioritet është i mundur falë neglizhimit e mosnjohjes së traditës së stërpasur intelektuale islame – traditë që është e aftë t’u japë përgjigje sfidave intelektuale që moderniteti i ka vënë përpara Islamit²⁶ – dhe nga mosnjohja e natyrës dhe premisave të shkencës moderne²⁷.

25. *Po aty*, f. 52-53.

26. Po ashtu, njohja e traditave intelektuale e shpirtërore simotra në religjione të tjera u mundëson atyre mburojë diturore të ngjashme. Ajo hedh dritë mbi të vërtetat metakohore e metakozmike, pakrahasueshmërisht superiore ndaj kontingjencave të ndryshme, e kështu mundëson rrugëtimin drejt Hyjnore dhe shpëtimin e shpirtit – *raison d'être* e çdo religjioni. Fakti që në qarqe të ndryshme fetare ka një angazhim të mbitepruar në modifikimin e realiteteve fragmentare historiografike e politike, për fat të keq, dëshmon një ngatërrim përparësish; diçka që s’mund të jetë kurrë pa pasoja.

27. Të shihen Fatos A. Kopliku (2015), *Diktatura e Sasisë, Zani i Naltë, nr. 12*, f. 18-35; *Science and the Myth of Progress*, ed. Mehrdad M. Zarandí (IN: World Wisdom,

Nuk është rastësi që kritikrat më të mprehta të modernitetit kanë ardhur fillimisht e kryesisht nga vetë perëndimorët. Falë përjetimit më të gjatë mbi kurriz të modernitetit, në krahasim me pjesën tjetër të botës, ata janë më të vetëdijshëm se shumë nga problemet që përballet bota moderne sot burojnë nga premisat e modernitetit e aplikimet e tij, qoftë në fushat shkencore, sociale, politike, etj.

Është me vend të kujtojmë një fjalim nga Dr. Martin Lings në Universitetin e Kajros në vitin 1964, ku mes të tjerash thotë:

I kemi dëgjuar shumë herë gjatë kësaj konference fjalët “zhvillim” (tetawwur) dhe “progres” (tekaddum), “ripërtëritje” (texhdîd) dhe “renaissance” (nendeh), dhe them nuk do të qe kohë e humbur të ndaleshim pak dhe t’i bënim një shqyrtesë kuptimit të tyre. “Zhvillimi” nënkupton shkaputje nga parimet; dhe ndonëse është e nevojshme të lëvizim nga parimet në një largësi të caktuar me qëllim që t’i zbatojmë ato, është e një rëndësie jetike të mbetemi pranë tyre aq sa marrëdhënia me ta të jetë plotësisht efektive. Zhvillimi, që këtej, kurrë s’duhet të kapërcejë këtë pikë. Pararendësit tanë qenë fort të vetëdijshëm që kjo pikë rreziku është arritur në Islam qindra vjet më parë; dhe për ne, që jemi kaq vonë

nga komunitetit ideal i Profetit dhe shokëve të tij, rreziku është krejt më i madh. Atëherë, si mund t'ia lejojmë vetes të mos jemi të vëmendshëm? Si mund të mos kemi frikë se po e rrisim largësinë nga parimet aq sa zhvillimi të bëhet degjenerim? Njëmend mund të shtrohet pyetja gjithë sa i përket asaj që me krenari shpallet sot si zhvillim: a nuk është në fakt degjenerim?²⁸

Përmbysje përparësish...

Shumë nga problemet me të cilat Shqipëria përballlet sot – politikisht, ekonomikisht, e si shoqëri – janë pasojë e komunizmit; faturat e asaj periudhe vazhdojmë akoma t'i paguajmë. Çfarë është edhe më tragjike është nostalgjia për regjimin komunist sepse “kishte rregull”, siç shprehen rëndom disa. E vërtetë, ka pasur rregull, por kjo ishte në sajë të brezit paraardhës, të mburjtur direkt apo indirekt me praninë e Islamit e Krishterimit, duke lënë kështu një sasi vlerash si trashëgimi. Ashtu sikurse pasuria shekullore e një familjeje mund të bëhet rrush e kumbulla në duart e një pasardhësi plëngprishës. Me lindjen e rritjen e “njeriut të ri, veprës më të ndritur

28. Martin Lings (Abû Bakr Sirâj ad-Dîn), *Funksioni Shpirtëror i Qytetërimit*, shqip. Vehap Kola. <http://vehapskola.blogspot.com/2013/03/funksioni-shpirtëror-i-qteterimit.html>. Origjinali: *The Spiritual Function of Civilization, Studies in Comparative Religion*, Vol. 2, No. 4. (Autumn, 1968).

të partisë”, kjo trashëgimi vlerash sa erdhi e u pakësua. Personalisht, do të argumentoja se vlera që u dëmtua më tepër ishte respekti ndaj së vërtetës, në kuptimin më të plotë.

Sipas kozmologjisë tradicionale islame, kozmosi mbahet në katër “shtylla” Hyjnore, të cilët janë katër Emrat parësorë: I Gjalli (*al-Hajj*), I Gjithëdituri (*al-'Alim*), Dëshiruesi (*al-Murid*), i Fuqishmi (*al-Kâdir*). “Zoti e krijon gjithësinë me anë të fuqisë, por Ai kurrë nuk ushtron fuqi pa e dëshiruar këtë, çka do të thotë se në gjithësi nuk ndodh kurrë diçka arbitrare ose e pakuptimtë. Ai nuk mund të dëshirojë diçka pa e njohur më parë, kështu që dijes i paraprin gjithëdija. Dhe dija varet nga jeta.”²⁹ Pra, ka një përparësi edhe në Emrat Hyjnorë, të cilët diktojnë edhe hierarkinë e natyrës së gjërave, ashtu siç e do Vetë Zoti. Pushteti apo fuqia, ushtrohet në sajë të vullnetit, i cili ushtrohet në bazë të dijes, e cila doemos varet nga vetë jeta. Kur kjo hierarki nuk respektohet, kur gjërat nuk vihen në vendin e tyre, doemos që nuk mund të pritët të mos ketë pasoja.

Gjatë regjimit komunist, shteti

29. William C. Chittick, *Ibn Arabiu, Trashëgues i Profetëve*, shqip., parath. & shën. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2012), f. 94. Të shihet Ibn el-'Arabi, *el-Futuhâtü l-Mekkiyye* (Hapjet Mekase), IV 228. 12, 18, cit. nga William C. Chittick, *Sufi Path of Knowledge: Ibn al-'Arabi's Metaphysics of Imagination* (NY: State University of New York Press, 1989), f. 49.

i kushtëzoi qytetarët e vet t'i binden autoritetit, pra pushtetit – me dhunë, propagandë mediatike e me arsim. Shumëkush që guxoi të mendonte ndryshe, që sfidoi legjitimitetin e kësaj ngrehine pushteti të ngritur për hatër të pushtetit, përfundoi pas hekurash, apo edhe u eliminua fizikisht. Vullneti, dituria, vetë jeta e njerëzve, pritej që të ishte në shërbim të partisë, pra pushtetit. Nga pikëpamja e kozmologjisë tradicionale islame, kjo qasje ishte në thelb padrejtësi, sepse e përmbys hierarkinë e natyrës së gjërave³⁰. E nga padrejtësia s'mund të dalë asgjë e mirë.

Siç e thamë, çdo gjë duhet të ishte në shërbim të pushtetit: historia, arti, teknologjia... Do të ndalemi pak te historia ngaqë është direkt e lidhur me temën tonë. Narrativi i historiografisë zyrtare ishte pak a shumë ky: shqiptarët kanë pasur një komb-shtet që nga lashtësia, por që ndodhi çfarë ndodhi para rreth njëzet e dy shekujsh erdhën romakët që shkatërruan 70 qytete³¹ e morën

30. Kjo përmbysje përparësish e vlerash, me gjithë pasojat që vijojnë, mund të ndodhë në rang individual, shoqëror, apo institucional, e jo vetëm në rang shtetëror.

31. Shifrat janë të pabesueshme kur kujtojmë se as sot nuk i kemi 70 qytete në Shqipëri, e jo më të ishin në antikitet. Megjithatë, as gëk as mëk intelektual nuk dëgjohej nga shqiptarët në ato kohë, qoftë nga mediokriteti i shumë studiuesve, qoftë nga frika e pasojave që rrinin varur si shpata e Demokleut mbi kokat e njerëzve.

150 mijë skllëvër, e na robëruan për 500 vjet. Pas disa shekujsh; dhe e gjejmë Shqipërinë (në Mesjetë!³²) të pushtuar nga bizantinët, të cilët po ashtu na robëruan edhe 500 vjet të tjera. Pastaj i erdhi radha turkut, që ishte deri diku më barbari i klubit të pushtuesve 500 vjeçarë. Më vonë erdhi pavarësia që s'mund t'i plotësonte ëndrrat e shqiptarëve, mbretit Zog nuk iu kursyen shumë epitete, erdhën italianët fashistë e gjermanët nazistë, dhe në fund, në fund fare, erdhën komunistët që mrekullisht plotësuan të gjitha aspiratat që shqiptarët kishin pasur. Është e pamundur të mos pikaset nota e theksuar teleologjike e kësaj historiografie; historia jonë ka pasur një synim, të cilin përfundimisht e përmbushi partial!³³

Në këtë rrefim, “periudha e errët” osmane luajti rol kryesor si antiteza e shpëtimtares parti apo shpëtimtarit udhëheqës. Demonizimi sistematik i trashëgimisë osmano-shqiptare ishte sfondi karshi të cilit shteti komunist

32. Komb-shteti është një ide që lindi vetëm pas Revolucionit Francez (1779) dhe është pavend supozimi se kishte një Shqipëri apo Itali në Mesjetë, qoftë fizikisht në hartë, qoftë në mendjet e njerëzve. Sidoqoftë, ky supozim merret si i qenë dhe mbretëron në çdo tekst shkollor e më gjerë.

33. Ky qe një tjetër absurditet përderisa qëndrimi zyrtar ndaj historisë pretendonte të ishte materialist – ku të vetmit faktorë në konsideratë janë influencat e ndërthurjesh politike, shoqërore, ushtarake – e nuk ka vend për teleologji, për synim apo qëllim të historisë.

krahasoi e glorifikoi veten³⁴. Mirëpo kjo retorikë nuk ka sosur dhe ka pasur përpjekje sistematike për ta mbajtur të kaluarën islame në pozitë që e vendosi komunizmi, ndërsa është sjellë Krishterimi në vendin e synimit që paskan pasur shqiptarët, synim ky që na është penguar nga “aksidenti historik” i osmanëve. Prapë, togfjalëshi “aksident historik”, i ndeshur rëndom, kundërmon teleologji, sepse nënkupton një udhë a synim drejt së cilës shqiptarët ishin nisur dhe ndodhinë e një aksidenti që i frenoi apo çoi në tjetër rrugë. Përsëri, historia jonë vazhdon të ketë një synim, të cilin e përfundimisht do ta përmbushë, këtë radhë, pranimi në familjen evropiane! Ndërkohë ri-konvertimi i shqiptarëve në Krishterim ofrohet si kusht për arritjen e këtij synimi që na e ndërpreu Islami. Le të komentojmë pak mbi këtë hamendje.

Pikësëpari duhet të kuptohet se komunizmi nuk do të mund të zinte vend aty ku Islami ishte plotësisht i shëndetshëm, por zuri vend ngaqë pozita e Islamit u godit sistematikisht nga faktorë të brendshëm e të jashtëm, diskutimi i të cilëve do të na largonte nga tema. Minimi i kësaj pozite të Islamit ishte njëkohësisht minim i pozitës së Krishterimit shqiptar, i cili, ndryshe nga ai

34. Libri i studiuesit Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja* (Tiranë: Dudaj, 2003) e dokumenton dhe argumenton qartë këtë.

perëndimor, kishte mbetur relativisht i pacenuar falë pranisë mbrojtëse të Islamit. Kjo është e kundërta çka u është servirur shqiptarëve si histori – kujtojmë formulën “ku shkel turku nuk mbin bari” – por dëshmitë flasin ndryshe. Metafizikani dhe studiuesi i pashoq i religjioneve Frithjof Schuon shprehet kështu: “...në Kishën Latine fatkeqësia erdhi nga antikiteti pagan, i cili që neutralizuar vetëm pjesërisht... në Kishën Lindore fatkeqësia erdhi, as nga turqit që pushtuan Ballkanin, as nga mongolët që pushtuan Rusinë, por nga lëvizjet autoktone laike, të cilat me tendencat e tyre materialiste e nacionaliste e shtypën Kishën. Nëse sundimi aziatik ishte fatkeqësi për laikët, ai ishte mburojë për jetën e brendshme të Kishave...”³⁵ Kujtojmë, gjithashtu, se Islami është e vetmja fé, që e ka të dekretuar me ligj mbrojtjen e feve të tjera. Ka mjaft shembuj që ilustrojnë praninë mbrojtëse të Islamit për fetë e tjera³⁶, e nuk flasim duke pasur

35. Frithjof Schuon, *Spiritual Perspective and Human Facts*, trans. Macleod Matheson (London: Faber and Faber Limited, 1954), f. 67 (përkthim i autorit).

36. Të shihen Thomas W. Arnold, *The Preaching of Islam: A History of the Propagation of the Muslim Faith* (London, 1913). Në veçanti kreu VI flet për ardhjen e osmanëve në Ballkan dhe trajtimin e popullatës nga ana e tyre; Genti Kruja (2015), *Toleranca në Fermanet e Shtetit Osman ndër Shqiptarët, Zani i Naltë, nr. 9*, f. 54-56. Gjithashtu, pak javë më parë iu dhurua edhe një delegacioni zyrtar shqiptar në Jeruzalem një kopje nga një ferman i kalifit të dytë të Islamit, Omerit,

parasysh vetëm anën ekonomike apo ushtarake, por edhe strehë nga mësymja e *-izmave* që filluan në Perëndim³⁷ qysh me Rilindjen. Roli i Krishterimit nuk u marginalizua në Perëndim nga Islami, por nga faktorë të brendshëm me prirje materialiste e sekulare, siç u tha edhe më lart nga Schuon-i.

Mirëpo, injoranca apo indiferenca sistematike e dëshmime dhe përsëritja në mënyrë monotone e kallëpeve të historiografisë komuniste në lidhje me Islamin (e jo vetëm) vazhdon akoma. Kjo është sikur dikush të përsërisë herë pas here se 1+1 bëjnë 3, dhe pastaj të konkludojë se nga fakti i shumë-përsëritjes së këtij pohimi atëherë 1+1 duhet të bëjnë 3. Kjo metodë ishte e “suksesshme” gjatë monizmit sepse pasojat e moskonformimit ishin

i cili u garantonte të krishterëve mbrojtje dhe lirinë e besimit. Fermanë të tillë janë shkruar nga sundimtarë myslimanë që nga Fatih Sulltan Mehmeti në Ballkan te Shah Akbari në subkontinentin indian.

37. Ky pohim është pjesërisht i vlefshëm sot ngaqë ka dëshmi të qarta që ideologji profane, me një petk religjioz, kanë depërtuar edhe Islamin, duke ofruar zgjidhje që janë kryekëput në kundërshtim me mësimet themelore të tij: “Kur’ani i urdhëron vazhdimisht besimtarët të kenë besim te Zoti, dhe qëndrimi i të besuarit te mëshira e Zotit e mbush botëkuptimin tradicional. Përkundrazi, ideologët dhe fundamentalistët u kërkojnë myslimanëve të kenë besim në vegimin utopik, teknologjinë ushtarake dhe zbatime centraliste, të detyruara, të Sheri’atit.” Chittick, *Shkencë e Kosmosit*, f. 110.

tepër serioze. Me anë të kërcënimit, direkt apo indirekt, komunistët mundën të krijonin njëzëri pak a shumë një opinion publik uniform – me ndihmën doemos edhe të Akademisë së Shkencave, të cilën e krijuan vetë për fabrikim opinioni.

Stafeta e neglizhimit të vërtetës nuk duhet kaluar dorë më dorë, duke vazhduar kësisoj kultivimin e mëtejshëm të “njeriut të ri nr. II”, që synon shpëtimin e përparimin e kombit me anë të “kthimit te feja e të parëve”, duke nënkuptuar në veçanti Katolicizmin. Siç edhe e përmendëm, ky kthim serviret pothuajse në rangun e një ligji natyror, i shoqëruar me aspiratat për t’u bërë pjesë e “familjes evropiane”³⁸, që nuk do të thotë tjetër, por pranimi në klubin e të “fortëve” ekonomikë, politikë, ushtarakë e me radhë. Vështirë të gjendet argument më anti-kristian e më anti-religjioz në përgjithësi. Profetët, urtarët e shenjtorët e feve në shekuj, kanë ftuar njerëzit në gjirin e një religjioni për t’u shpëtuar shpirtit, sepse adhurimi është gjendje normative e të qenët, mënyra e vetme që lejon njohjen e gjërave ashtu siç janë e jo siç duken. Asnjë figurë shpirtërore s’ka ftuar njerëz në fë për t’u pranuar në aleanca ushtarake apo unione politike e

38. Është e vështirë të mos mendosh se ç’nënkuptohet me këtë: a jemi ne shqiptarët pa familje, jetimë, apo i përkasim ndonjë familjeje aziatike e afrikane e duam të adoptohemi nga familja evropiane?

tregtare. Një Klement i Aleksandrisë, një Shën Agustin apo një Shën Toma D'Akuin do të kthehej përmbys në varr nëse do të dëgjonte një ftesë të tillë për në fenë e Krishtit.

Autori i këtyre rreshtave nuk pretendon assesi të marrë përsipër se si duhen ftuar njerëzit në Krishterim, apo në cilëndo fé qoftë, por kushdo që ka njohuri minimale mbi veprat e disa prej kolosëve intelektualë e shpirtërorë të Krishterimit dhe respektin e sinqertë ndaj një religjioni autentik, nuk mund të pranojë argumente të tilla në heshtje. Gjithashtu duhet përmendur se realiteti i Krishtit, si çdo figurë tjetër madhore shpirtërore, ka një dimension metahistorik, që del përtej caqeve të kohës³⁹; diçka që si duket është harruar. Ky thelb që nuk duket është gjithmonë shumë më i rëndësishëm se lëvozhga, qoftë kjo në formën e dinamikave historike,

39. “Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishte lindur Abrahami, unë jam” (Gjoni 8:58); ose Profeti Muhamed thotë, “Isha profet kur Ademi ishte mes ujit e baltës” ose mes “shpirtit e trupit” (Tirmidhiu, Manakib I; Ahmed VI 66, V 59, 379) – në lidhje me këtë hadith shih edhe komentin nga Ibn al-‘Arabi, *Futūbāt*, I, 243; III, 141. 7; Për çfarë flitet në pohime të tilla? Doemos që flitet për të vërteta përtej kontingjencave historike, theksi mbi të cilat, paradoksalisht, është shtuar së tepërmi, diçka që s’mund të ndodhë pa një mungesë kthjelltësie, parakusht i ngatërimit të përparësive. Kur kjo ndodh, rrëmuja e brendshme domosdo do të pasqyrohet së jashtmi.

shoqërore, demografike e kulturore – kjo s’duhet harruar.

Të tjera “njolla” dhe institucionalizimi i trashësisë

Një “njollë” tjetër e Islamit në Shqipëri vjen në formën e etiketimit të trashëgimisë së tij thjesht si një kopje e dorës së sytë e artit e kulturës bizantine. Ama pohime të tilla kanë sjellë përballje me situata të sikletshme paradoksale. Marrim si shembull arkitekturën e periudhës osmane. Me gjithë shkatërrimin në masë të trashëgimisë arkitekturore myslimane shqiptare⁴⁰, për mrekulli mbijetuan në gjendje relativisht të mirë, si dëshmi e kësaj trashëgimie, lagje të tëra në Berat, Gjirokastër, në pazar të Krujës dhe po ashtu në disa qytete të Kosovës e Maqedonisë. Në veçanti Berati e Gjirokastra janë deklaruar si pjesë e trashëgimisë së njerëzimit edhe nga UNESCO-ja⁴¹. Nëse është e vërtetë se ishim për 500 vjet në “errësi”, atëherë

40. Fshirja e trashëgimisë arkitekturore e artistike islame e pastaj pretendimi se Islami na la në errësi ngjason shumë me praktikatat mafioze kur një dëshmitar eliminohet fizikisht duke hapur mundësinë për sajimin e një skenari apo historie sipas midesë së mafiozit. Shkatërrimi sistematik i trashëgimisë kulturore osmano-shqiptare, dëshmi vlerash të pakundërshtueshme, ishte parakusht i përcmimit historiografik të saj.

41. Ato janë me vlerë, prandaj janë përfshirë në listën e UNESCO-s. Te një numër jo i vogël shqiptarësh logjika është e kundërt; qyteteve tani po u njihet vlera sepse janë njohur nga UNESCO-ja.

si është e mundur që trashëgimia arkitekturore myslimane e periudhës osmane ka vlerë të padiskutueshme? Siç thotë edhe Krishti, “Ju do t’i njihni nga frytet e tyre. A vilet vallë rrush nga ferrat ose fiq nga murrizat?”⁴² Kësisoj, është e vështirë të pretendohet, logjikisht, se një qytetërim i errët, barbar e pa vlera, prodhon bukuri e harmoni në hapësirë, siç dëshmohet nga arkitektura⁴³ e lagjeve tradicionale myslimane të Beratit, Gjirokastrës apo Prizrenit. Apo vërtet mund të vilet rrush nga ferrat e fiq nga murrizat?

Nëse dikush kërkon të kundrojë botën e brendshme të një myslimani a myslimaneje tradicionale të gdhendur nga hiri e bereqeti islam, mjafton të kundrojë Xhaminë e Et’hem Beut, Xhaminë Blu në Stamboll, Taxh Mahalin në Agra të Indisë, apo sarajet e Alhambrës në Granadë të Spanjës. Nëse dikush kërkon në botën e brendshme të njerëzve të latuar nga nacional-komunizmi, mjafton t’u hedhë një sy parafabrikeve, pallateve, e godinave, që nga republikat sovjetike deri në Ballkan. Ironia

42. Mateu 7:16

43. Ne morëm si shembull arkitekturën, por gjurmët e artit islam gjinden edhe në poezi, muzikë, veshje, etj. Kujtojmë se manifestimet dhe shpalosjet më të qarta e të kthjellta të doktrinës së Islamit gjinden në artin tradicional islam. Të shihet Titus Burckhardt, *Arti i Islamit: Gjuba dhe Kuptimet*, shqip. Vehap Kola (Shkup: Logos-A, 2012).

qëndron në atë se frytet e artit⁴⁴ e arkitekturës myslimane shqiptare nacionalizohen, ndërsa pema e cila dha këto fryte, Islami, demonizohet. Diçka e tillë mund të quhet me të vërtetë “institutualizim i trashësisë”. Nuk e kemi fjalën për “trashësinë” në kuptimin zhargon të saj, por për mbulimin e kthjelltësisë, e tejdukshmërisë intelektuale – trashjes me anë shtresash palë-palë argumentesh e interpretimesh të pasakta – në mënyrë sistematike me anë të librave, teksteve shkollore, kumtesave, dokumentarëve, etj.

Tentativat për të shpjeguar artin islam thjesht si produkt i një konglomerati huazimesh – hebraike, bizantine, hindu, etj. – nuk kanë munguar dhe hamendësime të tilla janë paraqitur çuditërisht si teori të padiskutueshme. Mirëpo, çfarë është e pamundur të shpjegohet logjikisht është se si ka mundësi që kopjacë të zellshëm, papritmas, nuk krijuan art e arkitekturë bizantine të dorës së dytë, në rastin e Ballkanit⁴⁵, por krijuan diçka rrënjësisht origjinale që dallon qartë nga burimi i supozuar i huazimeve?! Shpjegimi shpaloset natyrshëm para nesh nëse njohim praninë e Hirit Hyjnor të një shpalljeje, e cila transformon e gdhend botën e brendshme të bashkësisë

44. Kjo është temë më vete, por mund të themi se e njëjta pyetje vlen edhe për muzikën, veshjtjen, artizanatin, poezinë, etj.

45. Ose art hindu në Indi, apo art zoroastrian në Persi, e kështu me radhë.

së besimtarëve, transformim që domosdo manifestohet në forma nga më të larmishmet në kohë e vende të ndryshme. Arkitektura tradicionale islame e Egjiptit, për shembull, është e ndryshme nga arkitektura tradicionale islame e Ballkanit, Persisë ose Malajzisë, ama secila rrezaton larminë që lind nga një burim, *teuhīdī*. Nga ky kënd, është e qartë se arti e arkitektura islame, pavarësisht nga largësia gjeografike apo ndarja kohore, mbesin pagabueshmërisht të tilla. Xhamia Mbret në Berat është shumë më e ngjashme në thelb me një xhami në Indinë Mugale sesa me Kishën e Shën Triadës në Kala të Beratit. Mund të sillen plot shembuj të tjerë që e ilustrojnë këtë argument.⁴⁶

Një tjetër “njollë” është prejardhja dhe origjina jo-shqiptare e disa familjeve myslimane, që është servirur rëndom si dëshmi për “përzierjen e gjakut të pastër arbëror”. Nuk ka akoma as edhe një vërejtje a akuzë (fatmirësisht) ndaj faktit se Pjetër Marubi, për shembull, mjeshtri i fotografisë, ishte me origjinë italiane, jetoi e vdiq në Shkodër. Nga ana tjetër qëndrimi ndaj pranisë së familjeve myslimane me origjinë turke (apo kudo nga Lindja) nuk ka qenë aspak

46. Të shihen edhe Seyyed Hossain Nasr, *Islamic Art and Spirituality* (State University of New York Press, 1987), Jean-Louis Michon, *Introduction to Traditional Islam* (IN: World Wisdom, 2008).

i tillë; nëse do të thoshim se jo rrallë është derdhur vrer, nuk do të ishte larg së vërtetës. Sidoqoftë, kjo është një mendjengushtësi e cila dëmin më të madh ia shkakton atyre që ia lejojnë vetes të shprehen në këtë mënyrë dhe nuk meriton vëmendje më shumë. Çfarë ka rëndësi është sqarimi i kësaj larmie origjinash, veçanërisht në qendrat urbane.

Është esenciale të kuptohet se komb-shtetet moderne kanë shumë ndryshime themelore nga ato premoderne; në veçanti, parimet mbi të cilat mënyra e sundimit të qeverisjes⁴⁷ dhe vlerat që gdhendin organizimin e shoqërisë. Gjithashtu, shtetet premoderne kanë qenë nga natyra shumëkombëshe dhe shumetnike, e në veçanti perandoritë, me shtrirjen e tyre të gjerë. Një nga këto perandori⁴⁸ ka qenë edhe ajo osmane, e cila shtrihej në tre kontinente dhe kishte mbi tridhjetë grupe etnike brenda kufijve të saj: turq, shqiptarë, serbë, boshnjakë, hebrenj, grekë, libanezë, armenë, egjiptianë, e kështu me radhë. Që nga brigjet e Adriatikut një njeri mund të udhëtonte në brigjet e Afrikës Veriore apo ato të Detit të

47. Të shihet, p.sh., Jean Hani, *Sacred Royalty: From the Pharaoh to the Most Christian King*, trans. Gustavo Polit (London: The Matheson Trust, 2011); një studim mbi natyrën e monarkive dhe familjeve mbretërore në vende e periudha të ndryshme historike.

48. Perandoritë romake, perse, bizantine, arabe, kineze, etj., janë gjithashtu të ngjashme në këtë drejtim.

Kuq pa pasur nevojë për lejekalim⁴⁹. Fakti që në shumë qendra urbane të perandorisë osmane ka pasur shumë kombësi s'është aspak e çuditshme. Tregtia ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm në lëvizjen e njerëzve, mallrave, ideve, kulturës, artit. Po ashtu administratorët e ushtarakët⁵⁰ e lartë bashkë me familjet e tyre kanë ndërruar krahinë ose qytet rregullisht. Fakti që një turk si Hasan Riza Pasha, mbrojtësi i Shkodrës, u lind në Bagdad, apo Mehmet Ali Pasha, një shqiptar nga Kavalla, ishte vali i Egjiptit (e më vonë mbret), ose Vaso Pasha, një shkodran, ishte guvernator i Libanit, ishte diçka më se normale. Shembuj të ngjashëm ka plot edhe ndër tregtarë, artistë, zejtarë, etj. Në kujtimet e veta, për shembull, Eqrem bej Vlora shkruan për dhjetëra shqiptarë që punonin e banonin anembanë perandorisë, të cilët i takoi gjatë udhëtimeve të tij, aq sa edhe shprehet: "A ka ndonjë cep të Perandorisë Osmane ku të mos ketë shqiptar?"⁵¹ Një perandori

49. Diçka deri diku e ngjashme me këtë, për sa i përket shtrirjes së territorit dhe larmisë së kombësive, do të ishte SHBA, ku distancat nga New York-u në Florida, apo nga Detroit-i në Kaliforni janë me mijëra km dhe kombësitë e grupet etnike janë nga më të ndryshmet. Situata të ngjashme hasen edhe në Kinë apo Indi, shtete që kanë trashëguar trojet e mbretërive e perandorive premoderne bashkë me larminë etnike të tyre.

50. Ushtarakët kanë lëvizur gjithmonë, edhe sot, jo vetëm gjatë perandorisë.

51. Eqrem bej Vlora, *Kujtime: 1885-1925*,

si ajo osmane ishte për nga natyra shumëkombëshe dhe qytetarët e saj kishin të drejtë të jetonin, punonin, tregtonin, kudo që mund ta shihnin të arsyeshme apo të nevojshme. Pikërisht për këto arsye, për shembull, një nga lagjet kryesore të Stambollit edhe sot e kësaj dite mban emrin Arnavutköy, apo ka akoma fshatra në Turqi ku flitet shqip, pa përmendur fare qytetarët turq me origjinë shqiptarë⁵², numri i të cilëve është mjaft më i madh.

Ndërsa krenohemi me këtë panoramë të historisë, duke e çmuar aftësinë e shqiptarëve për të jetuar e punuar mes viseve e popujve nga më të ndryshëm, mbetet mjaft e çuditshme se si studime të çmueshme si ai i Hamdi Bushatit, *Shkodra dhe Motet*⁵³, ku mes të tjerash i kushtohet një kapitull prejardhjes së huaj të disa familjeve në Shkodër, instrumentalizohen si pretekst për të dëshmuar "ndotjen" e gjakut të dëlirë arbëror, sikur prejardhja jo e duhur na qenka krim. Shtegtimi, emigrimi, lëvizja e njerëzve, është pjesë e natyrshme e historisë së njerëzimit, pavarësisht nga vendi dhe epoka. Sipas logjikës së akuzave të tilla, shqiptarët që kanë lëvizur e janë vendosur edhe sot në Evropë,

përk. Afrim Koçi (Tiranë: Botimet IDK, 2003), f. 121.

52. Jo vetëm origjinë shqiptarë, por edhe boshnjakë, çerkezë, bullgarë, grekë, etj.

53. Hamdi Bushati, *Shkodra dhe Motet II* (Shkodër, 1999), kreu VI.

Amerikë, a kudo qofshin, kanë “ndotur” gjakun e dëlirë anglez, francez, gjerman, amerikan... “ndotje” kjo që do të mbetet aty, qoftë edhe me shekuj.

Në vend që prejardhja e huaj e disa familjeve shkodrane e shqiptare të shihet si dëshmi e pranisë së një dinamike të shtresuar, qoftë demografike, qoftë kulturore, qoftë artistike, qoftë tregtare, në trojet shqiptare gjatë Perandorisë Osmane, ajo është parë nga disa si “njollë” që duhet hequr ose duhet të qëndrojë e tillë. Siç e thamë edhe më lart, kjo “njollë” është selektive, sepse prejardhja nga Italia, apo ndonjë vend perëndimor, mrekullisht bën përjashtim. Përveç dritëshkurtësisë, një qëndrim i tillë do të ishte edhe një ilustrim adekuat i asaj çka njihet si “racizëm”.

Përfundime

Historiani Arnold Toynbee, në hyrjen e veprës së tij monumentale *A Study of History* (Një Studim i Historisë), duke marrë Britaninë e Madhe si shembull, argumenton se asnjë komb ose komb-shtet në Evropë nuk mund të ketë një histori të kuptueshme nëse kufizohet te fusha e “historisë së kombit”. Ai thotë se historia varet nga forca që “nuk janë nacionale, por që rrjedhin nga faktorë më të gjerë... dhe janë të pakuptueshme në veprimin e tyre të pjesshëm përderisa mungon një

qasje tërësore...”⁵⁴. Historiografia e Shqipërisë (dhe jo vetëm) lëngon akoma nga qasja fragmentare dhe korniza e zhvendosur konceptuale e historisë, sepse historia e Shqipërisë studihet e shkëputur nga rrethinat gjeografike e historike dhe se mendësia e komb-shtetit – diçka shumë e vonë në historinë e shqiptarëve dhe vetë njerëzimit – projektohet në mentalitete premoderne. Si rrjedhojë, formohen perceptime të gabuara mbi vendet dhe njerëzit e së kaluarës, duke u veshur atyre vlerat, qëndrimet e shpresat që kemi ne sot, duke i barazuar kështu pa as më të voglin hezitim me tonat. Doemos që qasje të tilla na kanë çuar në konkluzione të mangëta (në rastin më të mirë) apo kryekëput të gabuara.

Një mbretëri apo shtet i rrethuar nga uji ka avantazhin e të pasurit kufij të pandryshueshëm, duke e bërë kështu më të lehtë studimin e historisë së saj si njësi më vete, thotë Toynbee. Nëse ka ndonjë vend ku një qasje e tillë do të qe e suksesshme ai do të ishte Britania e Madhe, e rrethuar nga deti nga katër anët. Megjithatë, vazhdon Toynbee, edhe historia e Britanisë është e pakuptueshme pa njohur mirë zhvillimet në vendet skandinave, Itali, Francë, Spanjë, Gjermani, e kështu me radhë; dyndjet saksone, vikinge,

54. Arnold Toynbee, *A Study of History* (Oxford: Oxford University Press, 1946), hyrje.

Magna Karta, luftërat napoleonike, revolucionet industrial, luftërat botërore, janë të pakuptueshme nëse nuk shihet panorama e plotë historike, shoqërore, politike në vende të tjera. Kur diçka e tillë është e vërtetë për Britaninë, që është një ishull, atëherë si mund të kemi një histori të kuptueshme të Shqipërisë pa pasur një njohje të mirë të historisë së vendeve fqinje, e në veçanti brenda suazës së Perandorisë Osmane⁵⁵ për më shumë se pesë shekuj?

Izolimi fizik, psikologjik e intelektual që imponoi regjimi komunist do të ishte i pamundur pa ndihmën e “njollave në biografi”, të cilat nëse i shqyrtojmë mirë kishin, në një mënyrë a tjetër, një lidhje me botën, përtej kufijve fizikë, psikologjikë e intelektualë të ngurtësuar me ligj. Siç e thamë edhe më lart, një gjuhë e huaj, studime jashtë, prejardhje e huaj... ishin të mjaftueshme për të qenë tabelë qitjesh nga shteti dhe kjo praktikë përforcohej me anë të një propagande të organizuar, qoftë me anë të arsimit, qoftë me anë të mediave.

Për mendimin tonë, sot “njolla” e Islamit përbën vazhdimësinë e këtij mentaliteti e qëndrimi dhe vazhdon

55. Gjithashtu dhe asaj romake, bizantine, mbretërisë detare të Venedikut, por ngaqë perandoria osmane ka qenë më e fundit, mund të argumentohet, rëndësia dhe ndikimi ka qenë më i madh.

e na pengon vendndodhjen e saktë të koordinatave tona historike, na pengon njohjen e asaj çfarë ishim, e si pasojë njohjen e asaj çfarë jemi e ku duam të shkojmë; na pengon daljen jashtë lëvozhgës së ngushtë psikologjike e intelektuale që na imponoi regjimi komunist⁵⁶. Në fakt, izolimi është e vetmja mënyrë se si regjime të tilla mund të ruanin e përligjinin sundimin e pushtetin e tyre. “Njolla” e Islamit është sot ajo që gjoja na pengon integrimin, zhvillimin, kulturën; por kjo është në thelb e njëjta gjuhë e përdorur nga regjimi komunist, vetëm se këtë radhë programi i partisë (imagjinare) nuk flet për një botë vlerash proletare, por për vlera liberale, perëndimore, e kështu me radhë. Ashtu siç edhe komunistët më përpara, kushdo që ngulmon te ky tëhuajëzim i trashëgimisë e pranisë myslimane shqiptare, te kjo tjetër kornizë e ngushtë intelektuale, me ose pa qëllim, po përdor një mjet për të përligjur superioritet e pushtet.

56. Nuk është e rastësishme se ky izolim intelektual, u pasua nga ai kulturor, shoqëror, politik, ekonomik dhe fizik. Në të njëjtën kohë nuk ishte izolim pasiv por edhe aktiv, sepse lidhjet me jashtë, qoftë gjeografikisht apo intelektualisht, këputeshin ose pengoheshin sistematikisht. Barbaria e fundit në Kalanë e Lezhës ndaj pllakës së shkruar osmanisht është një tjetër dëshmi e vazhdimësisë së këtij mentaliteti vetizolues.

Urojmë të jemi akoma në kohë për të dalë nga ky ngërç psikologjik e intelektual, dalje e cila është parakusht për çlirimin nga një sërë problemesh që i përkasin jetës sonë, qoftë si individë, qoftë si shoqëri. Imitimi i verbër me të vërtetë

mund të na sigurojë një kothere mbijetese, por asnjëherë dinjitet, i cili është i pamundur pa njohur vlerën e vetvetes. Sa për njollat, do të vazhdojmë t'i gjejmë e shohim tek të tjerët përderisa i bartim akoma në shpirtin tonë...

Poema “Erveheja” - botë e katërt që sublimoi mungesën e jetës shqiptare

Prof. dr. Rahim Ombashi

Departamenti i Shkencave të Komunikimit

Universiteti Bedër

Abstrakt

Kryevepra e vjersbëtarit Muhamed Kyçyku (1784-1844) Erveheja vijoi të mbetej vepra më e popullarizuar në periudhën e letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, pas botimit të parë të saj, më 1888 në Bukuresht, nga Jani Vretoja. Ndonëse numri i atyre që lexonin me alfabet arab ishte shumë i pakët, poema tregimtare me vetëm 214 strofa katërshe, me varg tetërrokësh, u shijua dhe u kuptua duke u vlerësuar nga masa e madhe e dashamirësve. Shkakut i përhapjes masive duhet parë të thjeshtëzimi i krijimit poetik, veçmas pas dy përshtatjeve: “Mbaruarë prej Hajdar Argirokastritit edhe qeruarë fjalët’ e huaja prej J. Vretosë”, por edhe të misioni utopik social i kësaj lloji letërsie. Duke qenë letërsi e qëllimshme, mbi dëgjuesin ndikoi më fort konteksti socio-kulturor, i cili u bë përcaktues, sesa teksti. Pas zbulimit dhe botimit të tekstit origjinal të “Ervehesë”, u zgjua edhe vetë lloji i kritikës, sepse tharimi se si lexohet kuptimisht një vepër artistike fshihet brenda vetë krijimit, që do të interpretohet me metodën semiotike. Iu mëshua tekstit, duke anashkaluar tematikën universale, si fushë nga e cila merret lënda letrare, duke iu qasur më fort me tematikën e saj kulturore, që lidhet me besimin islam dhe me kulturën islame. Ideja mbizotëruese del individuale, kurse tema lidhet me dhembjet e jetës dhe disa nëntema e motive që rrjedhin prej saj. Pas mbledhjes së informacionit do të kalohet në analizën reflektive, e cila ndihmon në qasjen e ëndrrës, trillit dhe fantazisë me realitetin social.

Fjalë çelës: utopi sociale, përshtatje, metoda semiotike, analizë reflektive, ëndërr, trill, fantazi, realitet social

Hyrje

Muhamet Kyçyku (1784-1844) u njoh në letërsi me emrin Muhamet a Mehmet Çami, pasi veprën e tij postume *Erveheja* e botoi më 1888 në Bukuresht Jani Vretoja, pasi ishte “Mbaruarë prej Hajdar Argirokastritit edhe qëruarë fjalët’ e huaja prej J. Vretosë”, i cili e transkriptoi dhe e kreu nga fjalët e huaja. Muhamet Çami, *Erveheja*, Selanik, 1910. Në krye të botimit të parë, i cili u rishtyp në vitin 1910 po me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit, është shënuar: “Kjo librë herën e parë u shtyp në Bukuresht më 1888 prej I. Vretosë me ndihma të gjithë mëmëdhetarëve”. Asokohe në Rumani kishte një komunitet të madh me shqiptarë, që veç veprimtarisë ekonomike merrej edhe me veprimtari kulturore e patriotike. Komuniteti i mërgimtarëve të Bukureshtit arriti të kishte gazetën e vet dhe shtypshkronjë, ku u shtypën shumë libra me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit. Në hyrje të botimit, Jani Vretoja, i cili kishte njohuri filologjike, sqaron se poemën ia kishte dhënë Resul Efendiu prej Gjirokastre. Vepra e shkruar me dorë prej Hajdar Gjirokastritit iu lexua atij nga Avni Efendiu, që njihnte alfabetin me shkronja arabe.

Në fund të poemës së botuar është shtuar pohimi i Hajdar Gjirokastritit, i cili dokumenton:

Tri hise krey Muhameti,

Një hise Hajdar fakiri. (Çami, 1910)

Më poshtë Jani Vretoja shton se Hajdar Gjirokastriti e ‘mbushi’ poemën e Muhamet Kyçyikut me një pjesë tjetër shtesë. Në ‘Përparje’ (Hyrje) botuesi thekson se kishte të dhëna për veprën origjinale të Muhamet Kyçyikut, e cila ndodhej në Çamëri, por ai nuk kishte mundur ta gjente te ndonjë që e kishte “e ta ngrinim dhe atë të shihnim sa dhe ku ndërron”. (Çami, 1910)

Prej pohimit mësojmë se ai, si botues, kishte interes të nxirrte së pari në dritë veprën e Muhamet Kyçyikut për vlerat e saj morale, mësimore dhe edukative, ndaj nuk ngulmoi për të gjetur origjinalin, ndonëse thekson se krijimi i përshtatur ka njëthurje fort të bukur. Ky veprimtar i Rilindjes sonë Kombëtare, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe me një formim filologjik të mirë për kohën, nuk arrin ta ndajë përkufizimin e letërsisë si vlerë më vete, si vetëdije artistike por di t’i dallojë mirë vlerat e saj morale dhe edukative. Në këtë nivel të formimit teorik letrar do të ketë qenë edhe Hajdar Gjirokastriti, i cili bëhet me vullnet pjesëtar në veprën e mirëfilltë të Muhamet Kyçyikut.

Është koha kur në Perandorinë Osmane shqiptarët thirreshin me emrin e krahinës nga vinin:

“Këtë vjershën e tij për të vuajturat e Ervehesë na e dha Resul Efendi Argjirokastriti shkruarë me shkronja arabishte prej Hajdar Efendiut nga Argjirokastra, i cili është vjershëtor dhe rron plak i shkuar, dhe na e këndoi Avni Efendi gjithandej nga Argjirokastra... ”.

Në fund të poemës emri i plotësuesit dhe njëherazi kopjuesi i saj jepet Hodo Kastri (“kështu i thonë më shumë në shqip Hajdarit”, sqaron Jani Vretoja), më poshtë jepet Hodo Kastrë.

Duket, në fund të shekullit XIX, rëndësi kishte të treguarit e identitetit kombëtar më shumë se ai vetjak, ndaj dhe Muhamet Kyçuku hyri fillimisht në letërsi me emrin letrar Çami, që ishte emri i krahinës së vet.

Që Jani Vretoja synonte të arrinte më shumë në rrafshin e edukimit dhe duke argëtuar, plotësohet edhe më poshtë, kur ai i përgjigjet Hodo Gjurokastritit, i cili në shtesën e tij në vargje kërkon që *Erveheja* të jetë vetëm për lexues të besimit të autorit: “...; se, ndonëse nukë jam mumin, sidekur duanë, jam vëlla i tyre i vërtetë dhe gjak që kurrë ujë z’bëhetë”. (Çami, 1910)

Në vitin 1910 poema u ribotua në Selanik, në shtypshkronjën *Mbrothësia*, kurse në vitet 20’ të shekullit XX vepra u ribotua në shtypshkronjën *Dhori Kotti* me alfabetin e Manastirit. Pas Luftës II Botërore, pas një ekspedite shkencore në Konispol dhe rrethina

u gjet vepra origjinale si dhe shkrime të tjera të autorit. (USHT, 1959) Poema origjinale u botua së pari te *Buletini i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1957/2 me transkriptim nga Osman Myderrizi.

Nga një përfaqje e shpejtë del që teksti i Vretos ishte me nivel më të ulët artistik se origjinali, por roli i tij edukativ kishte qenë shumë i madh:

Teksti i M. Kyçkut
Sot për sot erdhi sabati,
të kujtoç Perëndinë;
të mjerit m’u sos murati,
që më trete si qirinë.

Teksti i Jani Vretos
Sot për sot më erdhi dita,
Po të kujtoç Perëndinë;
Ndër këmbët tua t’u shtrita,
Ndë dash shkelm’ e më mirr
shpirtinë”.

Te hyrja e botimit të vet Jani Vreto nuk jep asnjë të dhënë tjetër për veprën origjinale, për të cilën tashmë dimë fakte të tjera, të cilat ndihmojnë për interpretimin e veprës si një lexim i hapur.

Muhamet Kyçuku u lind në Konispol të Çamërisë, ku kreu shkollën fetare të qytezës. I vijoi studimet e larta fetare në Kajro të Egjiptit, ku qëndroi për 11 vite. Kur kthehet në vendlindje, jeton si hoxhë. Në fillim nisi të përshtatë vepra letrare nga gjuhët orientale, të cilat i njihnte mirë, por shkroi edhe letërsi të mirëfilltë. Veç *Ervehesë* ka shkruar edhe vepra të tjera, por veçanërisht

poema tregimtare *Erveheja* i dha lavdinë dhe emrin e merituar, sepse dha ndihmesë në disa fusha të jetës shoqërore.

Vepra është shkruar rreth vitit 1820, kur Perandoria Osmane dhe bota islame ishin ekspozuar ndaj një periudhe shumë të tmerrshme të krizës. Muhamet Kyçyku duket ka tentuar të gjejë diagnozat më të rëndësishme për kurimin e krizës. Disa nga pikëpamjet e tij, hodhën dritë mbi të tashmen më të mirë, në funksion të së ardhmes. Sipas tij kriza mund të jetë më e fortë tek ato shoqëri që u mungon spiritualiteti, i cili është një nga burimet më të rëndësishme të pushtetit për shoqëritë. Komuniteti mysliman ku ai lindi, u rrit dhe pas kryerjes së studimeve punoi si hoxhë, ishte shumë i afërt me besimin sunit. Ndihej lidhja e fuqishme e tij me pushtetin shtetëror, ndaj ai beson se formimi shpirtëror, identiteti shpirtëror ishte një bazë për ta përballuar dhe dobësuar krizën e perandorisë, përndryshe ajo mund të shkaktonte probleme serioze në shoqërinë shqiptare, ku plagët sociale sa vinin e thelloheshin. Letërsia është krijuar për të ndërtuar një botë më të mirë se ajo ku jetojnë njerëzit, ndaj krijoi figurën lapidare të gruas, më të brishtë ndaj dhe më të sulmuarë prej atyre që bartnin tiparet e shëmtuara të përforcuara nga kriza.

Kriza kishte prekur moralin,

etikën humane dhe rrezikonte të prekte edhe identitetin islam të banorëve. Kur Mehmet Akif Ersoi zbuloi se kriza e perandorisë do të reflektohej deri te etika fetare, shkroi në një poemë të tijën:

Lartësi morale jo, informatat jo
dhe ndërgjegjja,

*Sens i virtytit, por frika e Perëndisë
në njerëzit.*¹

Poetët, duke pasur fatin të parandiejnë dukuri që shoqëria i kontakton më pas, i drejtohen kohës artistike, e cila nuk vjetrohet, ndaj M. Kyçyku vuri në themel të poemës së vet në vargje një problem etik fetar, që shërben si dokument edhe për fusha të tjera të dijes.

2. Utopia sociale e poemës tregimtare *Erveheja*

Poema u përhap te lexuesit dhe dëgjuesit si përshtatje e tekstit origjinal. Për shoqërinë shqiptare të kohës kjo ishte një dukuri e zakonshme, e cila do të vijojë tepër gjatë. Ajo shërbeu në shumë plane, sidomos si një model për shoqërinë në krizë. Duke qenë me një masë mesatare vargjesh, ajo u mësua përmendësh, recitohej në mjediset shqiptare, ku ishin shumë pak ata, që lexonin me alfabetin osman. Një numër i madh lëvizjesh sufi të

1. Assoc. Prof. Ahmet Faruk Kiliç, *The model of M. Akif Ersoy in the social crisis Resolution*, 2nd International Conference on Humanities “Crisis and Spirituality”, 17-19 may 2013, Tirana

Islamit, që ishin krijuar në Lindjen e Mesme nga shekujt XI-XII e këtej, shpejt kaluan Bosforin.² Lidhjet me kulturën islame ishin vendosur qysh në shekullin XIII me Sari Salltëkun, i cili së bashku me përkrahësit e tij përfaqëson komunitetin e parë mysliman të vendosur në Ballkan.³; por ato ishin vijim i lidhjeve edhe më të hershme që ishin kodifikuar në tesavvuf si poetikë islame. Nëse sufizmi në shekullin e mëparshëm kishte gjetur përhapje në disa qytete të begata të kohës, madje dhe në fshat, më pas sunizmi zyrtar u bë mbizotërues. Feja e vegjëlisë në formën e një nënshtrese fetare si dhe karakteri tejet sinkretik i natyrës së bektashizmit si vijë fetare tërësisht jozyrtare, siç vë në dukje etnologu Albert Doja,⁴ në këtë periudhë ia kishte lënë kryet e vendit vijës zyrtare. Kur individi nuk mund të përballej me krizën, ai duhej të përballej me veten si dhe me pjesëtarët e familjes së madhe brenda në celulën e shenjtë familjare. Po rritej numri i atyre që largoheshin në

mërgim ekonomik e ushtarak, kurse familja i ishte dorëzuar gruas, portës së botës. Familja patriarkale e kohës mudohej të shtrëngonte radhët, kur gruas i mungonte burri dhe ajo vihej nën pushtetin jo vetëm të vjehrrës, por deri edhe të kunatit të mbetur në shtëpi. Ligjet e mbijetesës po lindnin vese që dëmtonin familjen. Incesti moral brenda familjes patriarkale shfaqej në jo pak raste. Më e palëkundshme vijoi të ishte lufta për të mbrojtur monogaminë, duke e futur nga sheriatit në kodet juridike lokale, por edhe te kodet e besës, si institucion moral. Varfëria ekonomike dhe mungesa e modelit po krijonin institucionin e mosmirënjohjes. Varësia ekonomike, mungesa e mbrojtjes nga ligji, por edhe nga normat shoqërore shqiptare, e shpinin gruan deri në kufijtë e skllavërisë së pranuar.

Muhamet Kyçyku, duke vënë në themel të poemës figurën e gruas, përcillte porosinë e profetit Muhamed, që çdo burrë të maste veten në raport me korrektësinë e marrëdhënieve të tij me gruan (familjen e tij), madje vetë mudohej që te ky raport të ishte fitimtar. Erveheja do të mbetej nën kujdesin e të kunatit, pa tundur djepin e vet, do të mbetej nën dhunën e rrugës, ku e shihnin gruan vetëm si një mjet argëtues që mund ta blije e ta shisje. Zhgënjimet prej njerëzve Erveheja do t'i ketë varg, por asnjëherë nuk e humbi besimin te Zoti, me të cilin ka

2. Ahmet T. Karamustafa, *God's unruly friends: Dervish groups in the Islamic later middle period 1200-1550*, (Salt Lake City: University of Utah Press, 1994).

3. Prof. Dr. H. Musa Taşdelen, *Sari Salltuk as a Spiritual Leader in the Balkans*, 2nd International Conference on Humanities "Crisis and Spirituality", 17-19 may 2013, Tirana.

4. Doja, Albert, "A political history of Bektashism from Ottoman Anatolia to contemporary Turkey", *Journal of Church and State* [Oxford]. 2006.

raporte të qëndrueshme:

*U⁵ paratë që pagova
Ndë arkët të mbretërisë,
Ty, o shpirt, nuk t'i hova⁷,
Po për hir të Perëndisë.*

Familja shqiptare po jepte shenja dobësimi, kurse individi duke synuar të ruante me çdo çmim jetën, po dëmtonte vlerat e saj. Fabula e vendos Ervehenë në kushte të veçanta. Gjinia e burrit të saj është e vogël, pranë shtëpisë së çiftit ndodhet vetëm vëllai beqar i bashkëshortit. Poema gjeti mbështetje nga përhapja e haditheve profetike, të cilat nënës i jepnin tri herë më tepër rëndësi nga babai, sepse atje merret modeli i nisjes së jetës.

Në Islam familja bashkëshortore është e bazuar në sakrificë, besnikëri dhe bindje. Autori ka bërë kujdes që të gjitha këshillat të mishërohen te protagonistja e poemës, e cila kontraston me individin dhe mjediset e dhunshme të kohës. E fyer, e dëmtuar padrejtësisht, asnjëherë nuk gjen kohë të analizojë karakteret e njerëzve që synojnë apo arrijnë t'i bëjnë keq, sepse për besimtaren nuk ka vend zakoni i rrugës për të kërkuar gabime, për të fajësuar e kritikuar... Heshtja është lavdia e gruas, thuhet në një maksimum të lashtë greke. Flet aq pak, më shumë flet me heshtjen dhe durimin, ndaj i shton vetes tipare që ia shtojnë bukurinë, prej së cilës

5. Unë.

6. Në.

7. Dhurova.

gjen belanë. Si besimtare ajo e pranon se familja islame është e bazuar në sakrificë, besnikëri dhe bindje. Prej vargut të parë me të cilin autori nis portretizimin e saj të shtohet interesi për të njohur atë më pas. Ajo zhbiron vetveten me veprimet që kryen, duke i shtuar vetes vlera. Pas përshkrimit në fillim të poemës, ajo hyn menjëherë në rolin e vet, fillon të shfaqë tipare të karakterit të edukuar në familje. Menjëherë fillon ta respektosh dhe shpejt edhe ta duash karakterin qëndrestar të saj, sheh aty çfarë i mungon shoqërisë ku jetonte, por nuk mund ta harrosh asnjëherë.

Kur i prishet çerdhja bashkëshortore, Erveheja di të ruajë qetësinë shpirtërore duke synuar në ringritjen e saj me durim. Kjo pastërti e bën atë të gëzohet për të mirat e protagonistëve të tjerë, duke marrë misionin e gruas që gëzon kur shëron njerëzit pa dallim nga veset dhe verbëria fizike. Duke i munguar familja e vet bëhet pjesëtare e vlefshme e familjes së madhe të botës, nga ku më pas do të veçojë rrethin e saj të ngushtë familjar. Rreth një shekull e gjysmë më pas, Nënë Tereza do të porosiste të njëjtën gjë:

“Çfarë mund të bësh që të promovosh paqe në të gjithë botën?! Shko në shtëpi dhe duaje familjen tënde.”

Konteksti sociopolitik, kulturor e historik i veprës me mision social

Personazhi i parë letrar i letërsisë sonë u krijua nga vjershëtari M. Kyçyku: “Kjo poemë e shkurtër u paraprin poemave narrative të romantizmit. Në kryeveprën e vet *Ervebeja* Kyçyku krijon një vepër të plotë, ku sprovohet njeriu deri në triumfin e tij moral, kurse personazhi i Ervehesë është personazhi i parë letrar në letërsinë shqipe”. (Hamiti, 2010)

Sprovat e heroinës dëshmojnë për gjendjen sociale në të cilën ishte shoqëria shqiptare e kohës. Kriza e fuqishme e Perandorisë Osmane, kishte nxitur popujt e Ballkanit të synonin krijimin e shteteve të tyre, pas shkëputjes nga perandoria, që po shtynte kohërat e saj të pashpresa. Jehona e Revolucionit Francez shtoi përpjekjet e intelektualëve të perandorisë për të bërë kujdes në pastrimin dhe pasurimin e gjuhës turke, si parakusht për krijimin e shtetit kombëtar në të ardhmen. Ky ishte interesi edhe i intelektualëve të të gjitha kombeve që formonin perandorinë. Poema *Ervebeja* e Muhamet Kyçyikut e shpuri më tej sigurinë e krijuesit shqiptar, sepse vepra do të shërbente si bazë për krijimet e mëvonshme. Ajo, ndonëse e ngjizur mbi një fabul tregimtare turke, e përshkuar nga fryma e tesavvufit si poetikë, u përpunua dhe u formatua si një tekst i mirëfilltë, ku lënda ishte tërësisht shqiptare. Veç problemeve që kriza kishte shkaktuar për gjithë perandorinë, ajo

zbuloi edhe probleme tërësisht të natyrës shqiptare. Duke krijuar mitin e gruas, ajo la modele mitike.

Vlerësimi i mësipërm i studiuesit Sabri Hamiti, flet për rolin e poemës në historinë e letërsisë shqipe, duke dëshmuar njëherazi tharmin e fuqishëm artistik, që jepte realiteti konfliktual dhe i vrazhdë i kohës. Figura monumentale e gruas shqiptare, që zhbihet deri në imtësitë shpirtërore, i shërbeu shoqërisë së kohës, por la si dokument boshin, i cili shtyn krijuesin ta plotësojë me krijimin artistik. Duke u ngjizur mes figurave stilistike të apostrofës dhe sarkazmës, poema iu largohet vargjeve vetëlavdëruese të divanit, me të cilin nisi letërsia jonë me alfabet arab, si dëshmi e një arti të idealizuar individual dhe bëhet identifikim me krijuesin. Duke krijuar figurën ideale si model etik e moral, vepra bën zhbirimin e utopisë sociale duke shërbyer si fakt i kohës historike. Pas filozofisë së poemës epike qëndron konstruksioni ligjërimor ideologjik, për shkak se mund të zbulojmë lidhjen e saj të mundshme me një realitet të caktuar, ose faktorët sociologjikë dhe politikë që e kanë përcaktuar.⁸

Në këtë mënyrë ajo shërben si një dokument social i kohës, i cili vjen deri në kohën tonë, sepse poema ka vlera edhe si produkt shoqëror, si mjet komunikimi mes kohërave. Ajo

8. Albert Doja, *Bektashizmi në Shqipëri: Histori politike e një lëvizjeje fetare*, Tiranë, 2008.

do t'u shërbejë si model krijuesve të mëpastajmë, të cilët do të ndihnin të bëhej Shqipëria.

Poema tregimtare morale prej 856 vargjesh, ndarë në strofa katërshe, e mori fabulën prej një tregimi në prozë në gjuhën turke *Revza* (Lulishte), duke krijuar poemën morale origjinale. Gjuha e poemës, nga kompozicioni, nga detajet e gjetura, i japin asaj statusin e origjinalitetit.

Fabula e veprës *Erveheja* endet rreth ndodhive, peripecive të një gruaje shqiptare, e cila di të sakrifikojë deri në ekstrem për të mbetur ajo që ishte në çastin, kur i shoqi u largua. Vuan, endet në botën e halleve, shkon në prag të vdekjes disa herë, por nuk dorëzohet, për asnjë çast nuk humbet besimin te Zoti. Integriteti shpirtëror vetjak e ndihmon t'i kalojë kurthet që i ngriheshin gjithkund, duke marrë shpërblimin e qëndresës morale. Shpëton me ndërhyrjen e Zotit duke marrë në fund shpërblimin e virtyteve të saj, rikrijimin e familjes, madje edhe të gjinisë, tashmë të zgjeruar.

Autori ka shënuar se e ka shkruar *Ervehenë* për të paditurit, masën e madhe të popullit. Vepra e shkruar do të arrinte atje mes leximit të atyre të paktëve që arrinin të lexonin me alfabet arab. Pas një ekspozicioni të shkurtër, nis tregimi i autorit, i cili nuk i lë hapësirë mendimit. Fabula dhe personazhi ndihmojnë të jepet

një pamje më e gjerë e tërë popullit. Teknika epike *in media res* na fut në zhvillimin e veprimit pa u munduar ta përmbyllë atë sa më shpejt. Pjesa e parë e poemës ka tension dramatik, ndërsa e dyta, si i mbarojnë tërtherjet, ka më tepër përsëritje, ndërsa autori bën kujdes që të përcjellë porosinë.

Erveheja dinjitare, e bukur, e mençur, e lumtur prej martesës, do të mbetet fillikat në shtëpinë e vet, sepse të shoqit "I ra puna të largohej". Duke mos zbuluar arsyen konkrete të largimit nga familja, poemës i mungon e veçanta, ndaj ndihet që autori synon të përcjellë porosinë morale. Fabula shtjellohet duke ia lënë amanet të vëllait beqar gruan. Ai e jep besën se do të kujdeset për të kumatën, por Erveheja ishte shumë e bukur, ndaj fillon të vuajë. I kunati kërkon të shtrojë shtrat me të, menjëherë pas dhënies së fjalës. Ai ndesh në qëndresën e saj dhe sipas porosive të qoftëlargut e akuzon si të pandershme. Me dëshmitarë të blerë arrin ta dënojë, duke e ekzekutuar me gurë. Ndodhet gjysmë e vdekur nën muranë, kur kalon aty pranë një bujar (arap). Botuesi Jani Vreto shkruan se në origjinal ishte arap (që në shqip ka kuptimin njeri i zi), por ai e zëvendësoi me fjalën bujar (fisnik), duke menduar se mund të jetë arab, banor i Arabisë. Duke na treguar për zëvendësimin gjejmë faktin se gjuha turke e shurdhon bashkëtingëlloren *b* në *p* te fjala *arapçe* (arabisht), pra gjuha arabe, prej nga del se arap

është emri i atij që flet arabisht e jo njeri me ngjyrë. Personazhin më pozitiv të veprës, që i shpëton jetën heroinës së poemës, duke pasur pasoja të tmerrshme, autori e etiketon me emrin e banorit të atij populli të zgjedhur, që nxori njeriun, i cili priti Kur'anin e Shenjtë, që pati fisnikërinë ta përkrahte të dërguarin e Zotit. Arabi fisnik, i cili dëgjon rënkimet e Ervehesë, që po vdes nën muranën e sapongritur, ishte arap (bujar, fisnik), dhe jo arap (njeri i zi). I bindur se homonimia do të prekte përcjelljen e mesazhit, Jani Vretoja e zëvendëson fjalën, duke e shtuar dozën e përshtatjes. Personazhi pozitiv është pjesëtar i një populli tjetër, ndaj vepra dëshmon edhe pranimin prej autorit të diversitetit kulturor, si pasuri e Perandorisë Osmane.

Intriga e poemës me elemente të fuqishme dramatike, fillon prej kunatit, i cili nuk dihet në është marrosur nga tundimi prej bukurisë së veçantë të Ervehesë, apo i verbuar prej besëprerjes. Sidoqoftë Erveheja do të ketë problem me bukurinë e saj të rrallë edhe në episode të tjera të poemës. Duke u mbështetur te mendimi i Faik Konicës: “Ashtu kuptova se në të vërtetë kisha arritur në Shqipëri, një vend i bekuar me një mijë bukurira, po i shkelur nga një turmë, e cila ushqen njëfarë urrejtjeje kundër bukurisë” (Konica, 1993) duhet ta pranojmë se kjo urrejtje duhet të

ketë qenë më e fortë një shekull më parë dhe veçanërisht në kohë krize. Autori nuk e individualizon fisnikun, sepse i duhet individualizimi për të krijuar mitin e heroinës. Ai e shpie në shtëpinë e vet qenien e gjetur nën muranë, ku i shërben me ngrohtësi bashkë me gruan. E përsëri problem bëhet bukuria. Sapo ajo shërohet, bëhet edhe më e bukur. Bujari i ofron martesë, sipas kodit kuranor mbi martesën me një grua për bamirësi. Ajo e njeh Kur'anin e shenjtë, dispozitat e sheriatit islam, i dinte se sa të nevojshme ishin zbatimi i dispozitave që orientonin jetën shpirtërore, fizike dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore, rregullat në familje, në bashkëshortësi. Këtë etapë të vështirë ajo arrin ta kalojë duke e bindur atë burrë besimtar se mirësia që kreu duke i shpëtuar jetën, se mirësinë ia kishte bërë Zotit e nuk duhej ta prishte. Nëse ai e fton për martesë se e gjykon si të ngratë, ajo arrin ta bindë se ka status tjetër. I duhet të përballet më tej edhe me tundimin që i ka shkaktuar shërbëtorit të fisnikut, i cili për hakmarrje, me që ajo nuk pranon të martohet me të, hakmerret duke vlarë djalin e bujarit, por padit Ervehenë për krimin.

Iu bë detyrim lufta, ndonëse e urrente atë. Asaj i është dhuruar urtësia, ndaj dhe mirësi e madhe. Është në prag të një katastrofe, sepse i duhet të ridalë në rrugë, pasi provon se është e pafajshme. Duke nderuar besnikërinë e Ervehesë, fisniku i jep

dhuratën e kurorës, niqahun, si ta kishte pjesëtare të familjes, por asaj i duhet të largohet prej asaj shtëpie fatkeqe. Buzë një rruge, me niqahun e ndarë nga bujari, i shpëton jetën një burri, i cili i detyrohej arkës së sundimtarit. Përsëri propozim për martesë prej të shpëtuarit nga vdekja dhe përsëri dhunë për të realizuar dëshirat mashkullore.

Pas mospranimit, i shpëtuari e shet si skllave të një kapedan anije. Fatkeqësitë nuk kanë të sosur. Edhe si skllave arrin ta mbrojë nderin e dinjitetin vetjak. Së fundmi i vjen në ndihmë ndërhyrja hyjnore, që e mbytet anijen e njerëzit e saj të zhytur në vese. Zoti e hedh të gjallë në breg të detit Ervehenë.

Pas pjesës së parë të poemës, me aq shumë pika takimi me realitetin social absurd të shoqërisë shqiptare të fillimit të shekullit XIX, fabula e pjesës së dytë të poemës vijon të endet në një botë mrekullish, si shpërblim hyjnor për besnikërinë e heroinës. Vishet si burrë dhe arrin të marrë lejen nga mbreti për të qëndruar në vendin ku e hodhi dallga. Mjekon verbimin (sëmundje e paditurisë) e bën emër në mjedisin përreth. Kur froni mbretëror mbetet bosh, sepse nuk ka trashëgimtar, këshilli mbretëror e vendos në krye të mbretërisë, duke u bërë një me amanetin e mbretit, që jep shpirt i lehtësuar pas atij gjykimi të mençur. Vijon të shërbejë si mjeke popullore dhe nami arrin deri në qytezën e saj,

ku vuajti padrejtësisht. Vijnë për t'u kuruar i kunati, i shoqëruar me të vëllanë, të cilit i premtoi dhe i dha besë, shërbëtori plëngprishës me bujarin aristokrat, të cilët shfaqen të penduar. I shëron dhe së fundmi u tregon se kush është në të vërtetë. Vë në fronin e mbretit të shoqin, i kërkon bujarit të sjellë të shoqen, që ta ketë si nënë, fal kunatin dhe shërbëtorin, duke i shërbyer simbolit të besimit islam si mëshirë e falje.

Tregimi në vargje ka tension dramatik, deri sa Erveheja arrin të marrë të drejtën për të qëndruar në vendin ku e hodhi shqota detare, por gjithçka në poemë endet rreth figurës së Ervehesë, që shërben për të zhvilluar fabulën tregimtare.

*Erveheja që një grua,
që s'kish shoqe n'atë ditë,
vajzë dhe si u martua,
posi hëna kur bën dritë.
Bukurinë e kish me shur⁹,
fort që një zonj⁹ e ndersburë,
burrin e kish bërë mamur¹⁰
dhe me buje¹¹ të bukurë.* (USHT,

Histori e Letërsisë Shqipe, Tiranë, 1959, f. 289)

Fjala grua është në kuptimin zonjë, sipas traditës sonë të kohës, por dhe fesë islame. Shihet vijueshmëria e edukimit të femrës që në vogëli dhe më pas. Megjithatë është reflektuese e diellit, nuk ka dritën e vet, është hënë, sepse metafora diell i referohet

9. Lavdi, nam.

10. Të lumtur.

11. Tipare.

vetëm adhurimit. Është shumë e bukur, duke dëshmuar se shqiptarët kanë problem me bukurinë, por jo me fisnikërinë:

“Kështu, në qoftë se në Shqipëri bukuria është e përbuzur dhe e shkëlmuar, s’ka dyshim se fisnikëria, një nga virtytet e vjetra të kombit, shqiptar, është edhe e gjallë dhe merr një fuqi të re nga shembull i Atij që duhet të jetë dhe është pasqyra e mirësive të shpirtit dhe të sjelljeve...” (Konica, 1993)

Vlerat e Ervehesë dalin në përplotësimin moral të burrit, çka flet për një hap në raport me kohën në këtë drejtim. Autori e shpie edhe më parë mendimin për gruan, sepse edhe ajo ka rolin e vet në forcimin e tipareve pozitive të bashkëshortit të vet, duke mos mbetur thjesht në reflektimin e dritës së burrit: “Posi hëna kur ep dritë”.

Tiparet pozitive që mishërohen nga veprimet e tyre gjatë gjithë shtjellimit të veprës, krijojnë sfondin e shpresës për shoqërinë në të ardhmen. Erveheja është shembull mirësie e përkushtimi ndaj njerëzve. Për të shpëtuar një të panjohur jep gjithë niqahun e vet. Është me karakter të fortë, arrin të mos i nënshtrohet çastit të temperamentit sanguin shqiptar, nuk di të marrë hak, sepse nuk e pranon komponentin “hakmarrës”, “të identitetit shqiptar, një komponent ky, të cilin nuk e ka si veçori kryesore si identiteti kulturor evropian” (Frashëri, 2006) edhe

besimi islam, që edukon mirësinë dhe paqen shpirtërore. Heroina grish banorin shqiptar të çdo kohe, të dy gjinive dhe tërë shtresave shoqërore, veçmas të shqiptarit në kohë krize, që të mos lejojë të bjerë në krizë shpirtërore, e cila varet tërësisht prej individit. Duke konsoliduar identitetin shpirtëror, mund të arrijë të përballojë, të ulë ndikimin e krizës në tërësi mbi të e shoqërinë, në përgjithësi.

Figura e Ervehesë, e para në letërsinë shqipe, anon nga perfeksioni social, synon të ngrihet në nivelin e një qenieje shpirtërore, që afrohet me dritën (fuzulium) duke arritur aq pranë me arshin hyjnor. Tregimi i rrjedhshëm është plot gjallëri e dramatizëm. Dialogu është i afërt me ligjërimin bisedor, plot ngjyra. Vargu tetërokësh i jep mundësi autorit të individualizojë karakteret nëpërmjet gjuhës apo veprimeve që kryejnë.

4. Diskutim

Muhamet Këçuku zgjodhi mitin e gruas si mjedis ku ai kreu meditimin e vet social. Qeniet mitike shqiptare kanë shumë figura femërore, që hyjnë thellë në histori. Me figurën e Ervehesë krijohet personazhi i parë femër, por njëherazi zë fill miti i gruas në letërsinë tonë të individualizuar, që në letërsinë e Rilindjes Kombëtare do të zërë vend parësor.

Zhbirimi i gjendjes sociale plot mungesa, ku ajo jeton, pasi nuk

është më nën kujdesin e mbrojtjen e të shoqit, i japin mundësi autorit të gjejë të veçantën, pa lustër, problemet sociale, ekonomike, shpirtërore, morale, etike, fetare etj., për të cilën kishite nevojë shoqëria shqiptare e kohës, disa prej të cilave shfaqen edhe tani. Gruaja është qenie natyrore, por edhe sociale e shpirtërore, që jeton në natyrë, në familje dhe në komunitet. Problemet e shumta që shfaqen rreth Ervehesë janë probleme të kohës, madje edhe më të fuqishme se për një kohë të caktuar historike. Në tisin krijues artistik gjejmë fakte të organizimit familjar, shoqëror, zakonor e ligjor të popullit tonë në shekullin e fundit të ekzistencës së Perandorisë Osmane, kur po dukeshin shenjat e krijimit të shteteve të veçanta.

Siç shprehet studiuesi Adem Balaban te punimi i vet: *Rëndësia e përdorimit të gjuhës në menaxhimin e krizës*, “Nëse para, gjatë ose pas krizave të tilla, do të përdoret drejt dhe korrekt gjuha nga udhëheqësit politikë, media dhe njerëzit mund të parandalohen dhe zvogëlohen konfliktet.”¹² Te poema tregimtare

12. Dr. Adem Balaban, *The importance of Using Language in Crisis Management*, 2nd International Conference on Humanities “Crisis and Spirituality”, 17-19 may 2013, Tirana.

The importance of Using Language in crisis Management: “Whether before during or after such crisis, the proper and correct use of language by political leaders, media and dhe people may prevent and reduce

Erveheja e shkruar shqip, por me alfabet arab, gjuha jo vetëm parandalon konflikte, arrin të bindë e të edukojë moralisht, por dhe me besimin islam. Erveheja e përdor këtë mjet të komunikimit për të informuar, këshilluar, argumentuar e bindur personazhet e tjerë të poemës tregimtare. Fjala në gojën e personazheve pozitivë të poemës fiton forcë, sjell zgjidhje problemesh e jep kënaqësi, krejt ndryshe nga fjalët e personazheve negativë, që marrin urrejtje e përcëpim.

Duke qenë grua, ajo nuk di t’i ndajë njerëzit që kanë nevojë për ndihmë. Bujari e shpie në shtëpi gruan e gjetur nën muranë, pa e ditur besimin e saj fetar, shtresën e saj shoqërore apo origjinën e saj etnike. Erveheja e shpëton nga vdekja qyqarin, i cili ka dëmtuar arkën e sundimitarit, u jep 400 florinj, gjithë niqahun e vet, sepse ajo nuk di të bëjë llogari, kur lypset mirësi, pa e ditur besimin e tij. Po kështu nuk dihet besimi fetar i mbretit që i jep strehë, nuk dihen besimet e atyre që u kuron verbimin pa asnjë pagesë. Për këtë arsye vepra poetike *Erveheja* u bë e dashur për të gjithë banorët shqiptarë, pavarësisht besimit fetar.

5. Përfundime: Propozime

Në qoftë se me divanin e Nezim Beratit letërsia shqipe dëshmon se mori në mënyrë krijuese modelin dhe shtytjen nga letërsia e tesavvufit conflicts”.

për të hyrë në rrugën e krijimit poetik individual, me poemën tregimtare *Erveheja* të Muhamet Kyçyikut kjo letërsi vuri themelet e poemës narrative, e cila shpejt do të nxiste zhanre të tjera që pritej të shfaqeshin. Duke ruajtur e ftilluar ndjeshmërinë artistike në gjuhën amtare, ndihmoi për plotësimin me elemente shpirtërore identitetin vetjak. Duke qenë dokumente në kohë artistike, detajet e shumta të ngurtësuar në të, japin ndihmesë për të zhbiruar kohën historike dhe njëherazi ato shërbejnë si pika referimi për komunikimin nëpër kohëra.

Elementet e poetikës mistike (sufiste): Zoti, zemra, besimi, hëna, përkohshmëria e jetës tokësore plot privime përballë asaj hyjnore tërë dinjitet, të jetuarit shpirtërisht deri në tërtherje etj., jepen paralelisht me elemente të poetikës mitike shqiptare: orët, zanat, shtojzovallet, me themele te miti i *Magna Mater*, si jehonë e kultit të perëndeshës anatoliane, që e bën figurën e Ervehesë më se shqiptare, më se të lidhur me një mjedis të caktuar. (Roller, 1999)

Figura e Ervehesë duke qenë origjinale, sepse është funksionalizuar artistikisht në kuadër të strukturës letrare, (Krasniqi, 1984) ka ruajtur topose sociale, që ruajnë klishe sociale, të cilat kanë arkivuar fakte të kohës. Në strukturën poetike të veprës dhe veçmas atë të heroinës,

shpallet edhe vetëdija morale, sociale dhe estetike e Muhamet Kyçyikut, pikëpamjet e tij mbi jetën dhe mbi shoqërinë. Arsyet e brendshme kombëtare, ai i ktheu në fakte letrare, që çuan në krijimin e fortë dramatik të karakterit të Ervehesë.

Figura e veprës, siç thotë Lesingu, bënte efekt estetik duke shënjuar përshtypje të thellë te shqiptarët, si esencë metafizike e bukurisë. Me poemën *Erveheja* autori gjeti mundësinë t'i flasë bashkatdhetarit të vet për problemet që e shqetësonin me shumëkuptueshmërinë e thjeshtësisë, duke mos u bërë tregtar i fjalës. E kaloi hijen e vet, synoi ta kapërcente kohën, ndaj mbeti në kohë me poemën tregimtare dhe sprova e gruas që beson në Zot doli me sukses. Poeti personifikoi fenomenet sociale, i bëri qenie që ndiejnë, duke projektuar vetveten, ëndrrat dhe idealet e veta. Nuk u vu në qendër të gjithësisë individi dhe dëshirat e tij, si te mistikët (sufistët), por vepra dëshmon tipare të traditës më të mirë shqiptare, që kishin zëvendësuar elemente të misticizmit. Te karakteri i pavarur i Ervehesë janë trashëguar një numër shumë i madh tiparesh të vjetra, që shërbejnë si shembull tipik për forcat e ngurtësisë kulturore dhe qëndresës politike.¹³ Me këtë poemë tregimtare

13. Kressing F. (2002), *Preliminary account of research regarding the Albanian Bektashis*. English, Book, Illustrated edition: Albania-a country in transition: aspects of changing

hapet rruga e bektashizmit, si një trashëgimi fetare dhe kulturore, që do t'i sjellë letërsisë shqipe Naim Frashërin.

Filozofi i madh kinez, Kong Fu Tzu ka shkruar:

“Shenjat dhe simbolet janë ato që e sundojnë dhe udhëheqin botën, e jo fjalët apo ligjet.”

Me anë të Ervehesë u shënjua imazhi i dinjitetit, i kthyer në simbol. Prandaj është pafundësisht e bukur jeta morale e Ervehesë. Si qenie me emrin ‘Njeri’ synonte diçka më të lartë se ekzistenca, dinjitetin njerëzor, që i jep kuptim jetës. Vepra përcolli këtë trashëgimi morale deri me vendosjen e sistemit kolektivist në Shqipëri, pas Luftës II Botërore. Me vendosjen e rendit komunist, jeta u bë aq kolektive, u prek rëndë dinjiteti dhe personaliteti i çdo individi, sa jeta e secilit rrezikoi të humbte veçantinë e saj, ndërsa njerëzve iu kultivohej shtetërisht psikologjia e turmës.

Socializmi do të galdohet nga turmat pa qytetarë dhe i nxiste ato të urrenin njerëzit që e ruanin me fanatizëm dinjitetin. Ndershmëria shembullore, pasi u ndalua ligjërisht besimi fetar, asokohe quhej budallallëk, ndërsa krenaria e vërtetë e dinjiteti vetjak ndëshkohej kolektivisht dhe dënohej

shtetërisht. Njeri i mirë çmohej ai që nuk e dallonte veten në asgjë nga të tjerët, madje ‘shkrihej me ta’. Nuk shqetësohej kush institucionalisht për përsosjen shpirtërore të individit dhe talentet e fuqishme duhej ta vuanin në heshtje dramën e tyre. Dinjiteti ishte kërcënim i hapur për diktaturën, megjithatë vepra *Erveheja* e realizoi detyrën e vet sociale dhe për këtë e dënuan me heshtimin ostacizt.

Mungesa e kontaktit me artin cilësor ndikoi në prishjen e shijeve estetike, veçmas të rinisë, siç e kishte parashikuar qysh herët personaliteti dhe veprimtari i shquar:

Para syve të riut të sotshëm ma i madhi njeri në botë asht Krali i Automobilavet: Fordi, ma i vlefshemi Libër asht Romani i dashurisë.

Pra po shofim çiltazi se në jetën e mbrendëshme kemi një shkretë të përgjithshme; as një gja nuk na bindë dëshirat, as kur sendi nuk na kënaqë; si një dtë qi përplaset nga shtërgata asht tue u tramzuë mendimi i brezit të rijë dhe po mundohet me gjetun shtroherën qi të prekin pakë ndijësit e ashpëruara. (Vokopola, 1927)

Kategoria e rastësisë objektive i ka dhënë hapësirë krijuesit për realizimin e veprës, ku zonja e një shtëpie të thjeshtë ka vlera mbretëreshe. Ai e ofroi produktin e vet si ndjeshmëri artistike, si letërsi në gjuhën amtare, por jo më pak si kulturë, si moral, si dije duke forcuar karakterin utilitar, kur kriza

identities in a South-East European country / [edited by] Frank Kressing, Karl Kaser, Baden-Baden: Nomos.

rrezikonte të shtoheshin prodhimet kallpe, siç thuhet në një citat te *Protagora* e Platonit:

“Sigurisht, thashë, dituria është ushqim i shpirtit dhe duhet të ruhem, miku im, që sofisti të mos na mashtrrojë kur lëvdon atë që shet,

si matrapazët që shesin sende për trupin, sepse ata lëvdajnë pa dallim gjithë mallin e tyre pa ditur cili vërtet është i dobishëm ... Rreziku është shumë më i madh në të blerë të dijes, sesa në të blerë të mishit dhe të pijes.”

Bibliografia

1. Çami M. (1910). *Erveheja*, Selanik, f. I.
2. Doja A. (2006). *A political history of Bektashism from Ottoman Anatolia to contemporary Turkey*, Journal of Church and State [Oxford].
3. Doja A. (2008), *Bektashizmi në Shqipëri: Histori politike e një lëvizjeje fetare*, Tiranë.
4. Frashëri K. (2006), *Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të Tjera*, Tiranë, 2006, f. 6.
5. Hamiti S. (2010), *Poetika shqipe*, Tiranë 2010, f. 147.
6. Karamustafa T. A. (1994), *God's unruly friends: Dervish groups in the Islamic later middle period 1200-1550*, (Salt Lake City: University of Utah Press).
7. Konica F. (1993), *Vepra*, Tiranë, 1993 (f. 227).
8. Krasniqi B. (1984), *Letërsia dhe vetëdija historike*, Prishtinë, 1984.
9. Kressing F. (2002), *Preliminary account of research regarding the Albanian Bektashis*. English, Book, Illustrated edition: Albania--a country in transition: aspects of changing identities in a South-East European country / [edited by] Frank Kressing, Karl Kaser, Baden-Baden: Nomos.
10. Roller, Lynn E. (1999). *In Search of God the Mother the Cult of Anatolian Cybele* (Berkeley-Los Angeles: University of California Press). *New Book on Magna Mater*.
11. Universiteti Shtetëror i Tiranës, *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Tiranë, 1959, fq. 284.
12. Assoc. Prof. Faruk Kiliç A., *The model of M. Akif Ersoy in the social crisis Resolution*, 2nd International Conference on Humanities “Crisis and Spirituality”, 17-19 may 2013, Tirana.
13. Balaban A. *The importance of Using Language in Crisis Management*, 2nd International Conference on Humanities “Crisis and Spirituality”, 17-19 may 2013, Tirana.
14. Taşdelen M. *Sari Salltuk as a Spiritual Leader in the Balkans*, 2nd International Conference on Humanities “Crisis and Spirituality”, 17-19 may 2013, Tirana.
15. Vokopola F. (1927) *Të rinjtë e sotsbëm si mejtojnë edhe kujt i mbesojnë?*, Zani i Naltë, 6, IV, janar, f. 174-178.

Liria e besimit dhe dialogu ndërftar në Shqipëri

Vlash Plepi
Akademia Teologjike Orthodhokse, Durrës

Abstrakt

Bashkëbisedimi dhe komunikimi me ndjekësit e feve të tjera bëhet më i lehtë kur ne pranojmë tjetrin si vëllain dhe motrën tonë, duke respektuar lirinë, sidomos lirinë e ndërgjegjes së tyre. Ne i pranojmë ata siç janë, me dashuri të singertë, duke i ndarë së bashku eksperiencat e tyre fetare, që kanë qenë më të rëndësishmet në kërkimet tona për kuptimin e jetës dhe vdekjes dhe në dëshirën tonë për të përjetshmen, Perëndinë.

Zhvillimi i dialogut dhe tolerancës fetare nuk imponon marrëveshje të përbashkëta, por respektimin e lirisë fetare dhe të së drejtës së çdo njeriu të zgjedhë vizionin dhe rrugën që ai bindet të ndjekë në afrimin e tij me Hyjninë.

Tema të këtilla të cilat kanë të bëjnë me lirinë e besimit dhe dialogun ndërftar, mbarëvajtjen ndërmjet njerëzve, komuniteteve, popujve apo grupimeve të ndryshme, të cilët kanë ndërmjet tyre dallime ideologjike, besimi apo të çfarëdo emërtimi tjetër që ato mund të marrin, janë kaq të rëndësishme apo dhe të domosdoshme për një bashkekzistencë paqësore dhe

mirëkuptim kaq shumë të dëshiruar nga mbarë njerëzimi anekënd botës.

Parimi kryesor i funksionimit të besimit të krishterë është i mbështetur mbi lirinë dhe dashurinë.

Njeriu u krijua me një liri dhe aftësi të tillë, saqë në qoftë se dëshiron mund të mohojë madje edhe vetë Krijuesin. Perëndia që ndërkohë “ankohet” për kapërcimin e lirisë, por megjithëkëtë, nuk e detyron njeriun. Po kështu nuk i

imponon atij pendimin dhe kthimin në besimin e vërtetë. Biri prodik është i lirë të braktisë shtëpinë atërore. Po kështu krejtësisht i lirë vendos të kthehet.

Përjetimi i dashurisë zhvillohet në dy linja paralele të cilat nuk mund të ekzistojnë në mungesë të njëra-tjetrës. E para është dashuria për Perëndinë dhe e dyta është dashuria për të afërmin (njeriun). Kuptimi dhe përpjekja individuale e çdo besimtari drejt kësaj dashurie të përsosur nxjerr jashtë çdo lloj frike dhe të mbush me shpresë (I Jon 4:18) duke dhënë orientim në udhëkryqet më të vështira të jetës.

Bashkëbisedimi dhe komunikimi me ndjekësit e feve të tjera bëhet më i lehtë kur ne pranojmë tjetrin si vëllain dhe motrën tonë, duke respektuar lirinë, sidomos lirinë e ndërjegjies së tyre. Ne i pranojmë ata siç janë, me dashuri të sinqertë, duke i ndarë së bashku eksperiencat e tyre fetare, që kanë qenë më të rëndësishmet në kërkimet tona për kuptimin e jetës dhe vdekjes dhe në dëshirën tonë për të përjetshmen, Perëndinë.

Kryepiskopi Anastas në librin e tij “Globalizmi dhe Orthodhoksia” do të shprehej se: “njeriu, i cili ka bindje të ndryshme, kurrë nuk privohet nga cilësia e tij bazë ‘nënshtetësia’ e tij shpirtërore; nuk pushon së qeni ‘bir i Perëndisë’, i bërë sipas ikonës së Perëndisë (gjeneza 1:27) pra është vëlla”.

Duke e konsideruar interpretim të vargut të mësipërm të gjenezës, në kontekstin shqiptar Çajupi te “Baba Tomorri” do të shprehej:

**“Të Krishtër e myslimanë
I gatoi nga një baltë”**

Ky komunikim, sidomos ndërmjet grup-feve të ndryshme, duhet të zhvillohet në rrafshin e bashkekzistencës vëllazërore dhe në gjetjen e problematikave të një interesi të përbashkët duke iu shmangur ndryshimeve dogmatike dhe ndasive që mund të mbartin ato. Këtë gjë e them se sot vihet re një drujtje nga disa besimtarë të zellshëm për të dialoguar me një besimtar të një feje tjetër, sepse rezervojnë frikën e pajtimit me ndonjë element të ndryshëm dhe kompromentues të besimit të tyre. Kryepiskopi Anastas do të vërente sërish se: “.. Besimtarë të devotshëm të feve të ndryshme kanë ndjerë një rrezik të ri, të fshehur në këtë dialog – rrezikun e sinkretizmit dhe kompromiseve në besimin e tyre. Kohët e fundit, një vetëpërmbajtje në rritje është ngritur në shumë komunitete fetare që kanë lidhje me gjithë këtë proces të dialogut. Si rezultat, është e domosdoshme të gjesh një shteg ndërmjet ekstremeve, dhe të sqarohet edhe njëherë karakteri, qëllimi dhe shpresa e këtij dialogu, që nuk mund të ndryshojë bindjen personale dhe mirëbesimin e një besimtari të një feje konkrete”.

Dialogu gjithashtu nuk mund të

ketë si synim të bindë që perceptimet e njëres fe janë të drejta, ndërsa tjetra është në rrugën e gabuar. Një taktikë e tillë është totalisht e gabuar. Dialogu është njohje e tjetrit, duke e pranuar fenë tjetër ashtu siç është dhe jo siç duam ne që ajo të jetë. Fetë dallojnë nga njëra-tjetra dhe ne duhet të respektojmë këto dallime ndërmjet nesh dhe ajo që është më kryesorja, e që koha e lyp me ngashërim, është që të njohim dhe të bashkëndiejmë vlerat antropologjike, ekologjike, bamirëse si dhe të çdo gjëje që kontribuon në mbarëvajtjen, paqen dhe harmoninë në mbarë njerëzimin.

Pikërisht për këtë arsye, dialogu ndërftar është tregues i besnikërisë që kanë besimet e ndryshme fetare ndaj thelbit të besimit të tyre.

Në kohën tonë, është vendimtare të bëjmë një përpjekje të deshifrojmë simbolet e shenjta të feve të tjera dhe, me dashamirësi, të studiojmë mesazhin e tyre kryesor. Fetë si sisteme, sigurisht përmbajnë elemente pozitive dhe negative. Duke iu afruar dhe konsideruar sistemet fetare konkrete, ne duhet të evitojmë entuziazmin negativ ose kritikën përbuzëse. Ne rrezikojmë të përdorim njohuritë tona rreth njëres për të përgjithësuar pikëpamjet tona për sa i përket të tjerave.

Zhvillimi i dialogut dhe tolerancës fetare nuk imponon marrëveshje të përbashkëta, por respektimin e lirisë fetare dhe të

së drejtës së çdo njeriu të zgjedhë vizionin dhe rrugën që ai bindet të ndjekë në afrimin e tij me Hyjninë.

Në të kundërt, injorimi i domosdoshmërisë të zhvillimit të tolerancës, dialogut dhe të komunikimit ndërftar, do të thotë një stimulim i bombave të terroristëve dhe të raketave të të fuqishmëve. Pasojat e këtij “dialogu” i kemi ndjerë në mënyrë të dhimbshme në zhvillimet e fundit në rajone të ndryshme të botës.

Terrorizmi nuk ka fe. Terrorizmi nuk ka sistem vlerash ku të mbështetet. Terrorizmi nuk ka atdhe, – thotë shkrimtari ynë Ismail Kadare.

Fetë janë një faktor i rëndësishëm në jetën e një vendi, në zhvillimet historike, politike, sociale, kulturore madje dhe ekonomike të tij.

Megjithëse fetë kanë, sigurisht, një mesazh paqeje në thelbin e tyre dhe në trashëgiminë e tyre kulturore, pavarësisht nga kjo, ato janë shfrytëzuar për të shkaktuar luftëra. Ky shfrytëzim është futur në fuqi nga udhëheqësit politikë dhe ushtarakë, por ka qenë gjithashtu e mundur falë dobësisë së udhëheqësve fetarë, të cilët nuk kanë pasur fuqi të mjaftueshme për të kundërshtuar ideologjitë mbizotëruese dhe për t'i shndërruar përmbajtjet e besimeve të tyre në kulturë të shoqërisë civile.

Analiza e kësaj teme na tregon se historia nuk ka vetëm gjëra të bukura, por dhe situata gërryese.

Sido të jetë, brenda turpërisë së historisë zhvillohet e mira.

Historikisht shumë konflikte dhe luftëra janë servirur të mbuluara me petkun e fesë, duke fshehur interesat e ndryshme politike dhe fitimprurëse. Duhet qartësisht të theksohet këtu që çdo luftë e bërë në emër të fesë është një fyerje, madje një krim kundër vetë fesë.

Për rrjedhojë, përgatitja e duhur e feve të njerëzimit për zbutjen dhe kapërcimin e fenomeneve të sëmura të fanatizmit dhe të zemërngushtësisë fetare është kultivimi i frymës së tolerancës dhe të dialogut paqësor, i cili zvogëlon largësitë, krijon predispozitat për respekt reciprok dhe për bashkekzistencë paqësore ndërmjet popujve. Bashkekzistencën paqësore na e imponon edhe fryma ekumenike, e cila për të krishterët përbën esencën e dashurisë evangjelistike, e cila vazhdon të zhvillohet me gjithë vështirësitë që ekzistojnë sot. Kjo është një botë në të cilën duhet të marrin pjesë shoqëritë e të gjithë popujve dhe të të gjitha feve.

Në qoftë se kulturat dhe fetë e botës takohen kështu me njëra-tjetrën, në mënyrë që të mos duan tashmë të bashkohen në shërbimin e ndonjë modeli të qëllimtë dhe të bëhen vegla të tij, por të jetojnë në mirëkuptim reciprok dhe bashkëpunim, vetëm atëherë, mbase, do të mund të ofrojnë shumë në kërkesën e qëndrueshme për paqe dhe zhvillim.

Dialogu mes qytetërimeve të ndryshme i jep mundësi popujve që të arrijnë fuqinë kultivuese shpirtërore të feve dhe traditave të tyre kulturore, duke krijuar një bazë për shtytje dhe arritje të bashkëjetesës së popujve brenda një klime lirie dhe paqeje, ku përplasjet dhe mosmarrëveshjet do të shfaqen dhe do të ngrihen kaq dukshëm dhe sinqerisht, ku kurrë më të mos udhëzojnë në antagonizma dhe luftëra ushtarake dhe ekonomike.

Dhurata e tolerancës apo e lirisë fetare është e lindur dhe përbën elementin themelor të të drejtave të njeriut dhe të ndërgjegjes së çdo njeriu. Njeriu pa detyrim dhe pa trysni të jashtme mund të besojë dhe të shprehë përmbajtjen e besimit të tij.

Toleranca fetare mund të vihet re shumë lehtësisht këtu në Shqipëri. Toleranca në besim është një vlerë që ne e ruajtëm gjatë shekujve, duke u qëndruar sulmeve të shumta përçarëse.

Shqiptarët erdhën ndër shekuj si popull plurikonfesional, ku feja e mëparshme qëndronte në një kohë që një fe tjetër e re hynte, dhe kështu deri në ditët e sotme. Shqiptarët kanë ruajtur një traditë të bukur urimi të festave të besimtarëve të përkatësisë tjetër fetare. Kështu të krishterët bëjnë vizita për t'i uruar Bajramin myslimanëve dhe anasjelltas, myslimanët i urojnë të krishterëve Pashkën, Krishtlindjet etj. Shumë

domethënëse, kur kjo bëhej fshehtas nën terrorin e shpatës së egër të diktaturës komuniste.

Duke vazhduar me regjimin komunist, ju sjell një ndodhi nga burgjet famëkeqe të asaj kohe.

Në burgun e Tiranës ku ishte futur ajka e shoqërisë, ndodheshin gjithashtu dy figura të hierarkisë fetare: Episkop Irine Banushi dhe Haxhi Hafiz Ibrahim Dalliu, të dy veshur me rrobat e tyre fetare.

Persekutori i vendosur nga “pushteti popullor” duke dashur të tallej me klerikët, e heq kalimafin nga koka e episkopit dhe e vendos në kokën e Hoxhës, në të njëjtën kohë e merr taxhin e hoxhës dhe e vendos atë në kokën e episkopit. Duke qeshur me ironi u thotë:

Persekutori - o prift, si ndjehesh me çallmë në kokë?

Episkopi - Ndihem krenar që mbaj në kokë këtë veshje të Zotit.

Persekutori – Po ti o hoxhë me këtë kapele të priftit?

Hafizi- Nuk e di a i takon ky nder kokës sime për të mbajtur këtë kalimaf të shenjës.

Përgjigje prej njerëzish të mençur, që u kuptuan nga të gjithë, por besoj jo nga persekutori mjeran.

Nga moria e shembujve që sjell bashkëjetesa dhe komunikimi ndërftar në Shqipëri mjaftojnë këto dy shembuj, për të nxjerrë në pah se

kjo vlerë e çmuar e popullit shqiptar është treguar me vepra dhe sakrificë, më së pari nga prijësit fetarë, si dhe e përkrahur dhe e përjetuar nga populli besimtar.

Toleranca ndërftare nuk është e dhënë një herë e përgjithmonë, por është si një lule e brishtë që kërkon përkujdesje dhe dashuri që të mos vyshket, duke e vaditur me komunikim dhe mirëkuptim të sinqertë.

Në vendin tonë duket qartë se nuk është thjeshtë një bashkëjetesë e shtrënguar, por më tepër se kaq. Është një respektim i besimit të njëri-tjetrit me vetëdije të plotë. Kjo traditë e hershme shqiptare është sot në harmoni të plotë me standardet demokratike perëndimore të lirisë së besimit të gjithkujt e të respektit ndaj besimit të tjetrit, veçanërisht e spikatur në një demokraci të avancuar, multietnike e plurikonfesionale.

Në kohën tonë, kur kërkesa për paqe dhe bashkekzistencë në botë, liri dhe drejtësi është e imponuar, është e rëndësishme që fetë të gjenden në një komunikim mbarëbotëror ndërmjet tyre dhe të këmbejnë mendime së bashku për rryma të ndryshme të mendimit të të gjithë botës. Komunikimi do të na japë më shumë dije dhe mirëkuptim dhe do të na bëjë të hapim më shumë zemrat tona.

Imazhi i fesë islame në median shqiptare

Rasti Charlie Hebdo

MSc. Qani Sulku

Abstrakt

Sa e lehtë apo e vështirë është të ruash apo të përmirësosh imazhin pas një përbaltjeje me të drejtë apo pa të drejtë? Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH), i vetmi institucion përfaqësues i myslimanëve të Republikës së Shqipërisë, çfarë roli luajti në paraqitjen e imazhit të fesë islame dhe të myslimanëve, nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tij në programet televizive gjatë trajtimit të temave të ndryshme, të cilat patën në fokus rastin Charlie Hebdo? Sa profesionistë u treguan drejtuesit e programeve në trajtimin e temave të tilla, për të mos qenë të një-anshëm, apo për të mos krijuar perceptime dhe qëndrime të gabuara? Nga të ftuarit në programet analitike, a pati nga ata që kishin ardhur me qëllimin për të përbaltur fenë islame dhe vetë myslimanët? Vetë emërtimi i temave bazë të programeve, a ishte i duburi dhe i përzgjedhur me kujdes, apo kishte dhe emërtime temash që cenonin përkatësinë fetare të besimtarëve myslimanë? Këto janë disa prej pyetjeve, rreth të cilave do të përpiqem që të hedh dritë në këtë punim, duke vëzhguar, studiuar, krabasuar programet mediatike shqiptare të datës 7 janar 2015 e tutje, që patën si fokus të tyre rastin Charlie Hebdo dhe tema që ndërlidheshin me shkaqet që çuan në këtë akt tragjik.

1 - Hyrje

Ajo që ndodhi më 7 janar 2015, në redaksinë e revistës satirike “Charlie Hebdo” në Paris të Francës, ku u vranë 12 persona, ndër ta gazetarë dhe karikaturistë, dhe u plagosën 10

të tjerë, u pasqyrua dhe u analizua më pas, pothuajse në të gjithë botën.

Charlie Hebdo është një revistë franceze satirike javore, e njohur për tonin provokativ dhe trendin antireligjioz. Masakra që u krye në selinë e saj në 7 janarin e 2015-ës, u

cilësua si hakmarrje ndaj karikaturave të saj ndaj profetit Muhamed.

Si në shumë vende të tjera evropiane dhe jo vetëm, edhe në vendin tonë, rasti Charlie Hebdo zuri një hapësirë të konsiderueshme mediatike, jo vetëm informative, por edhe analitike. Shumë programe televizive, si dhe shumë gazeta të përditshme, i kushtuan një rëndësi të veçantë këtij rasti. Programe televizive “Talk show” dhe të formateve të tjera, duke marrë spunto nga ajo çfarë ndodhi në redaksinë e revistës satirike në Paris, sollën para publikut shqiptar tema që kishin lidhje me terrorizmin, përplasjen e kulturave dhe qytetërimeve, harmoninë ndërjetare në Shqipëri, dialogun ndërjetar, ksenofobinë, terrorizmin, etj.

Hipotezat që ngre në këtë studim janë:

Media shqiptare nuk është e përgatitur për trajtimin e çështjeve të tilla.

Media shqiptare, nga pakujdesia dhe mosprofesionalizmi, prodhoi situata islamofobe.

Media vizive dhe ajo e shkruar në Shqipëri, duke filluar që nga 7 janari 2015 e për tre javë rresht, pothuajse çdo ditë i ka rezervuar një hapësirë rastit në fjalë, temave dhe çështjeve që ndërlidheshin me Charlie Hebdo dhe shkaqet që mund të kenë çuar në këtë atentat. Këtu lind një pyetje:

A ishte e nevojshme që të flitej dhe të analizohej për një periudhë

trejavore, rasti i Charlie Hebdo-së në Paris për publikun shqiptar, një popull i njohur për dialogun dhe harmoninë ndërjetare?

Të ftuarit e ndryshëm në diskutimet televizive, a ishin të njerëzit e duhur për të trajtuar dhe analizuar tema kaq të ndjeshme, të cilat, po nuk u trajtuan dhe analizuan si duhet, mund të shkaktojnë keqkuptime, keqinterpretime dhe stereotipa, që mund të ndikojnë në nxitjen e konflikteve ndërjetare?

Ngjarja e Charlie Hebdo-së iu adresua fesë islame dhe ndjekësve të saj, si dhe ndikoi negativisht në imazhin e fesë dhe të vetë myslimanëve në mbarë botën. Këtu lind një tjetër pyetje me nënpyetje që duhen qartësuar:

Sa e lehtë apo e vështirë është të ruash/të përmirësosh imazhin pas një përbaltjeje me të drejtë apo pa të drejtë?

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH), i vetmi institucion përfaqësues i myslimanëve të Republikës së Shqipërisë, çfarë roli luajti në paraqitjen e imazhit të fesë islame dhe të myslimanëve, nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tij në programet televizive?

Sa profesionistë u treguan drejtuesit e programeve në trajtimin e temave të tilla, për të mos qenë të një-anshëm, apo për të mos krijuar perceptime dhe qëndrime të gabuara?

Nga të ftuarit në programet analitike, a pati nga ata që kishin ardhur me qëllimin për të përbaltur fenë islame dhe vetë myslimanët?

Vetë emërtimi i temave bazë të programeve, a ishte i duhuri dhe i përzgjedhur me kujdes, apo kishte dhe emërtime temash që cenonin përkatësinë fetare të besimtarëve myslimanë?

Këto janë disa prej pyetjeve, rreth të cilave do të përpiqem që të hedh dritë në këtë punim, duke vëzhguar, studiuar, krahasuar programet mediatike shqiptare të datës 7 janar 2015 e tutje, që patën si fokus të tyre rastin Charlie Hebdo dhe tema që ndërlidheshin me shkaqet që çuan në këtë akt tragjik.

Zgjedhja pikërisht, që në fokus të punimit tim, të jetë imazhi i fesë islame në median shqiptare, duke marrë spunto nga rasti i Charlie Hebdo-së, pasi ky rast për disa kohë u kthye në temën dhe çështjen më aktuale ndërkombëtare, e duke qenë i tillë, edhe në vendin tonë, u shndërrua në çështjen e ditës për një periudhë tre javore, në diskutimet e sferave të ndryshme, në mediumet e ndryshme, e në veçanti në televizion dhe në shtypin e përditshëm. Shkaku tjetër, që më shtyu ta përzgjedh këtë temë, është drejtimi im i studimit në master shkencor: “Komunikim Ndërkulturor”. Ky studim sjell një risi, për sa i përket qëndrimit dhe qasjes së mediave shqiptare për tema që ndërlidhen me shkencën e

komunikimit ndërkulturor, dialogut ndërfetar dhe imazhit mediatik të religjioneve.

Sipas mendimit tim, imazhi luan një rol shumë të rëndësishëm në komunikim. Ruajtjes dhe kultivimit të imazhit, çdo ditë e më tepër, i kushtohet rëndësi, qoftë në nivel individual, qoftë kolektiv, qoftë shtetëror apo jo. Mendoj se çelësi magjik për një imazh pozitiv është komunikimi i mirëmenaxhuar, duke pasur kujdes veçoritë e palës me të cilën kemi të bëjmë në lidhjet tona të përditshme apo sezonale, të afërta apo edhe të largëta. Për çështjen në fjalë, për imazhin e feve në përgjithësi, rol të rëndësishëm luan edhe dialogu ndërfetar dhe komunikimi ndërkulturor, si dy fusha të cilat të ndihmojnë për të njohur njëri-tjetrin dhe specifikat e gjithsecilit.

2 - Interpretim i programeve

Në këtë kapitull, do të mundohem të bëj një interpretim të përgjithshëm, në disa raste edhe të veçantë të programeve të përzgjedhura të këtij studimi, mbi disa veçori negative dhe pozitive, që shoqëruan bisedat dhe debatet mbi rastin Charlie Hebdo.

Programet që kam përzgjedhur, mbi të cilat do të paraqes një përjasje shkencore për tema të caktuara janë:

Programi “Tetë a Tetë” në A1 Report TV - 7 janar 2015

Programi “Tetë a Tetë” në A1

Report TV - 9 janar 2015

Programi “Tetë a Tetë” në A1
Report TV - 13 janar 2015

Programi “Top Story” në Top
Channel TV - 15 janar 2015

Emisioni “Shqip” në Top
Channel TV - 12 janar 2015

Emisioni: “Opinion” në TV
Klan - 8 janar 2015

Emisioni “Opinion” në TV
Klan - 19 janar 2015

Emisioni: “Oktapod” në Vizion
Plus TV - 13 janar 2015

Emisioni: “Kapital” në Vizion
Plus TV - 16 janar 2015

Emisioni “Tonight Ilva Tare” në
Ora News TV - 13 janar 2015

Media shqiptare nuk është e gatshme për trajtimin e temave që ndërlidhen me shkencat e komunikimit ndërkulturor dhe dialogut ndërfaqet, për faktin se i mungojnë specialistët në këto drejtime. Kjo u vu re në të gjitha programet televizive që trajtuan tema që ndërlidheshin me religjionet pas rastit të Parisit. Këtë shqetësim e vë në dukje edhe Dom Gjergj Meta, opinionist për çështje fetare në media, i cili në intervistën që zhvillova me të, ndër të tjera tha: “...ende nuk ka persona të përgatitur në fushën e gazetarisë të flasin për probleme fetare. Është një problem që unë e kam ngritur shpeshherë, që mediat duhet të kenë në gjirin e tyre persona të përgatitur në çështjet fetare, të përgatitur në kompetencë them. Nuk do të thotë që të jesh me patjetër besimtar për të folur për këto probleme, por

të kesh kompetencë studimore. Sigurisht në qoftë se dikush është edhe besimtar, kjo është një vlerë e shtuar, por kërkohet një njohje më e thellë e problemeve, qoftë të problemeve gjeopolitike për të cilët do të flasin ekspertët gjeopolitikë, por qoftë edhe për problemet fetare, ku duhet të flasin persona që i njohin çështjet fetare. Shpeshherë në këto probleme, ku ndërthuren, qoftë çështjet gjeopolitike, qoftë çështjet fetare, dhe kështu që nuk duhet të ngatërrohen kompetencat, por duhet të jenë ekspertët”.¹

Emërtimi i disa prej temave të programeve të përzgjedhura të këtij studimi, nuk ishin korrekte, pasi, ose nga pakujdesia, ose nga mos-thellimi mbi impaktin e tyre në publik, ndikonin drejtpërdrejt negativisht në imazhin e fesë islame. Disa prej këtyre temave ishin: *A na kërcënon terrorizmi islamik?* – temë e emisionit “Opinion” në Tv Klan, si dhe tema: *Islami, Evropa, Terrorizmi* – në Tonight Ilva Tare, në Ora News Televizion. Në momentin e parë që shikon të titruara të dy këto tema, të parën lidhje që bën është se terrorizmi na qenka pjesë e Islamit, ndërsa në të dytin, Islami prodhon terrorizëm në Evropë. Tema e dytë në Ora News Televizion përbëhej nga tre çështje madhore, të cilat duhet të ishin të ndara në emisione përkatëse për secilën çështje dhe jo të tria së bashku në një program të vetëm.

Gjatë pasqyrimin të programeve,

1. Intervistë me Dom Gjergj Meta,
<https://youtu.be/Sp3yySMqzHE>

vura re se mbi %80 e të ftuarve, nuk ishin personat e duhur për të komentuar dhe debatuar mbi rastin në fjalë, për arsye se, nga njëra anë, as nuk ishin të formuar profesionalisht në drejtime që mund të hidhnin dritë mbi çështjen. Nga ana tjetër, përpara se të vinin nëpër programe as nuk kishin përsiatur për temën që do të diskutonin. Nuk ishin fare të kujdesshëm në komentet e tyre, për tema kaq të ndjeshme dhe flisnin si për çështje të përgjithshme. Në lidhje me këtë, po sjell edhe konstatimin e ekspertit të komunikimit mediatic, pedagogut të shkencave të komunikimit Mark Marku, që më dha në intervistën që zhvillova me të: “Ky është një nga problemet e debatit mbi besimin në Shqipëri. Pjesëmarrësit në debat, janë injorantë ndaj çështjeve të besimit, pastaj nisur nga pozita laike, disa janë ateistë dhe nuk kanë parasysh specifikat e komuniteteve, kur diskutojnë për çështjet e besimeve, çështje që kërkojnë shumë informacion, bisedojnë si për çështje që ata i zotërojnë. Pak-kush i njeh specifikat e besimit. Pak-kush njeh sistemin e vlerave që besimet përcjellin. Nuk mund ta gjykojë se si funksionon besimi islam nga këndvështrimi se si funksionon besimi katolik. Duben kuptuar specifikat e besimeve dhe shpesh bëhen gafa të jashtëzakonshme. Këtu nuk njihet historia e besimeve, normalisht një person që nuk është praktikant, nuk i njeh specifikat e besimit. Ndryshe i njeh një besimtar, ndryshe një laik, ndryshe një teolog, një klerik, ndryshe një intelektual që vjen nga

fusha të tjera”. Ndërsa kur e pyeta se çfarë këshilloni për raste të tilla kur bëhet debat publik në media, prof. Marku u përgjigj: “Në fillim duhet të njohim mirë problematikën, në këtë rast për sa i përket besimeve, e këtu fatkeqësisht nuk ka specialistë. Mediat franceze, angleze apo italiane kanë specialistë që i dinë shumë mirë këto fusha, pra çështjet e besimit. Nuk mund të diskutosh për besimin islam, nëse s’ke lexuar Kur’anin; nuk mund të diskutosh për besimin katolik, nëse s’ke lexuar Biblën. Në debatet që u zhvilluan në median shqiptare mbi këto çështje, 80% e tyre nuk kanë lexuar tekstet bazë të besimeve përkatëse (tekstet e shenjta). Përveç të tjerash, nuk njohin aspektet e përditshmërisë së besimeve: çfarë do të thotë një ritual? Çfarë konotacioni ka për besimtarin; çfarë konotacioni ka për jobesimtarin? Në debatet mbi besimet, duhet më tepër profesionalizëm, më tepër dije. E dyta, duhet etikë. Ka qenë një traditë shumë e mirë e debatit religjioz më përpara, rezervoheshin shumë për të folur për besimin e tjetrit. Debatu duhet t’u libet më shumë besimtarëve të komunitetit, sesa atyre që vijnë nga jashtë. Emri i dikujt që flet për besimin e dikujt tjetër ka një konotacion simbolik. Në momentin që flet, shkakton probleme. Ky kujdes nuk ndodh në Shqipëri. Ne flasim për besimet sikur ato janë të këqija, ndërkohë që unë mendoj se besimet janë vlerë e shoqërisë. Besimi te Zoti është një vlerë individuale e çdo qytetari. Në këtë kuptim, debati është totalisht joprofesional, provokativ, më shumë krijon problem sesa zgjidh, dhe është krejtësisht i pa-orientuar. Ftohen disa

*njerëz që duan të marrin thjesht pjesë në debat publik?*²

Ndërsa myftiu i Tiranës, Ylli Gurra, në lidhje me këtë çështje më tha në intervistën që zhvillova me të: “... dy kabet që u rrahën më së tepërmi ishin spektri fetar dhe liria e fjalës dhe, në gjykimin tim personal, do të ishte më me vend që të gjitha panelet, diskutimet, komentimet, vlerësimet... të rrotulloheshin në pjesën, ka në njërin anë elita fetare dhe në anën tjetër ajo e shkencave të komunikimit, pra gazetarë, analistë, të cilët të ishin të thelluar në aspektin e komunikimit publik dhe pjesa tjetër domosdoshmërisht të ishte pjesa e elitës fetare, myslimanët së pari dhe pastaj edhe religjionet e tjera mund të ishin pjesë e këtyre komunikimeve.”

Media shqiptare prodhoi dhe islamofobi, për shkak të shkujesjes, si p.sh.: me termin *terrorizëm islamik*, i cili u përdor aq shpesh nëpër të gjitha programet, duke ia ngjitur atë fesë islame dhe pasuesve të saj, madje një prej temave ishte nën titullin: *A na kërcënon terrorizmi islamik?* Në momentin që përdoret ky term në media, publiku që nuk ka informacionin e nevojshëm dhe të duhur, krijon stereotipi mbi fenë islame dhe ndjekësit e saj. Mbi këtë term, studiuesi Besnik Sinani, në një prej programeve televizive, u shpreh: *“Jo vetëm që nuk është politikisht korrekte dhe sjell një emër të keq për pasuesit e një feje, por edhe në aspektin analitik”*. Pati edhe programe në të cilat, cenimi i

simbolikave fetare islame, Librit të Shenjtë të Kur’anit, si dhe të profetit Muhamed, ishte më i dukshëm. Përmendim këtu programet “Top Story” dhe “Shqip” në Top Channel, si dhe “Kapital” në Vizion Plus. Në programin “Shqip”, ku u fol për lirinë e shprehjes, u publikuan edhe karikatura të Charlie Hebdo ndaj profetit Muhamed, karikatura të cilat u refuzuan për t’u botuar nga prestigjioze evropiane dhe perëndimore. Në pjesën tjetër të programit u vu re një lloj situatë anti-islame, e krijuar nga drejtuesi si dhe nga i ftuari Mustafa Nano, i cili nëpërmjet një shkrimi të tij nën titullin: *Liria e shprehjes vlen më shumë se të gjithë librat e shenjtë*, që u cek edhe në program, cenoi vlerat dhe shenjtërinë e librave hyjnorë. Ndërsa programi “Shqip” devijoi në pjesën e tretë të tij nga fokusi i temës. Nuk e di nëse ishte bërë me qëllim, apo jo. Në këtë pjesë ishin ftuar dy gazetarë nga Kosova, të njohur për qëndrimet dhe veprimet e tyre në media kundër Islamit dhe disa grupeve të caktuara nga mesi i myslimanëve të Kosovës. Nuk tingëlloi bukur, shfaqja e urrejtjes së tyre publikisht në media ndaj individëve, të cilët janë drejtues të lartë të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe ndaj disa grupeve islame si Forumi i të Rinjve Myslimanë të Kosovës. Një tjetër rast është edhe Ben Blushi në emisionin “Opinion”, nëpërmjet qëndrimit të tij mediatic, por edhe

2. Intervistë me Prof. Mark Marku, <https://youtu.be/bSj43qEJNVU>

nëpërmjet shkrimeve apo librave të tij të botuar së fundmi, ka shprehur haptazi që është kundër Islamit si fe. Nuk mjaftohet me kaq, por shkon edhe më tej duke përbaltur vlera dhe citate hyjnore të librave të shenjtë, apo duke satirizuar figurën e profetit Muhamed. Rast tjetër mund të përmendim Sokol Shametin, i ftuar në emisionin “Kapital”, i cili deklaroi se ishte ateist, se nuk e kishte lexuar kurrë as Kur’anin dhe as Biblën dhe fliste për fenë islame dhe për ndjekësit e saj pa pasur fare informacion dhe dije. Rrjedhimisht, gjithçka që thoshte, ndikonte negativisht në imazhin e fesë islame.

Ajo që bie në sy, pothuajse në të gjitha programet televizive, që i kam përzgjedhur si pjesë e studimit, është se nuk bëhet nga ana e drejtuesve të tyre një rezymë, një përmbledhje, për të nxjerrë konkluzionet mbi çështjet e diskutuara nga paneli. Do ishte mirë që të nxirreshin konkluzionet, në mënyrë që të qartësohen koncepte të caktuara edhe për vetë pjesëmarrësit e debatit, por edhe për audiencën. Një tjetër veçori e programeve televizive, është dalja nga boshti i temës dhe kalimi nga dega në degë. Kjo besoj se ka ndodhur për shkak të mospërgatitjes nga ana e panelit për çështje të caktuara.

Për sa i përket kohës televizive që iu kushtua trajtimit të rastit Charlie Hebdo dhe temave të ndryshme që ndërlihdeshin me të, ja se si m’u përgjigjen disa prej personazheve që

zhvillova intervistë me ta:

Hoxhë Ahmed Kalaja: “Është e vërtetë që kishte shumë trajtesa. Ne kemi prirje të qajmë më shumë ballin e tjetrit sesa ballin tonë. Po edhe mungesa se me çfarë ta mbushësh programin, ky është një problem tjetër. Charlie Hebdo ishte rasti i mirë për t’u trumbetuar, për t’u bërë zhurmë për diçka, ndërkohë mund të ketë pasur me dhjetëra raste të ngjashme të shpërndara nëpër botë, që mund të kenë marrë ndonjë cep gazete. Në Shqipëri trajtimin e këtij rasti në programet televizive e shoh si *ekzagjerim*”.³

Myftiu Ylli Gurra: “Mbetet në dorë të medias se, për sa kohë e mban në fokus një ngjarje apo ndodhi të caktuar, një lëvizje apo një dalje e qeverisë dhe e funksionarëve të lartë fetarë të një vendi për një rast që pati një jehonë jo kontinentale por ndërkombëtare. Ajo që mbetet për t’u vlerësuar në çështjen mediatike, qoftë vizive, qoftë të shkruar në Shqipëri, është mënyra apo këndvështrimi se si e shohim. Unë nuk e shoh të tepruar, vlerësim do ta quaja në sensin pozitiv interesimin e domosdoshëm për ta përcjellë qoftë në thell se çka përmbante, apo cila ishte domethënia e vërtetë e kësaj pjesëmarrjeje, apo demonstrimin e një vlere që ka kombi shqiptar në Paris në janar të 2015. Njëherazi tërheqje e vëmendjes së opinionit publik për disa vlera që janë të mirëtrashëguara, pavarësisht se kemi jetuar një tmerr në komunizëm dhe ateizëm njëherazi për rreth tre dekada, me ia rikujtuar dhe rifreskuar shoqërisë sonë se, vlerat nuk mund të jenë dhe të

3. Interviste me hoxhë: Ahmed Kalaja, <https://youtu.be/m3WKdpFq9Fk>

mbeten immune, nëse nuk investohet nga shoqëria, qoftë ato religjioze në aspektin fetar mysliman dhe të krishterë, por edhe mosinteresimi i shtetit.”⁴

Dom Gjergj Meta: “Unë mendoj që këtyre temave u dubet kushtuar gjithmonë vëmendje dhe asnjëherë nuk është tepër. Terrorizmi kur shfaqet, i çfarëdo matrice që të jetë, është një e keqe që dëmton bashkëjetesën njerëzore, sidomos kur terrorizmi merr ngjyrime fetare, bëhet edhe më i rrezikshëm, për arsye se mbledh një urrejtje të themeluar shpesh në dimensionin shpirtëror të njeriut. Gjithë çështja mbetet jo te hapësira që i kushtohet, dubet të ketë hapësirë, por te drejtësia e trajtimit të të tilla çështjeve, personat që i trajtojnë në media, sa janë të aftë të jenë objektivë, të jenë të matur në gjërat që thonë dhe kompetentë. Pastaj harmonia dhe toleranca fetare nuk janë në kundërshtim mbi trajtimin apo debatin për këto çështje, përkundrazi, harmonia mund të përforcohet edhe më tepër. Fetë, duke u distancuar nga fenomenet ekstreme, nga dukuritë ekstremiste, kanë më shumë mundësi dialogu midis tyre për të mirën e bashkëjetesës.”⁵

Besnik Mustafaj: “...ishite e nevojshme. Nuk jam në gjendje të gjykoj nëse opinioni publik, konsumatori i këtyre mediave ishte po aq i interesuar, aq sa ishin redaktorët e gazetave apo drejtuesit e mediave, sepse nuk kemi një studim se çfarë pret publiku nga media, por gjithsesi ishte në koherencë me qëndrimet që mbajti

media e vendeve të lira. Nuk është e tepërt, asnjëherë nuk është e tepërt. Shqipëria shqubet për harmoni ndërjetare, por nuk është immune. Ne kemi raste dramatike siç ka në Paris, në Londër e Kopenhagën, raste myslimanësh të radikalizuar, të devijuar nga doktrina myslimane, në këtë kuptim nuk ishte e tepërt, por informacioni nuk u drejtobet vetëm myslimanëve. Informacioni i mediave ishte për të gjithë opinionin publik.”⁶

Përfaqësuesit e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u prezantuan denjësisht, si dhe paraqitën me maturi vlerat e besimit islam, si dhe u përballën, po me të njëjtën maturi me komente dhe kundër-argumente. KMSH dërgoi në media për të marrë pjesë në trajtimin e temave të ndryshme më kompetentët e tij si për shembull: Elvis Naçi – Drejtor i Mesazhit Islam pranë KMSH, in johur në opinionin publik për oratorinë e tij dhe përgatitjen në propagandën fetare islame. Një prej përfaqësuesve në median shqiptare ishte edhe vetë Myftiu i Tiranës, Ylli Gurra, i cili ishte edhe i deleguari i KMSH-së për të qenë pjesë e delegacionit shqiptar në marshimin e Parisit. Gjithashtu, i pranishëm në disa prej programeve të përzgjedhura në këtë studim ishte edhe Hoxhë Ahmed Kalaja, edhe ky i njohur në publik për oratorinë e tij dhe tërheqjen e brezit të ri drejt fesë islame. Pozitivisht dhe denjësisht u prezantuan edhe përfaqësuesit

4. Intervistë me myftiun e Tiranës: Ylli Gurra, <https://youtu.be/S0z2Cerm9Xc>

5. Intervistë me Dom Gjergj Meta, <https://youtu.be/Sp3yySMqzHE>

6. Intervistë me Besnik Mustafaj, <https://youtu.be/nc5eR8c2e5w>

e komuniteteve të tjera fetare, ku atë harmoni që e proklamojmë edhe jashtë vendit e argumentuan edhe nëpërmjet deklaratave të tyre unifikuese. Përfaqësuesit e KMSH-së shfrytëzuan pozitivisht hapësirën televizive që iu ofrua në këto programe për ta prezantuar fenë islame ashtu siç është, fe e paqes, e dashurisë dhe e humanizmit njerëzor dhe jo fe e terrorit, e dhunës dhe e ekstremizmit, siç paraqitet nga qarqe apo individë dashakeqë.

3 - Konkluzione dhe rekomandime

Duke analizuar programet mediatike shqiptare, që kam përzgjedhur në këtë studim, koha e të cilëve në total ishte 1110 minuta, si dhe duke iu referuar autorëve të huaj dhe botimeve të tyre më të fundit si për shembull: Karen Armstrong, Religion and the History of Violence – botim i vitit 2015; Tarik Ramadan, Të jesh mysliman evropian - botim i 2011; Ferid Muhiq, Identiteti islam i Evropës – botim i 2014, etj., apo autorë shqiptarë si p.sh.: Artan Fuga, Stereotipa mbi identitetin fetar / Komunikimi në shoqërinë masive – botim i 2014, apo autorë të tjerë si Mustafa Nano dhe Ben Blushi, gjithashtu, edhe nëpërmjet intervistave që kam zhvilluar me specialistë të komunikimit mediatik, përfaqësues të Komunitetit Mysliman dhe Katolik, gazetarë dhe drejtues programesh televizive,

drejtues të institucioneve të ndryshme, që ndërlidhen me kulturat dhe qytetërimet, arrita në disa përfundime, që do t'i shoqëroj më poshtë edhe me disa rekomandime përkatëse.

Media shqiptare nuk është e gatshme për trajtimin e temave që ndërlidhen me shkencat e komunikimit ndërkulturor dhe dialogut ndërfeetar, për faktin se i mungojnë specialistët në këto drejtime. Mediat duhet të kenë në gjirin e tyre persona të përgatitur në çështjet fetare, të përgatitur në kompetencë studimore, sigurisht në qoftë se dikush është edhe besimtar, kjo është një vlerë e shtuar, por kërkohet një njohje më e thellë e problemeve.

Pjesa më e madhe e të ftuarve, nuk ishin personat e duhur për të komentuar dhe debatuar mbi rastin në fjalë, për arsye se nuk ishin të formuar profesionalisht në drejtime që mund të hedhin dritë mbi çështjen. Në fillim duhet të njohim mirë problematikën, në këtë rast për sa i përket besimeve. Do të ishte më me vend që të gjitha panelet, diskutimet, komentimet, vlerësimet apo jo të tilla, të rrotulloheshin në pjesën ku në njërin anë elita fetare dhe në anën tjetër ajo e shkencave të komunikimit, pra gazetarë, analistë të cilët të ishin të thelluar në aspektin e komunikimit publik dhe pjesa tjetër domosdoshmërisht të ishte pjesa e elitës fetare.

Media shqiptare në rastin e Charlie Hebdo, nuk pati asgjë origjinale në informacionet, komentet dhe pikëvështrimet, pasi ato ishin të importuara, u morën nga shtypi i huaj dhe u përkthyen. Duke qenë se përkthimet nuk varen nga njerëz shumë profesionistë, nuk ishte e vështirë të vije re edhe konfuzion, sepse përkthimi bëhej keq. Identifikimi i termit mysliman me islamizëm, myslimanizëm me islamizëm, radikal apo të gjitha këto shpeshherë krijojnë konfuzion tek audienca.

Ajo që bie në sy, pothuajse të të

gjitha programet televizive, që kam përzgjedhur si pjesë e studimit, është se nuk bëhet nga ana e drejtuesve të tyre një rezymë, një përmbledhje, për të nxjerrë konkluzionet mbi çështjet e diskutuara nga paneli. Do ishte mirë që të nxirreshin konkluzionet, në mënyrë që të qartësohen koncepte të caktuara edhe për vetë pjesëmarrësit e debatit, por edhe për audiencën.

Përfaqësuesit e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u prezantuan denjësisht, si dhe paraqitën me maturi vlerat e besimit islam, si dhe u përballën, po me të njëjtën maturi me komente dhe kundër-argumente.

Bibliografia

Bela H. Banathy and Patrick M. Jenlink (2005): *Dialogue as a means of collective communication*. Kluwer Academic/Plenum Publisher, New York.

Jane Idleman Smith (2007): *Muslims, Christians, and Challenge of Interfaith Dialogue*. Oxford University Press.

Jonathan Magonet (2003): *Talking to the other / Jewish interfaith dialogue with Christians and muslims*, I.B. Tauris/London, New York.

Maire Byrne (2011): *The names of God in Judaism, Christianity, and Islam*, Pndar NZ. New Zealand.

Milan Vukomanovic and Marinko Vcinic, *Religious dialogue in the Balkans: The drama of understanding*.

Karen Armstrong (2015): *Fields of Blood: Religion and the History of Violence*. Penguin Random House. UK.

Tarik Ramadan (2011): *Të jesh mysliman evropian*, Logos-A. Maqedoni.

Ferid Muhiq (2014): *Identiteti islam i Evropës*, Logos – A. Maqedoni.

Artan Fuga (2014): *Stereotipa mbi identitetin fetar, Komunikimi në shoqërinë masive*. Tiranë, f. 335-363.

Erving Goffman: (1959): *The Presentation of self in everyday life*, Garden City, (edizione italiana, Bologna: Il Mulino, 2011), f. 11.

Michael Kunzik (1997): *Images of Nations and International Public Relations*; Lawrence Erlbaum Associates- Publishers Mahwah, New Jersey, f. 1.

Kur'ani, Suretu Bekare, Vargu 256.

Saba Mahmood (2009): *Religious Reason and Secular Affect: An Incommensurable Divide?* *Qritique Secular? Blasphemy, Injury, and Free Scpeech*, f. 64.

Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 714.

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam, “**Rreth lirisë së shprehjes së mendimit: rregullat dhe dispozita**”, Vendimi nr. 176 (2/19) Emiratat e Bashkuara Arabe, 26-30 prill 2009.

Feja dhe kombi

http://www.youtube.com/watch?v=DdZ9BnFAu1s&feature=youtube_gdata_player

- Abdu Muhtar Musa, *Bota myslimane karsbi Perëndimit*
<http://www.onislam.net/english/politics/transnational/431049-muslim/world/and/west.html>
shqip.com/2015/1/10/ Liria-e-shprehjes-vlen-më-shumë-se-të-gjithë-librat-e-shenjtë
<http://www.e-zani.com/2015/01/12/charlie-te-e-gazetarise-shqiptare/>
Tarek Mitri, Marrëdhëniet mes myslimanëve dhe të krishterëve
<http://erasmusi.org/marredheniet-mes-myslimaneve-dhe-te-krishtereve/>
- A1 Report - Tete a Tete, *Ksenofobitë, terrorizmi, kriza globale* (7 janar 2015) <https://youtu.be/S5auyrWHf2Q>
- A1 Report - Tete a Tete, *A dubet te kete kufi për satirën* (9 janar 2015)
<https://youtu.be/M0OQ6KXRnFA>
- A1 Report - Tete a Tete, *Harmonia fetare e Shqipërisë në Paris* (13 janar 2015)
<https://youtu.be/nNrFn5gHtwc>
Top Story, 15 janar 2015, - Top Channel Albania - Political Talk Show
<https://youtu.be/fpeblxCub7M>
<https://youtu.be/L5KZkF2Et0w>
<https://youtu.be/qQgvMZFUSIA>
Shqip, 12 Janar 2015 - Top Channel Albania - Political Talk Show
https://youtu.be/-NhK2f_irbI
https://youtu.be/X7aj33_TOTM
<https://youtu.be/DBXFOUmx73c>
- Opinion - *A na kërcënon terrorizmi islamik-* (08 janar 2015)
<https://youtu.be/CJ0rhPLxLq4>
- Opinion - *Toleranca fetare, realitet apo mit-* (19 janar 2015)
<https://youtu.be/1nt2Bubrdg>
- Emisioni ‘Oktapod’ 13 janar 2015 http://www.youtube.com/watch?v=hi8e4uXtFsM&feature=youtube_gdata_player
- Kapital - Bashkëjetesa mes besimeve. - 16 janar 2015 - Talk show - Vizion Plus
<https://youtu.be/RmRThXoR97U>
<https://youtu.be/mhP9ykjRkpQ>
<https://youtu.be/4VYAYCKrU4s>
Tonight Ilva Tare “Islami, Evropa, Terrorizmi”
<https://youtu.be/4VYAYCKrU4s>

Moderniteti dhe ideologjia në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane

(Shqipëria dhe shqiptarët në tekstet e shkollave osmane)

Dr. Hasan Bello

Qendra e Studimeve Albanologjike,
Instituti i Historisë, Tiranë

Abstrakt

Në tekstet shkollore osmane nuk mund të thuhet se flitej hapur mbi racat dhe kombet, por kishte raste kur në kuadër të trajtimit të aspekteve të veçanta me karakter gjeografik, përsëkrubeshin edhe detaje me interes për kombin tonë. Kështu, në tekstin “Gjeografia osmane” (“Coğrafya-yz Osmani”) në të cilin trajtoheshin karakteristikat e disa krabinave dhe popujve të Perandorisë, si shembull i mikpritjes dhe bujarisë merrej populli shqiptar. Mungesën e bujtinave (haneve) në qytetet shqiptare, autori e shpjegonte me faktin se te ky popull kjo traditë zinte një vend të rëndësishëm. Sipas tij, çdokush që udhëtonte nëpër Shqipëri dhe ngelte në mes të rrugës, qoftë ky mysliman ose i krishterë, nëse trokiste në derën e shqiptarit bëhej mysafir në shtëpinë e tij. Bujtësi ishte i detyruar që mikut t’i siguronte ushqim për aq ditë sa ai do të qëndronte.

Në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane vihet re se janë pasqyruar të gjitha etapat e modernizimit dhe ideologjia zyrtare e kohës. Kështu, në periudhën e Tanzimatit (1839-1876), në tekstet dhe programet shkollore i kushtohet

rëndësi e madhe identitetit osman të nënshtetasve të Perandorisë. Kjo politikë ishte në përputhje me zhvillimet e ngjashme të ndërtimit të identiteteve perandorake që kishin filluar të ndiqnin në këtë kohë edhe shtetet evropiane.

Në etapën e dytë, e cila përfshin

periudhën e Sulltan Abdulhamidit II (1876-1909), në tekstet dhe programet shkollore zë vend ideologjia panislamiste si element përbashkues i të gjithë popujve të Perandorisë përballë rrymave nacionaliste (turke, arabe, shqiptare, kurde, etj...), që krahas zhvillimit të tyre normal, si rezultat i rrethanave historike, nxiteshin edhe nga shtetet evropiane si diversion dhe presion ndaj politikës centralizuese të Abdulhamidit II.

Në etapën e tretë, e cila përfshin periudhën pas shpalljes së Kushtetutës së dytë (1908), në tekstet dhe literaturën shkollore të Perandorisë Osmane merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe politika e ndërtimit të identitetit kombëtar.¹ Një trajtim pak a shumë të ngjashëm lidhur me këtë trajktore kishte bërë që në vitin 1904 edhe një nga themeluesit e nacionalizmit turk, Yusuf Akçura (Jusuf Akçura)². Në një seri të gjatë shkrimesh të botuara në gazetën “Türk” (“Turk”) që asokohe dilte në Kajro, ai shkruante se në periudhën e Tanzimatit ishin bërë përpjekje për të krijuar popullin osman, në periudhën e Abdulhamidit II, popullin islam dhe se pas kësaj periudhe kishte filluar

1. Mehmet Ö. Alkan, “Osmanlı İmparatorluğu'nda Modernleşme ve Eğitim”, *TALID*, 6 (12), 2008, s. 13-14.

2. Yusuf Akçura (1876-1835) një nga themeluesit dhe teoricienët më të njohur të nacionalizmit turk. Autorë i disa librave dhe artikujve mbi këtë tematikë.

krijimi dhe ndërtimi i një identiteti të ri kombëtar, atij turk.³

Në periudhën e Tanzimatit, përveç festave me karakter fetar si ditë pushimi, ishte edhe data e hipjes në fron të sulltanit, ndërsa në periudhën e Abdulhamidit II u shtua si ditë pushimi edhe ditëlindja e tij. Ndryshime thelbësore ndodhën sidomos pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908 kur në kalendar u shtua si festë kombëtare edhe dita e shpalljes së Kushtetutës, ndërsa në tekstet shkollore u futën koncepte bashkëkohore të sistemit politik dhe shtetit kombëtar, si: atdheu, populli, shteti, kushtetuta, parlamenti, zgjedhjet, legjislacioni, sistemi gjyqësor, etj.

Zyrtarisht tekstet e para shkollore mbi historinë dhe gjuhën osmane filluan të shkruheshin në vitin 1850. Në periudhën e Tanzimatit, në shkollat osmane bëhej përpjeke që brezi i ri të edukohej me dashurinë për “atdheun osman”. Koncepti “atdhe” (“vatan”) në literaturën shkollore të Perandorisë Osmane i përket kësaj periudhe. Ky koncept shumë shpejt do të bëhet një nga temat më të parapëlqyera dhe më të debatueshme nga Osmanët e Rinj (“Yeni Osmanlılar”)⁴. Një përhapje

3. Këto teza dhe shkrime ai i përmbloodhi në librin e tij të njohur *Üç tarzi siyaset*, Istanbul, 1912..

4. Osmanët e Rinj (“Yeni Osmanlılar”) janë pararendësit e Turqve të Rinj ose xhonturqve. Kjo shoqëri gjysmë ilegale u themelua në vitin 1865 nga një grup intelektualësh osmanë të cilët nën shembullin e Revolu-

të gjerë në masat e popullsisë dhe te shtresa intelektuale e Perandorisë Osmane ai do të gjejë sidomos nga vepra teatrale e Namik Kemal-it⁵ “Vatan yahut Silistre”, subjekti i së cilës fund e krye përshkruhet nga patriotizmi romantik. Sipas shumë studiuesve të historisë së letërsisë osmane kjo vepër është botuar në dy versione. Në versionin e pacensuruar të shtypur ilegalisht, pjesa teatrale mbyllet me fjalët “Rroftë Atdheu. Rrofshin Osmanët” (“Yaşasın Vatan. Yaşasın Osmalılar”), ndërsa në botimin zyrtar ajo mbyllet me urime drejtuar sovranit “Rroftë Sulltanil Rroftë Sulltani” (“Padişahım Çok Yaşa! Padişahım Çok Yaşa”). Si rezultat i ndikimit që kjo pjesë pati kur u vu në skenë, Namik Kemal-i u internua, ndërsa vepra e tij u ndalua, për shkak se ajo tentonte të zëvendësonte dashurinë dhe bindjen ndaj sulltanit, me dashurinë për atdheun.

cionit Francez dhe zhvillimeve politike e kulturore në vendet evropiane mendonin se, P-Osmane mund të shpëtonte vetëm duke u demokratizuar. Një kërkesë tjetër e tyre ishte shpallja e kushtetutës dhe drejtimi i vendit nga një grup individësh të përzgjedhur siç ishte parlamenti.

5. Namik Kemal (1840-1888) mendimtar dhe shkrimtar osman me origjinë shqiptare i gjysmës së dytë të shek. XIX. Autor i disa veprave letrare dhe teatrale që kanë lënë gjurmë në historinë e letërsisë osmane. Në veprat e tij kultivohet dashuria për atdheun osman. Ai njihet gjithashtu edhe si një nga përfaqësuesit më të njohur të lëvizjes së Osmanëve të Rinj

Tek Osmanët e Rinj koncepti “atdhe” (“Vatan”) sinjifikohej me kërkesën për miratimin e Kushtetutës dhe hapjen e parlamentit, të cilat në thelb e kufizonin pushtetin e sulltanit dhe automatikisht e kthenin Perandorinë Osmane në Monarki Kushtetuese.

Duke nisur nga viti 1880 në sistemin arsimor osman lëndët fetare morën rëndësi të madhe. Në programet dhe në tekste shkollore tani e tutje filloi të propagandohej politika panislamiste. Kjo për shkak se nga shkollat në të cilat lëndët shkencore-pozitiviste ishin futur që nga koha e Tanzimatit po dilnin çdo ditë e më shumë kundërshtarë të regjimit. Prandaj, Abdulhamidi II u përpoq që sistemin arsimor osman ta përdorte në funksion të politikës së tij panislamiste, për të formuar nëpunës të lidhur me sulltanin dhe me Islamin zyrtar. Ndërkohë që shtresa e dijetarëve (ulematë) u la jashtë këtij sistemi. Një dukuri e tillë nuk ishte specifike vetëm për Perandorinë Osmane, e njëjta gjë ishte duke ndodhur edhe në perandoritë fqinje dhe shtetet evropiane. Kështu, duke nisur që nga viti 1884, Car Aleksandri i III e kishte shtuar numrin e orëve fetare në shkollat ruse.⁶

Nga një vështrim qoftë dhe i përciptë i teksteve osmane vihet re

6. Robert Gilda, *Barricades and Borders Europe 1800-1914*, Oxford: Oxford University Press, 1987, p. 352.

se çdo epokë ka lënë gjurmët e saj. Në kapakun e botimit të dytë të tekstit shkollor “Gjeografia osmane” (“Coğrafya-yı Osmani”) theksohej rëndësia që Sulltan Abdulhamidi II i jepte arsimit dhe se çdo “mrekulli industriale” që po ndodhte brenda Perandorisë në këtë periudhë ishte rezultat i sistemit arsimor të ngritur prej tij.⁷ Në parathënien e tekstit “Ruajtja e Shëndetit” (“Hıfz-ı Sıhhat”) autori e quan Sulltan Abdulhamidin II si sundimtarin më të lavdishëm dhe më të drejtë të kohës.⁸

Në tekstet shkollore përgjithësisht ushqeje fryma e tolerancës fetare. Kjo për shkak se Perandoria Osmane kishte edhe nënshitetas jo-myslimanë, të cilët që nga koha e Sulltan Mehmet Fatihut II (1432-1481) njiheshin si komunitete më vete (miletë). Fëmijëve myslimanë u ndalohej që të kritikonin fetë e tjera dhe në vend që t’u mësoheshin “gabimet” apo “mangësitë” e tyre, u mësoheshin urdhëresat, ndalesat dhe monoteizmi i pastër islam.⁹

Në periudhën e Abdulhamidit II superioriteti i qytetërimit perëndimor nëpër tekstet shkollore kishte filluar të pranohej haptazi. Në tekstin “Gjeografia e re” (“Yeni Coğrafya”),

në kapitullin ku trajtohej kontinenti evropian, autori i drejtohet nxënësve me fjalët: “Siç e shikoni edhe në hartë, megjithëse kontinenti evropian krahasuar me katër kontinentet e tjerë është më i vogël, përsëri ai është më i qytetëruar. Popullsia e tij krahasuar me popullsinë e kontinenteve të tjerë është më e përparuar në shkencë, art dhe tregti”.¹⁰ Por nëse nga një anë atyre iu sugjerohej që Evropa dhe shoqëria perëndimore të merreshin si shembull për përparimin që kishin arritur në fushën shkencore dhe teknologji, nga ana tjetër iu bëhej thirrje që të bënin kujdes për të ruajtur zakonet dhe traditat osmane, veshjet dhe moralin islam.¹¹

Në kuadër të politikës panislamiste, që ishte kthyer në doktrinë zyrtare të shtetit osman, në tekstet shkollore si sulltani më i lavdishëm nuk cilësohej më Sulltan Sulejman Kanuni (1520-1566), por Sulltan Javuz Selimi (1512-1520), sepse ky i fundit kishte qenë i pari që kishte transferuar qendrën e kalifatit nga Bagdadi në Stamboll dhe e kishte pastruar Anadollin nga shizmi duke e sunizuar.¹² Besnikëria dhe bindja ndaj sulltanit në tekstet shkollore konsiderohej jo vetëm si detyrë patriotike, por edhe si

7. Ahmet Celal, *Coğrafya-yı Osmani*, Istanbul: Mekteb-i Harbiye Mat., 1316 (1900).

8. Besim Ömer, *Hıfz-ı Sıhhat*, Istanbul: Karabet Mat., 1318 (1902), s. 1.

9. Ali Tevfik, *Yeni Coğrafya*, Istanbul, 1305, s. 18.

10. Azmi, *Yeni Coğrafya*, Dersaadet: Kasbar Mat, 1314, s. 58.

11. Ayşe Sıdıka, *Usul-ü Talim ve Terbiye*, Istanbul: Alem Mat, 1313, s. 46.

12. François Georjeon, *Sultan Abdülhamid*, Istanbul: Homer Kitabevi, 2006, s. 228.

obligim fetar për çdo shtetas osman. Qëllimi kryesor i sistemit arsimor mbi të gjitha ishte edukimi dhe përgatitja e kuadrove besnikë ndaj sulltanit e kalifatit.¹³ Krahasuar me periudhën e Tanzimatit ku vihej re një lloj liberalizmi, në epokën e Abdulhamidit II, në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane, iu kushtua rëndësi e madhe përhapjes së sunizmit e sidomos shkollës juridike hanefite¹⁴. Në disa tekste shkollore tani bindja dhe besnikëria ndaj sulltanit konsiderohej si “vacib” (obligim fetar pothuajse kategorik),¹⁵ e në disa të tjera si “farz” (obligim fetar kategorik).¹⁶

Pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, partia “Bashkim dhe Përparim” u përball me një nevojë më të madhe se sa regjimi i vjetër që t’i shpjegonte popullit të mirat që sillte Kushtetuta dhe sistemi

parlamentar. Prandaj, krahasuar me periudhën e mëparshme, tekstet shkollore osmane iu nënshtuan një kontrolli akoma dhe më të rreptë. Ato fillimisht u spastruan nga të gjitha simbolet e ideologjisë panislamiste të epokës së Abdulhamidit II; fjalët lavdëruese që shkruheshin për sulltanin tani u hoqën; ndërsa nga njëra anë ngrihej në qiell regjimi kushtetues, nga ana tjetër kritikoheshin ashpër Abdulhamidi II, i cili kishte shfuqizuar kushtetutën dhe kishte shpërndarë parlamentin. Një dukuri tjetër që vihet re në tekstet shkollore të kësaj periudhe është edhe fakti se, ngjyrimi fetar tani zuri të zbehej dhe të zinte një vend gjithnjë e më të vogël se më parë.

Në ndonjë tekst, indirekt ose duke përdorur një gjuhë të kujdesshme, kishte filluar të mbahej qëndrim kritik ndaj sulltanit dhe të propagandohej se republika ishte një formë më e përparuar se monarkia. Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat politike, kur pjesa dërrmuese e popullsisë ishte e lidhur prej shekujsh me dinastinë osmane e sulltanin, bëhej kujdes që kjo të mos ngjallte reagimin e masës myslimane. Po në të njëjtin tekst ku vlerësohej forma republikane e regjimit ishte vendosur edhe një tregim në të cilin djali pyeste babanë nëse kjo formë do të zbatohesh edhe në Perandorinë Osmane. Përgjigjja ishte tej mase interesante, sipas “babait”, ky regjim politik ishte i pamundur të zbatohesh

13. Namik Sinan Turan, “Osmanlı Toplumunda Modernleşme ve Eğitimin Ideolojik Dönüşümüne Dair Gözlemler”, *Folklor Edebiyat*, Ankara 2008, c. 14, sy. 55, s. 123.

14. Shkolla juridike hanefite është një nga katër shkollat juridike të islamit suni. Kjo shkollë është themeluar nga juristi i njohur Ebu Hanife (v. 767) dhe përfshin një sërë rregullash të praktikimit të fesë islame më shumë të përshtatshme për zonat urbane. Në Perandorinë Osmane kjo shkollë ishte përcaktuar edhe si linjë zyrtare.

15. Ahmed Ziyaeddin, *Vesitü'n-Necat*, Dersaadet: Şirket-i Mürettibiye Mat, 1317, s. 5-6.

16. Ahmed Cevdet, *Eser-i Abd-i Hamdi*, Istanbul: Matbaa-i Amire, 1309, s. 26-29.

në Perandorinë Osmane. Në radhë të parë për shkak se kjo perandori përbëhej nga kombe të ndryshme, të cilët do të kërkonin që presidenti i republikës të ishte nga kombi i tyre dhe në radhë të dytë për shkak se ky shtet ishte themeluar nga dinastia osmane, e cila kishte sakrifikuar shumë dhe i kishte shërbyer prej shekujsh këtij populli. Prandaj, autori i këtij teksti konkludonte se shteti osman nuk mund të bëhej republikë.¹⁷

Në përputhje me zhvillimet politike që ndodhën pas Revolucionit Xhonturk në tekste tani theksohej kontributi i ushtrisë në realizimin e revolucionit dhe hyjnizohej roli i kushtetutës, duke e barazuar atë me lirinë. Koncepte të tilla si: atdheu, kombi, shteti, kushtetuta, parlamenti, zgjedhjet, ligji, gjykatat, etj., të cilat më shumë se sa perandorake ishin karakteristike për shtetet kombe ishin të pranishme kudo.¹⁸ Në tekstet shkollore tani filloi të propagandohej një ideologji e re, e cila nga studiuesit është emërtuar si një “sintezë turkoislame”. Nxënësit nuk ishin më të detyruar të brohorisnin “Rroftë Sulltani”, por recitonin vjersha fetare e patriotike për atdheun (“vatanin”) dhe kombin osman. Abdulhamidi II

konsiderohej si despot dhe periudha e tij si diktaturë kur populli vuante nga shtypja e mungesa e lirisë. Tani apologjizohej kontributi i ushtrisë dhe i partisë “Bashkim dhe Përparim”, e cila pasi kishte rrëzuar sulltanin, kishte shpallur Kushtetutën dhe i kishte rikthyer popullit lirinë.

Nga pikëpamja e kulturës politike, krahasuar me tekstet shkollore të periudhës së Abdulhamidit II, pas vitit 1908 vihen re ndryshime thelbësore. Nëse më parë bindja dhe besnikëria ndaj sulltanit konsiderohej si obligim fetar, tani bëhej thirrje për besnikëri ndaj atdheut, Kushtetutës dhe ligjeve. Shkolla nuk konsiderohej më vetëm si institucion shtetëror, por edhe si mjet socializues-partiak me anë të së cilës xhonturqit propagandonin pikëpamjet e tyre politike. Madje, për të arritur objektivat e saj, partia “Bashkim dhe Përparim” në disa zona të caktuara hapi shkolla private me programe specifike.

Në tekstet e historisë tani shpaloseshin përpjekjet e bëra për demokratizimin e Perandorisë që nga koha e Tanzimatit; theksohej kontributi i Osmanëve të Rinj dhe i përfaqësuesve më të njohur të kësaj lëvizjeje, si: Fazëll Mustafa Pasha, Zija Pasha, Shinasiu, Namik Kemal-i, Ali Suavi-u, etj. Shpallja e Kushtetutës dhe mbledhja e parlamentit të parë osman në vitin 1876-1877, konsideroheshin si data të rëndësishme historike, ndërsa

17. Ali Seyyidi, *Musâhebat-ı Ablâkîye*, Istanbul: Şirket-i Mürettebiye Mat, 1332, s. 24.

18. Mustafa Gündüz, “II.Abdülhamid Dönemi Eğitimi ve Ideolojisi Üzerine Tartışmalar”, *TALID*, 6 (12), 2008, s. 266.

shfuqizimi i tyre si fatkeqësi. Një vend po aq të rëndësishëm zinin edhe përpjekjet e xhonturqve përballë regjimit despotik të Abdulhamidit II, aktiviteti i tyre politik brenda dhe jashtë vendit e sidomos Revolucioni i vitit 1908.¹⁹

Në këtë periudhë, e cila përkon me lindjen dhe zhvillimin e nacionalizmit turk kemi një shtim të temave mbi rrënjët historike të popullit turk. Koncepte të tilla nacionaliste si: “ekonomia kombëtare”, “letërsia kombëtare”, “edukata kombëtare” filluan të artikuloreshin haptazi e të zinin vend çdo ditë e më shumë në të gjitha tekstet e shkollave osmane në mbarë Perandorinë. Në funksion të kultivimit të kësaj fryme në tekste u vendosën copëza leximi letrar me anën e të cilave kultivohej ndjenja e sakrificës për atdheun, interesin kombëtar dhe dashuria për kombin.²⁰ Bindja dhe dashuria për sulltanin, tani kushtëzohej me faktin se ai duhej të ishte simpatizant i Kushtetutës dhe respektues i detyrimeve që buronin prej saj.²¹

Në kuadër të politikës së osmanizimit që xhonturqit filluan të ndiqnin, në tekstet shkollore

19. Ahmed Hilmi, *Resimli ve Haritalı Milli Küçük Osmanlı Tarihi*, Dersaadet: Kasbar Matbaası, 1330, s. 134-140.

20. Halil AYTEKİN, *İttihad ve Terakki Dönemi Eğitim Yönetimi*, Ankara: Gazi Üniversitesi Eğitim Fakültesi Yayını, 1991.

21. Nuri DOĞAN, *Ders kitapları ve sosyalleşme (1876-1918)*, İstanbul: Bağlam, 1994, s. 79.

propagandohej me të madhe se, të gjithë ata që jetonin nën flamurin e Perandorisë, konsideroheshin si pjesëtarë të kombit osman. Ky i fundit përbëhej nga turqit, arabët, shqiptarët, grekët, hebrenjtë, kurdët, bullgarët, etj. Anëtarët e këtij kombi quheshin osmanë dhe se gjuha e tyre zyrtare ishte osmanishtja. Prandaj, sipas tyre, të gjithë fëmijët ishin të detyruar ta mësonin këtë gjuhë.²² Një anë pozitive e kësaj politike ishte fakti se partia “Bashkim dhe Përparim”, e cila synonte konsolidimin e unitetit të brendshëm dhe rritjen e kohezionit social, e kundërshtonte njësoj si ndarjen e racave ashtu edhe diskriminimin fetar. Në tekste propagandohej se pas shpalljes së Kushtetutës ndarjet ishin zhdukur dhe se të gjithë nënshtetasit osmanë, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike dhe fetare, ishin të barabartë. Myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë ishin të obliguar njësoj që të sakrifikonin për atdheun e tyre. Kombi osman konsiderohej si një komb me moral të lartë, brenda të cilit kishte pasur dhe kishte personalitete që duheshin marrë shembull, jo vetëm nga myslimanët por edhe nga të krishterët. Osmanizmi nuk i përkiste vetëm myslimanëve. Çdokush që jetonte nën hijen e flamurit perandorak dhe që i bindej ligjeve të shtetit, quhej ose mund të

22. Selim KOHEN, *Malumat-ı Eftal*, İstanbul: A.Asadoryan ve Mahdumları Matbaası, 1328, s. 14.

bëhej osman.²³ Në tekste, siç shihet, propagandohej vëllazërimi i të gjithë elementeve si një vullnet politik. Për ta ilustruar këtë po citojmë një pjesëz leximi nga teksti i shkollave fillore “Detyrat qytetare” (“Vezaif-i Medeniye”), në të cilin përshkruhet një stërvitje e improvizuar ushtarake ku merrnin pjesë fëmijë me përbërje të ndryshme fetare, myslimanë dhe të krishterë, të cilëve komandanti u drejtohet me fjalët:

“Tani nuk ka më ndarje dhe përçarje. Të gjithë jemi osmanë, të gjithë jemi bijtë e këtij atdheu, të gjithë jemi për përparimin e tij. Për t’i shërbyer atdheut që të gjithë do bëhemi ushtarë. Artin ushtarak duhet ta mësojmë që tani, që në të ardhmen të mos hasim vështirësi e të bëhemi ushtarë të mirë. Ushtrisë osmane duhet t’ia zbardhim faqen edhe një kat më tepër. Hajdeni shokë, të vazhdojmë stërvitjen në emër të osmanizmit dhe atdheut.”²⁴

Si ideologji, osmanizmi vazhdoi të propagandohej deri përfundim të Luftërave Ballkanike, rezultati tragjik i të cilave bëri që vendin e tij ta zinte nacionalizmi turk (turqizmi). Humbja e këtyre luftërave u shoqërua me humbjen e territoreve evropiane të Perandorisë Osmane, duke shkaktuar një zhgënjim të

madh te xhonturqit. Sipas tyre, Evropa nuk e kishte mbajtur fjalën e dhënë se sido që të ishte përfundimi i tyre nuk do të kishte ndryshime të hartës së Perandorisë. Kjo shkaktoi një skepticizëm të përgjithshëm tek elita drejtuese osmane lidhur me perspektivën dhe unitetin që mund të sillte tani e tutje osmanizmi. Pas humbjes së pjesës më të madhe të Rumelisë, e vetmja shpresë për ta mbeti turqizmi.

Në qoftë se më parë osmanizmi e refuzonte ndarjen dhe mbivendosjen e racave, ideologjia e re tani filloi të ndërtohej mbi virtytet superiore të kombit turk. Pabesia e Evropës së krishterë dhe dimensionin panortodoks i Luftërave Ballkanike bëri që vëllazërimin midis elementeve të ndryshëm fetarë brenda Perandorisë t’i jepej fund. Në tekstet shkollor osmane tani filloi të mbizotëronte ligjërimi i luftës midis “kryqit” dhe “gjysmëhënës”. Pothuajse në të gjitha librat u vendosën shkrime dhe vjersha të Ziya Gökalp-it (Zija Gokalpit)²⁵, i cili i bënte thirrje rinisë osmane të kishte kujdes nga çdokush që s’ishte i kombësisë turke.²⁶ E vetmja gjë e përbashkët dhe që kishte njëfarë

25. Ziya Gökalp (1876-1924) sociolog, teoricien dhe themelues i nacionalizmit bashkëkohor turk. Për disa vite me radhë ai shërbeu edhe si ideolog zyrtar i partisë xhonturke “Bashkim dhe Përparim”.

26. Ahmet Cevat, *Resimli Osmanlı Lisanı*, Istanbul: Matbaa-yı Hayriye ve Şürekası, 1330, s.12.

23. Süleyman Şebahettin & Fuat Köprülü, *Meşrutiyette Terbiye-i Etfal*, Istanbul: Necm-i Istikbal Matbaası, 1327, s. 98.

24. Ali Seyyidi, *Vezaif-i Medeniye*, Istanbul: Kaanat Matbaası, 1329, s. 34-35.

ngjashmërie me osmanizmin e propaganduar më parë tani ishte fakti se nacionalizmi turk mbarte një lloj identiteti islam.

Krahasuar me tekstet shkollore të periudhës së Abdulhamidit II, në të cilat superioriteti i qytetërimit evropian në fushën e shkencës dhe teknologjisë pranohej hapur, por që nga ana tjetër bëhej thirrje për një lloj selektiviteti, që nga ky i fundit, zakonet të mos kopjoheshin, traditat dhe veshjet, në tekstet shkollore të pas Revolucionit Xhonturk shoqërisë osmane i sugjerohej që Perëndimi të merrej si model pa rezerva edhe në këto aspekte.²⁷

Si përshkruhej Shqipëria dhe shqiptarët në tekstet shkollore të Perandorisë Osmane?

Në tekstet shkollore osmane nuk mund të thuhet se flitej hapur mbi racat dhe kombet, por kishte raste kur në kuadër të trajtimit të aspekteve të veçanta me karakter gjeografik, përshkruheshin edhe detaje me interes për kombin tonë. Kështu, në tekstin “Gjeografia osmane” (“Coğrafya-yı Osmanî”) në të cilin trajtoheshin karakteristikat e disa krahinave dhe popujve të Perandorisë, si shembull i mikpritjes dhe bujarisë merrej populli shqiptar. Mungesën e bujtinave (haneve) në qytetet shqiptare, autori e shpjegonte me faktin se te ky popull kjo traditë

27. Nuri Doğan, *Ders kitapları ve...*, s.101.

zinte një vend të rëndësishëm. Sipas tij, çdokush që udhëtonte nëpër Shqipëri dhe ngelte në mes të rrugës, qoftë ky mysliman ose i krishterë, nëse trokiste në derën e shqiptarit bëhej mysafir në shtëpinë e tij. Bujtësi ishte i detyruar që mikut t'i siguronte ushqim për aq ditë sa ai do të qëndronte.²⁸

Në tekstin e parë shkollor të historisë osmane “Fezleke-i Tarîh-i Osmanî” (“Përmbledhje e Historisë Osmane”) që u shkrua nga Ahmet Vefik Pasha* në vitin 1869, në kapitullin e nëntë ku autori trajton periudhën e Sulltan Mehmed Fatihut II përshkruan shkurtimisht edhe ekspansionin e ushtrisë osmane në territoret shqiptare,²⁹ qëndresën njëzetepesëvjeçare të Skënderbeut

28. Ahmet Celal, *Coğrafya-yı Osmanî*, İstanbul, 1311, s. 86-87.

* Ahmet Vefik Pasha (1813-1891) shkrimtar dhe burrë shteti osman. Në karrierën e tij të gjatë politike ai ka mbajtur disa poste të rëndësishme, si: kryeministër, kryetar parlamenti, ministër arsimit, ministër drejtësie, etj. Ai njihet gjithashtu edhe si përkthyes dhe autor tekstesh. Për 36 vjet me radhë, nga 1869-1905 libri i historisë “Përmbledhje e Historisë Osmane” që ai hartoi për shkollat ryshtije shërbeu si tekst bazë duke u bërë model edhe për tekste të tjera që do të shkruhen më vonë. Nga të dhënat që na ofrojnë studiuesit e jetës dhe veprës së Ahmet Vefik Pashës thuhet se ky libër historie ka thyer të gjitha rekordet e kohës së tij duke u ribotuar mbi 15 herë.

29. Ahmet Vefik Paşa, *Fezleke-i Tarîh-i Osmanî*, (Yayına Hazırlayan: Şakir Babacan), İstanbul: Boğaziçi Yayınları, 2011, s. 101.

në malet e Shqipërisë³⁰ dhe rrethimin e Shkodrës.³¹ Një rëndësi më vete në këtë tekst ka edhe fakti se në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë ku autori trajton ndarjen e vjetër të Perandorisë Osmane në ejalet, Shqipëria (“Arnautluk-u”) trajtohet si njësi administrative më vete, në përbërje të së cilës bënin pjesë sanxhaqet e Prizrenit, Shkodrës, Dukagjinit, Ohrit, Elbasanit, Vlorës, Delvinës dhe Janinës.³² Me përjashtim të Shkupit dhe Manastirit që bënin pjesë në një njësi tjetër administrative, këto sanxhaqe që autori i ka përfshirë nën emrin “Arnavutluk” (“Shqipëria”) përputhen pak a shumë me arealin etno-linguistik shqiptar. Studimi i trajtimit të historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve në tekstet shkollore osmane e sidomos, prania e këtyre dy koncepteve, gjeografik-Shqipëri (“Arnavutluk”) dhe etnik-shqiptar (“Arnavutlar”), në hartat e atlaset

30. *Po aty*, s. 102.

31. *Po aty*, s. 104-105.

32. *Po aty*, s. 150.

historiko-gjeografik, ndonëse deri tani e pahulumtuar siç duhet, na bën të konkludojmë se:

a) tek elita drejtuese (politike) dhe intelektuale e Perandorisë Osmane, Shqipëria si koncept gjeo-etno-linguistik ka qenë perceptuar qartë dhe saktë;

b) trajtimi i historisë së Shqipërisë si koncept gjeo-etno-linguistik dhe e shqiptarëve (si p.sh. Skënderbeu dhe qëndresa e tij, Ali Pashë Tepelena, veprimtaria e të cilit trajtohet shkurtimisht si nxitës i popullsisë së Moresë në kryengritje për të përmbushur qëllimet personale³³) edhe pse si pjesë integrale të historisë së Perandorisë Osmane nuk mund të mos ketë ndikuar si te nxënësit osmanë ashtu edhe te nxënësit shqiptarë që studionin në shkollat osmane për të krijuar një përfytyrim gjeo-etno-linguistik objektiv, që më vonë, me lindjen e frymës kombëtare, do të shndërrohet në vetëdije nacionale.

33 *Po aty*, s. 282: 287.

Roli i prijësve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar

Dr. Mois Kamberi
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Abstrakt

Ngjarjet, lëvizjet politike e zhvillimet diplomatike që çuan në shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit dhe qeverisë së parë shqiptare nuk mund të kuptohen pa kontributin e klerikëve, që ishin shtresa më intelektuale shqiptare. Në ngjarje shumë të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja e Pejës, Kongreset e Manastirit, Dibrës, Elbasanit dhe në kryengritjet e mëdha shqiptare të viteve 1910-1912, këta prijës qenë dhe udhëheqësit e tyre. Ky kontribut patriotik, me mendimet dhe idealet kombëtare, rriti rolin e tyre në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe zgjedhjen e tyre si përfaqësues në kongrese e kuvende me shumë peshë për fatet e Shqipërisë. Për këto merita ata janë zgjedhur dhe në organet drejtuese të tyre. Haxhi Ymer Prizreni – Kryetar i Qeverisë së Përkohshme të Lidhjes Shqiptare, Haxhi Zeka – kryetar i Lidhjes së Pejës, Haxhi Vehbi Dibra – Kryetar i Kongresit të Dibrës etj. Këta emra do të jenë të pranishëm me kontributin e tyre në sukseset që arritën kryengritjet e mëdha të shqiptarëve kundër politikave të monarkive ballkanike e Fuqive të Mëdha, kryengritje që çuan në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe formimit të Qeverisë së parë shqiptare të drejtuar nga Ismail Qemali. Kontributi patriotik i klerikëve u pa qartë dhe në zgjedhjen e tyre si drejtues në postet më të larta të qeverisë së parë shqiptare si: Haxhi Vehbi Dibra (Agolli), kryetar i Pleqësisë Shqiptare dhe Dom Nikoll Kaçorri, nënkryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ata janë të parët që hodhën idenë e formimit të një qeverie mbarë shqiptare.

Shekulli XIX shënoi një epokë të re për popullin shqiptar, atë të Rilindjes. Ai hyri në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe revolucioneve kombëtare, që çuan në çlirimin nga pushtimi osman dhe formimin e shteteve të pavarura. Për një varg rrethanash të brendshme e të jashtme, Shqipëria ishte vendi i fundit në Ballkan që u shkëput nga Perandoria Osmane dhe që shpalli pavarësinë kombëtare. Gjatë Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua ideologjia e re kombëtare, e cila, duke u ngritur mbi ndarjet krahinore e fetare, shprehte aspiratat jo më të krahinave të veçanta, por të gjithë Shqipërisë dhe shqiptarëve si komb.¹

Në kundërshtim me politikat e sulltanëve osmanë, që vinin shenjën e barazimit midis fesë dhe kombësisë dhe e trajtonin popullin shqiptar, me tri besime, të ndarë në tri kombësi të ndryshme, ku jeta shpirtërore e besimtarëve shqiptarë sundohej nga tri institucione fetare, tri shkolla dhe tri kultura të huaja, klerikët shqiptarë ngritën idenë e një shteti kombëtar shqiptar.²

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi dhe krijimi i shtetit shqiptar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të

bashkëpunimit të sinqertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, të cilët pavarësisht nga përkatësia e ndryshme fetare, dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar. Të dhënat e përfutuara nga burime të ndryshme historike vërtetojnë qartësisht ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme.

Periodha e Rilindjes Kombëtare, ajo e pavarësisë dhe e luftërave të ndryshme në mbrojtje të trojeve shqiptare, dëshmuar se ekzistenca e besimit fetar, jo vetëm që nuk u bë pengesë për përballimin e situatave të vështira të atyre kohërave, por u bë faktor i domosdoshëm për ruajtjen e pavarësisë dhe forcimin e shtetit, duke u vlerësuar se diversiteti fetar ka qenë dhe është një pasuri kombëtare, falë kjo e prijësve të shquar fetarë. Shumë kuvende e kryengritje lokale, krahinore, ndërkrasinore dhe mbarë kombëtare, u udhëhoqën dhe u drejtuan nga klerikë të shquar shqiptarë. Një realitet ky i cili herë pas here vlerësohet edhe nga opinioni ndërkombëtar.

Kur udhëton nëpër analet e historisë shqiptare dhe flet për lëvizjet dhe përpjekjet mbarëkombëtare, kupton se një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë, të cilët në shumë raste ishin drejtues fetarë, që nga imamë e myderrizë, myfti, kryemyfti,

1. ASHSH, "Histori e Popullit Shqiptar", Vëll. II, Toena, Tiranë, 2002, f. 27.

2. ASHSH, "Histori e Popullit Shqiptar", Vëll. II, Toena, Tiranë, 2002, f. 27.

kadi dhe kryetarë komuniteti e deri në klerikë katolikë e ortodoksë, ku në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe shpesh herë mjaft të vështira, punuan për krijimin dhe ngritjen e shtetit shqiptar, si dhe kontribuuan për forcimin dhe konsolidimin e këtij shteti, duke dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme në formësimin e vetëdijes kombëtare dhe fetare të popullit tonë.

Duke i bërë një vështrim retrospektiv veprimtarisë së klerikëve shqiptarë, si organizatorë të rezistencës antiosmane, kuvendeve e kongreseve të mbajtura në gjithë krahinat shqiptare, aktiviteti i tyre patriotik rriti popullaritetin e tyre në krahinat shqiptare.³

“Na shqiptarët, prej çdo feje qofshim, jemi të tanë vllazën gjaku dhe vllazën (vatani) atdheu. Do të shkojmë mbarë e mirë shoq me shoq si jemi tue shkue, do të punojmë së bashku për lulëzimin e atdheut tonë dhe do ta mbrojmë atë me gjakun tonë.”

Është e qartë që kleri mysliman ka dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar, ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes, në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do vëmë

3. M.H.D, Fondi kujtime. Kujtime të mbledhura nga Ivzi Shehu.

re se prania e klerikëve myslimanë është kudo e pashmangshme. Që nga kryengritjet kundër Tanzimatit me sheh Mustafën e sheh Fezën, e deri te përfaqësimi në organizma, si Komiteti i Stambollit, me Hoxhë Hasan Tahsinin e madh, erudit që me botimet shkencore, letrare apo publicistike u përpoq të vinte në dukje trashëgiminë kulturore të popullit shqiptar dhe domosdoshmërinë e njohjes prej shtetit osman të së drejtës legjitime për t’u arsimuar në gjuhën e vet amtare, duke vazhduar me Daut Efendi Boriçin, në Lidhjen e Prizrenit, me Hafiz Ibrahim Shkupin, në Kongresin e Manastirit, me Myfti Vehbi Dibrën, me Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Efendi Ndroqin në Kongresin e Dibrës, me Myfti Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit, etj.

Pra, në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, pa dyshim, gjen edhe ata, klerikët e nderuar të besimit mysliman, krah për krah e dorë për dorë me të gjithë klerikët e besimeve të tjera në Shqipëri. Edhe ata kanë pjesën e vet të historisë, janë edhe ata pjesë e lavdisë shqiptare, kanë hyrë edhe ata në vargjet e lahutës. Kujtojmë këtu vargjet e Fishtës të “Lahuta e Malsisë”:

“Shtrinë të ngratin hafiz Myslimin, dhe në dru e rrahën trimin

Sado që ishte një “hafiz” “Jam shqiptar me gjuhë e fis”

Jam Shqiptar përgjigjet Hafizi deri qe ashti i kambës i krisi”.⁴

Ngjarje të rëndësishme mbarëkombëtare janë të lidhura me zhvillimin e tyre pranë institucioneve fetare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si p.sh.: Lidhja Shqiptare e Prizrenit u ndez në Medresenë e Xhamisë Bajrakli. Kryetari i saj pas Iljaz pashë Dibrës, u zgjodh kleriku Haxhi Ymer Prizreni, që ishte dhe kryeministri i parë shqiptar në Qeverinë e përkohshme të Lidhjes. Kleri mysliman, me përkushtimin e tij mahnitës, i shërbeu shqipes me përkthimet e ndryshme. Ishin klerikët ata që kontribuuan së bashku me personalitete të shquara të vendit, për hapjen e mësonjëtove të para në gjuhën shqipe dhe për t’u mësuar fëmijëve shkrimin e këndimin e shqipes, si Hoxha Tahsini, Said Najdeni, Vehbi Dibra (Agolli), Hafiz Ali Korça etj.

Gjatë viteve 1900-1912, klerikët i gjejmë të pranishëm në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës politike, social-arsimore të vendit tonë, në kuvende dhe kongrese mbarë kombëtare si, Kuvendi i Pejës i drejtuar nga kleriku Haxhi Zeka, kongreset arsimore të Manastirit e Elbasanit, në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909 të drejtuar nga Vehbi Dibra, në kuvendin e madh të Vlorës etj. Me mendimin dhe qëndrimin e mbajtur, klerikët shqiptarë luajtën rol të rëndësishëm

4. Fishta, Gj., “Lahuta e Malësisë”.

në orientimin kombëtar të tërë jetës së vendit tonë. Në gjirin e kësaj lëvizje të gjerë politike, arsimore dhe ushtarake, ata bashkëvepruan dhe me figura të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare, si Ismail Qemali, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Luigj Gurakuqi etj.

Në kuvendin e Pejës dhe të Dibrës të vitit 1899, Haxhi Zeka, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Myfti Saliu, Myderriz Ismaili, Myderriz Abdullahu etj., luajtën një rol të rëndësishëm, duke dhënë një shembull se si duhej të zgjidhej çështja kombëtare. Klerikët, jo vetëm ishin përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare në këto kuvende, por dhe figura me shumë reputacion ndër delegatët e tjerë pjesëmarrës të këtij kuvendi. Fjala e tyre zinte vend sa herë që shprehej. Ndikim të madh pati H. Vehbiu dhe në vendimet që mori kuvendi i Dibrës i shkurtit 1899.

Përhapja e shkollave dhe e mësimit të gjuhës shqipe, si dhe zhvillimi i kulturës kombëtare, shtruan nevojën e caktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Për këtë u organizua Kongresi i Manastirit, 14 nëntor 1908. Delegatët e kongresit ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë si: Vehbi Dibra, Haziz Ibrahim efendiu etj., të cilët shtruan domosdoshmërinë e caktimit të një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe.⁵

5. ASHSH, “Histori e Popullit Shqiptar,

Në këtë kongres klerikët mbështetën idenë për përdorimin e një alfabeti të ri të gjuhës shqipe me germa latine dhe për mësimin e shqipes në shkollat e Shqipërisë.⁶

Në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, Vehbi efendi Dibra, Hafiz Ali Korça, Haxhi Hafiz Ibrahim efendiu, Hafiz Sherif Lëngu, etj., do të krijonin klube shqiptare e do të viheshin në krye të luftës kundër xhonturqve, që përpiqeshin të pengonin zhvillimin e kombit shqiptar, bashkimin e tij. Në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, Vehbi Dibra për aktivitetin e tij fetar dhe politik do të zgjidhej kryetar i Kongresit. Ky kongres i kalonte caqet kombëtare, që tregohet nga pjesëmarrja e delegatëve laikë e klerikë, jo vetëm nga vilajetet e Selanikut, Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës, por dhe e përfaqësuesve serbë, grekë, bullgarë e vllahë. Ky ishte i pari kongres ku më tepër se 300 delegatë toskë, gegë, myslimanë, ortodoksë, katolikë, priftërinj, hoxhallarë e shehlerë u bashkuan në një pikë, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia dhe arritjen e pavarësisë kombëtare.

Atdhetarët Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Kenan Manastirli, Vehbi Agolli, Haxhi Ali Elbasani, etj., e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës e shpalesjes së mendimit e

Vëll. II, Toena, Tiranë, 2002, f. 392.

6. Prof. Dr. Qazim Xhelili, Monografi, “Vehbi Dibra”, Tiranë: Albin, 1998, f. 27.

kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, kërkesa që ishin nga më të avancuarat të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si rezultat i kësaj lufte kongresi punimet e tij i nisi dhe i përfundoi si një kongres shqiptar, si një kongres që trajtoi edhe shumë probleme të rëndësishme kombëtare që dilnin dhe jashtë kompetencave të rendit të ditës së tij. Në të u ngritën probleme me kërkesa të mirëfillta shqiptare ku u shfaqën hapur:

- kërkesat me karakter të theksuar politik kombëtar, që çonin drejt realizimit të autonomisë së Shqipërisë,

- kërkesat për hapjen e shkollave shqipe të mbrojtura nga shteti,

- futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore,

- çështjen e alfabetit, etj.⁷

Punimet e Kongresit, lufta e ashpër politike që u zhvillua aty, provuan plotësisht se kërkesat e delegatëve patriotë ishin një përpjekje e hapur për realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit e administratës vendase të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend, përdorimi dy gjuhësh në dokumentet përfundimtare të tij, janë arritjet më të mëdha të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, suksese që

7. Gazmend Shpuza, “Kongresi kombëtar i Dibrës 1909”, Dibër, 2005, f. 32.

nuk ishin arritur në Kongreset e tjera kombëtare.⁸

Në Kongresin e Elbasanit të 2 shtatorit 1909, klerikët myslimanë Hafiz Ibrahim Dalliu, Josi Haxhi Mima, Emin Haxhi Ademi dhe Hoxhë Muglica bënë gjithçka për të hapur Normalen e Elbasanit, përkrah Luigj Gurakuqit, Hamdi Ohrit, Dervish bej Biçakut, Mithat Frashërit dhe të tjerëve, ata bënë gjithçka për të ndriçuar dhe ushqyer shpirtin kombëtar.

Elita fetare e vendit ka meritat më të para nga të gjitha elitat e tjera. Në rast se vështrojmë kombet dhe historitë e tjera do të gjejmë kombe të cilat kanë tradita mijëra vjeçare shkrimi, alfabetesh, biblioteka librash dhe qytetërimi, por kombi ynë ka një specifikë që s'e ka asnjë komb tjetër dhe është diamant i qytetërimit të kombeve dhe kjo është toleranca fetare. S'ka dhe s'mund të ketë asnjë tregues më epror për qytetarinë e një kombi sesa toleranca fetare.

Shqipëria përgjatë historisë së saj ka qenë një shembull se si njerëzit e fesë kanë ditur të zgjidhin saktë marrëdhëniet e besimit me kombin. Një mori dijetarësh shqiptarë të profilit fetar mysliman, katolik apo ortodoks kanë dhënë kontribut të çmuar në të gjitha fazat zhvillimore dhe format organizative të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Është pikërisht kontributi i klerikëve

8. Kenan Manastirli, "Kongresi I Dibrës", Stamboll, 1912, f. 7.

fetarë, që ne nuk njohim përgjatë historisë sonë, konflikte të bazuara në besimet fetare. Pa asnjë dallim, klerikët myslimanë, duke ruajtur tolerancën fetare, janë përpjekur në të gjitha mënyrat vetëm për një shoqëri me parime patriotike, për një shoqëri bashkëkohore, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, dashurisë për gjuhën dhe traditat shqiptare, dashurisë për atdheun e dashurisë për njëri-tjetrin, janë përpjekur për krenarinë tonë kombëtare. Më në veçanti kjo vepër bën ekzaminimin e përpjekjeve madhore të klerit dhe dijetarëve myslimanë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në pavarësinë e Shqipërisë, jo vetëm për çlirim kombëtar, jo vetëm për arsimin e shkollat shqip, por edhe për krijimin e shtetit shqiptar. Me firmën jo vetëm të patriotëve shqiptarë, por dhe të klerikëve myslimanë si: Hafiz Ismet Dibrës, Vehbi Dibrës, Hafiz Sherif Lëngut, etj., Shqipëria do të shpallej e pavarur.⁹

Pavarësia e Shqipërisë ishte aspiratë dhe punë atdhetare e një kombi të tërë, nga gjiri i të cilit lindën shumë heronj. Midis tyre historiografia jonë duhet të nënvizojë fort emrat e klerikëve myslimanë, njerëz me shumë reputacion në mbarë Shqipërinë, të aftë, largpamës, me nuhatje e drejtpeshim politik.¹⁰

9. Mois Kamberi, "Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare", Maluka, Tiranë, 2012, f. 176.

10. M.H.D. Fondi Dosje Patriotësh, *Vehbi*

Kulmin e ngritjes së tyre jo vetëm si klerikë, por dhe si luftëtarë të çështjes kombëtare, ata do ta arrijnë me pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës dhe zgjedhjen e tyre në organet më të larta të Qeverisë së Përkohshme.

Në situatën e krijuar, kur forcat Ballkanike po pushtonin Shqipërinë dhe trevat shqiptare rrezikoheshin nga një copëtim i ri, rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, arritën në përfundimin se e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte shpallja e Pavarësisë. Për këtë qëllim do të organizonin një kuvend mbarë kombëtar ku do të merrnin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat shqiptare.

Telegrame të shumta të dërguara nga Vloza për prefekturën e Elbasanit tregonin interesin e veçantë që kishin organizatorët e kuvendit për arritjen në Kuvendin e Madh të përfaqësuesve të klerikëve myslimanë si, Vehbi Agollit (Dibrës) dhe Hafiz Sherif Lëngut,¹¹ personalitete me kontribut fetar e politik të gjithanshëm për çështjen kombëtare, mandate që ua ngarkonte mbarë popullsia e Dibrës dhe e krahinave përreth për të dërguar fjalën e tyre në Kuvendin Kombëtar në Vlorë. Vehbi Agolli u ngarkua të kryesonte delegacionin e Dibrës, përgjegjësi të cilën atij ia ngarkonte

Dibra, dosja nr. 598.

11. A.Q.SH.-Fondi 71, D. 1, Përkthim nga turqishtja.

popullsia e Dibrës.¹²

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë, mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali arriti në Durrës. Plaku Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë të shoqëruar nga Nikoll Kaçorri u nisën për në Vlorë.

Më 21 nëntor 1912 Isa Boletini, Ajdin bej Draga, Mehmet pashë Dërralla dhe delegatët e zgjedhur të Dibrës, Vehbi Agolli dhe Hafiz Sherif Lëngu, u nisën nga Dibra për në Elbasan¹³ ku i prisnin delegatët e kësaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës.¹⁴

Ndërsa delegatë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare grupoheshin dhe së bashku niseshin për në Vlorë, disa qyteteve shqiptare, që rrezikoheshin nga pushtimi i shteteve fqinje, iu kërkua nga rrethet patriotike, që të ngrihej flamuri kombëtar me qëllim që pushtuesi i ri t'i gjente të pavarura. Midis 37 delegatëve¹⁵ dalloheshin klerikët Vehbi Agolli, Hafiz Sherif Lëngu dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Përballë kërcënimit të ri të pushtimit nga ushtritë ballkanike dhe situatës së re të krijuar për trevat shqiptare, plaku Ismail Qemali dhe atdhetarë të tjerë të mbledhur në

12. Zani i Naltë, viti 1937.

13. A.Q.SH.-Fondi – 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

14. A.Q.SH.-Fondi 32, D. 26, f. 133.

15. Valentina Duka-“Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë: Shblu, 2007, f. 19.

Vlorë, hapën më 28 nëntor 1912, ora 14.^{oo}, punimet e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pa pritur ende të gjithë delegatët e krahinave shqiptare për shkak të vështirësive të mëdha që ekzistonin. Mendimi i klerikëve për Pavarësinë e Shqipërisë, u mbështet nga të gjithë delegatët me në krye plakun Ismail Qemali, të cilët e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur: “Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme”.¹⁶

Pas shpalljes së pavarësisë, përpara kuvendit kombëtar shtroheshin detyra të reja historike: të ngrihej shteti i pavarur shqiptar me administratën dhe forcat e tij të armatosura, të sigurohej njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e kufijve politikë shtetërorë, që të përfshiheshin të gjitha trojet etnike shqiptare, të shtrihej pushteti shtetëror në këto troje dhe të organizohej mëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Ismail Qemali i paraqiti Kuvendit dhe ia besoi atij zgjedhjen e anëtarëve të qeverisë. Rrjedhimisht anëtarët e saj duhet të ishin të njohur brenda dhe jashtë vendit. Më 4 dhjetor 1912 u zgjodh Qeveria e Përkohshme¹⁷. Spikasin në përbërjen e këtij kabineti qeveritar krahas figurave të tjera

atdhetare Myfit bej Libohova, Abdi bej Toptani, Mehmet pashë Dërralla, Petro Poga, Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Pandeli Cale, Lef Nosi dhe figurat e dy klerikëve Dom Nikoll Kaçori dhe Vehbi Agolli (Dibra).

Me propozim të Ismail Qemalit, në Kuvend u zgjodhën edhe organet më të larta të përfaqësimit të qeverisë Shqiptare. Në mbledhjen e dytë që u hap më 30 nëntor 1912, me propozim të Luigj Gurakuqit, Vehbi Agolli u propozua të zgjidhej kryetari i Pleqësisë shqiptare (senatit). Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi jo vetëm Qeverinë e Përkohshme, por dhe Pleqësinë prej 18 anëtarësh. Kryetar i pleqësisë u zgjodh Vehbi Dibra.¹⁸ Në Kuvendin e Vlorës, Vehbi Agolli bëri dhe betimin e flamurit dhe dha Fet’fanë për shpalljen e pavarësisë. Kjo që zgjedhja e dytë e një atdhetari klerikal në postet më të larta të qeverisjes pas zgjedhjes së Dom Nikoll Kaçorrit si nënkryetar të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ndërkohë që Ismail Qemali merrej me zgjidhjet diplomatike të shtetit shqiptar jashtë atdheut, aktivitetin brenda tij e ushtronte Vehbi Dibra, mjaft i suksesshëm në shtrirjen e autoritetit të shtetit të parë shqiptar në të gjitha trevat shqiptare.

16. Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena, 2002, f. 511.

17. Bajram Xhafa, “Historia e Shqipërisë, periudha e pavarësisë”, Shkodër, 2006, f. 16.

18. Valentina Duka-“Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë: Shblu, 2007, f. 24.

Bibliografia

- A.Q.SH.-Fondi 32, D. 26.
A.Q.SH.-Fondi 71, dok. 723/1, viti 1912.
A.Q.SH.-Fondi 71, D. 1, dok 10307, përkthim nga turqishtja.
A.Q.SH.-Fondi – 245, D. 2, f. 6, viti 1912.
Gazmend Shpuza, “Kongresi kombëtar i Dibrës 1909”, Dibër, 2005.
Gjergj Fishta, “Lahuta e Malësisë”.
Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena, 2002.
Mois Kamberi, “Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, Maluka, Tiranë 2012.
Kenan Manastirli, “ Kongresi i Dibrës “, Stamboll 1912.
M.H.D. Fondi Dosje Patriotësh, *Vehbi Dibra*, dosja, nr. 598.
M.H.D, Fondi kujtime, Kujtime të mbledhura nga Ivzi Shehu
Prof. Dr. Qazim Xhelili, Monografi, “ Vehbi Dibra “, Tiranë: Albin, 1998.
Valentina Duka-“Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë: Shblu, 2007.
Bajram Xhafa, “Historia e Shqipërisë, periudha e pavarësisë”, Shkodër, 2006.
Zani i Naltë, viti 1937.

Kur'ani, shpirti i umetit mysliman

Prof. Dr. Shahid Bushihi
Marok

Abstrakt

Shpirti i Kur'anit shkakton një transformim, i cili, ashtu siç ndodh tek individët, ndodh edhe me komunitetet. Edhe kur flitet për një komunitet, Kur'ani shkakton të njëjtin ndryshim dhe transformim që ka shpirti për trupin. Ai i bashkon pjesët e ndara të shoqërisë dhe ofron një model unik dhe bashkëpunues të saj. Trupi i të vdekurit, i braktisur nga shpirti i tij tashmë, fillon dhe dekompozohet dhe shkrihet për t'iu kthyer elementëve të parë nga të cilët u krijua, ku secili element i kthehet origjinës së tij në tokë. Vallë çfarë i ndodhi këtij trupi në rastin e vdekjes? Vdes dikush dhe ne e shohim që nuk ka ndryshuar asgjë tek ai, është po ai që ishte para se të vdesë. Nga ana tjetër, tek ai ka ndryshuar gjithçka. Çfarë u largua prej tij që nga aspekti aparençial nuk ka ndryshuar gjë, por që ka ndryshuar gjithçka? Është larguar ai që ne e njohim me emrin shpirt. Ishte shpirti ai që e kishte unifikuar qenien dhe strukturën e saj fizike. Ishte shpirti që frenonte dekompozimin e trupit dhe shpërbërjen e tij, por edhe ndihmonte shërimin e tij në raste sëmundjesh. Ishte shpirti ai që i kishte dhënë ndjesitë dhe aftësitë.

Zoti në Kur'an thotë: “Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty shpirt me urdhrin dhe vullnetin Tonë. Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi. Por atë (Kur'anin), Ne e bëmë dritë, me anë të së cilës udhëzojmë kë të duam nga robërit Tanë. Ti, me të vërtetë,

udhëzon në rrugën e drejtë...”¹

Kur'ani është shpirt

Në ajetin e mësipërm, me fjalën “shpirt” nënkuptohet Libri i Zotit të Lartësuar. Është zgjedhur fjala shpirt për të shprehur sekretin e shpalljes hyjnore, e cila shkakton të njëjtin

1. Shura 41/52.

efekt që shkakton dhënia e shpirtit te njeriu, duke e transformuar në një krijesë tjetër. Njeriu konceptohet në barkun e nënës së tij për dyzet ditë si një pikë uji. Mandej ai shndërrohet në një copë gjaku të ngjizur, mandej shndërrohet në diçka të ngjashme me një copë mishi të kafshuar dhe të shtypur me dhëmbë. Pas kësaj faze i jepet shpirti duke e transformuar në një krijesë të ndryshme nga zanafilla e saj.

Njeriu - individi dhe shoqëria në tërësi - falë Kur'anit pëson një transformim tjetër. Natyra e këtij Libri i përngjan asaj të shpirtit, prandaj dhe përdoret termi “shpirt” në vend të Kur'anit. Lidhur me shpirtin, Zoti në Kur'an thotë: **“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni””**.²

Kurse në ajetin me të cilin e filluam këtë artikull, Zoti thotë: **“Dhe kështu, Ne të kemi dërguar ty shpirt me urdhrin dhe vullnetin Tonë.”**³

Në arabisht, po ta shohësh janë pothuajse të njëjtat fjalë në të dy pasazhet.

Ndikimi i shpirtit të Kur'anit te njeriu si individ

Ky Libër citohet në kuadër të shpirtit, duke lënë të nënkuptohet se ka të njëjtin funksion të shpirtit

2. Isra 17/85.

3. Shura 42/52.

për jetën e njeriut. Njeriu, para se në damarët e tij të qarkullojë drita e Kur'anit, është i vdekur, siç thuhet në Kur'an: **“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj!”**⁴

Kur Kur'ani depërton në zemrën e njeriut dhe depërton në çdo qoshe të qenies së tij, njëlloj si gjaku, realisht, ky njeri transformohet në diçka tjetër për sa i përket energjive, ideve, kapaciteteve dhe arritjeve. Kjo, sepse falë Kur'anit ai orientohet kah Zoti, njeh Krijuesin dhe Kujdestarin e tij, i mbështetet Atij siç duhet dhe që andej i burojnë të gjitha energjitë. Nga cilësitë e Zotit është dhe “i Plotfuqishmi” prej të cilit njeriu i burojnë të gjitha fuqitë. Nga cilësitë e Zotit është “i Gjithëdituri” dhe prej Tij njeriu merr dijet. Nga cilësia e Zotit “i Gjithëurti”, njeriu merr urtësinë. Nga cilësia e Tij “i Gjithëmëshirshmi”, njeriu furnizohet me mëshirë. Kështu, njeriu pajiset me nur dhe energji të pazakonta krahasuar me nurin dhe energjitë e mëparshme.

Le të sjellim disa modele për këtë:

Modeli i parë është modeli më perfekt, ai i profetit Muhamed (a.s.), si ishte para Kur'anit dhe si u bë më pas. Përgjatë dyzet viteve të para të jetës, para se t'i shpallehin fjalët: **“Lexo, me emrin e Zotit**

4. En'am 6/122.

tënd!”⁵, çfarë mundi të ndryshojë në Gadishullin Arabik? Çfarë ndryshimi sollë në zemra, tek individët, grupet, fiset dhe në histori?

Por, menjëherë pas shpalljes së Kur’anit, menjëherë pas ardhjes së këtij shpirti, ai tashmë ishte dikush tjetër. Deri atëherë ai kishte qenë thjesht “njeri”, ndërkohë që tashmë i ishte shtuar dhe: “të shpallim ty”⁶ (në arabisht të shpallim shprehet me foljen “nuhi”, që në origjinë do të thotë, të japim shpirtin⁷). E kur Profetit (a.s.) iu shpall ky Kur’an, ai u shndërrua në një dritë dritëdhënëse. **“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.”**⁸

Profeti Muhamed (a.s.), me shpalljen e Kur’anit mori nga nuri i tij. **“Juve ju erdhi prej Allahut dritë (Profeti) dhe Libër i qartë (Kur’ani)”**⁹ dhe vetë u shndërrua në një pishtar ndriçues. Çdo mysliman tek i cili depërton Kur’ani gjer në zemër, shndërrohet në një nur ndriçues për veten dhe të tjerët. Po, por çdo dritë dhe nur ndriçon sipas gatishmërisë dhe fuqisë që i jep ti vetë, sipas llojit dhe materialit.

Kështu, profeti Muhamed (a.s.), falë këtij shpirti të ri që iu dha nëpërmjet Kur’anit, u shndërrua në një person tjetër dhe sollë ndryshime historike, të cilat do të vazhdojnë deri në fundin e kësaj bote. Ai e transformoi Gadishullin Arabik ashtu siç duhej, e bashkoi njerëzimin e përçarë dhe i dha një format të ri me një nivel të lartë humanizmi. Falë tij, arabët dhe mbarë myslimanët shënuan arritjet më të larta në fushën e civilizimit nga lindja në perëndim.

Kur Kur’ani depërton në qenien e një myslimani, sigurisht që e shndërron në një nur që rrezaton. Po, një nur, por në vartësi të gatishmërisë së personit dhe brumit me të cilin ai është brumosur.

Modeli i dytë është modeli i Omer ibnul Hatabit. E dini çfarë ka qenë Omeri para se t’i jepet shpirti i Kur’anit? Ka qenë bari delesh, njeri si gjithë të tjerët. Por, me t’iu dhënë shpirti i Kur’anit, me të depërtuar në qenien e tij nuri i këtij Libri dhe me të mbërritur drita e tij në zemrën, mendjen dhe gjithë qenien, u shndërrua në një energji të pashtershme, duke u marrë si shembull dhe model në përballjen me sfidat dhe vështirësitë.

Modeli i tretë është modeli i Abdullah ibnu Mes’udit (Zoti qoftë i kënaqur me të). Nga një bari shtatlig, ai u transformua në një model botëror falë shpirtit të Kur’anit, një model i cili sfidoi mbarë elitën mekase, duke u lexuar haptazi vargjet e shpallura

5. Alak 96/1.

6. Enbija 21/25.

7. Shënim i përkthyesit.

8. Ahzab 33/45-46.

9. Maide 5/15.

nga Zoti, në një kohë kur askush nuk e shpallte dot besimin e tij.

Modeli i katërt është Bilal ibnu Rebah (Zoti qoftë i kënaqur me të), jetëshkrimi i të cilit tashmë është i njohur për të gjithë.

Gjithë këto ndryshime të këtyre kolosëve ishin rrjedhojë e konceptit të ri që përqaftuan, konceptit dhe kuptimit të ri të jetës që u dha Kur'ani, i cili luan rolin e shpirtit, i cili e transformon qenien materiale në një energji pozitive, ashtu siç transformoi baltën e Ademit (a.s.), në një qenie që meritoi përuljen e mbarë melekëve.

Ndikimi i shpirtit të Kur'anit te njeriu si komunitet

Ky transformim, ashtu siç ndodh tek individët, ndodh edhe me komunitetet. Edhe kur flitet për një komunitet, Kur'ani shkakton të njëjtin ndryshim dhe transformim që ka shpirti për trupin. Ai i bashkon pjesët e ndara të shoqërisë dhe të ofron një model unik dhe bashkëpunues të saj. Trupi i të vdekurit, i braktisur nga shpirti i tij tashmë, fillon e dekompozohet dhe shkrihet për t'iu kthyer elementeve të parë nga të cilët u krijua, ku secili element i kthehet origjinës së tij në tokë. Vallë, çfarë i ndodhi këtij trupi në rastin e vdekjes? Vdes dikush dhe ne shohim që tek ai nuk ka ndryshuar asgjë, është po ai që ishte para se të vdiste. Nga ana tjetër, tek ai ka ndryshuar gjithçka. Çfarë u largua

prej tij që nga aspekti aparenial nuk ka ndryshuar gjë, por që ka ndryshuar gjithçka? Është larguar ai që ne e njohim me emrin shpirt. Ishte shpirti ai që e kishte unifikuar qenien dhe strukturën e saj fizike. Ishte shpirti që frenonte dekompozimin e trupit dhe shpërbërjen e tij, por edhe ndihmonte shërimin e tij në raste sëmundjesh. Ishte shpirti ai që i kishte dhënë ndjesitë dhe aftësitë.

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për komunitetin e besimtarëve, apo për umetin mysliman. Kur këtij komuniteti (individë, familje dhe grupe) i depërton shpirti, shndërrohet në diçka tjetër për sa i përket energjisë, ndikimit dhe funksionit. Profeti Muhamed (a.s.) nuk shënoi ato arritje që njohim në Gadishullin Arabik, veçse me persona tek të cilët depërtoi deri në palcë shpirti i Kur'anit. Ata u unifikuan si një trup i vetëm, gjë të cilën Profeti (a.s.) e shpreh me fjalët: “Shembulli i besimtarëve në miqësinë, mëshirën dhe solidaritetin për njëri-tjetrin, është si shembulli i një trupi të vetëm, kur një organ lëngon përfshihet i gjithë trupi nga temperatura dhe pagjumësia.”¹⁰

Shohim që ai i shëmbëlleu marrëdhëniet e besimtarëve me njëri-tjetrin me trupin. Pasha Zotin! Nuk ka shembull dhe përngjasim më të goditur me të cilin mund të krahasohet uniteti, solidariteti dhe mishërimi, më mirë sesa një trup i

10. Muslimi.

vetëm. Le të sjellim një rast: Je duke ecur me shpejtësi të madhe dhe krejt befasisht sytë e tu shohin një gropë të thellë. Me një shpejtësi të madhe, sytë e transmetojnë lajmin në qendrën e analizimit të të dhënave në tru, i cili nga ana e tij lëshon urdhër për të gjithë trupin që të ndryshojë drejtim. Kjo mbështetje, ky mishërim, ky konstrukt dhe ky ndërveprim i kësaj forme, nuk mund të përshkruhet veçse si një trup i vetëm.

Por çfarë i bën këta trupa të ndarë dhe të përçarë, të bashkohen si një trup i vetëm, me ndjesi të vetme dhe unike, me këto raporte ndërvepruese mes aparateve të ndryshme pavarësisht funksioneve?

E gjitha kjo, falë shpirtit të Kur'anit, prandaj dhe duhet punuar që te ne të zërë vend shpirti i Kur'anit, i cili do të na japë jetë dhe do të na nxjerrë nga gjendja e vdekjes në gjendje jete, nga përçarja në bashkim si një umet i vetëm.

Efekt i shpirtit Kur'an te njeriu si lloj

Nëse i vdekuri ka humbur çdo lloj ndikimi, i gjalli ka ndikimin e tij në univers sipas dinamikës dhe formimit. Njeriu është një krijesë e veçantë, sepse Zoti e përzgjedhi si përgjegjës për jetën në tokë. **“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë.”**”¹¹

Për nder të njeriut, Zoti i

11. Bekare 2/30.

urdhëroi të gjithë engjëjt që t'i përuken në shenjë respekti, një pjesë të tyre i urdhëroi që t'i shërbejnë si mbrojtës dhe gjithçka tjetër e nënshtroi në shërbim të tij. **“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?”**¹²

Kështu njeriu është një krijesë e veçantë me aftësi të pazakonta. Nga vetë termi “halif” ndjejmë integrimin e brezave të njëri-tjetri, gjë të cilën e sqaron ajeti: **“Nëse do, ju zhdok dhe sjell pas jush çfarë të dojë, ashtu si ju ka krijuar nga pasardhësit e popujve të tjerë.”**¹³

Një ndër kuptimet e fjalës “halif” është një qenie që trashëgohet dhe se trashëgimia materiale bëhet si rezultat i vdekjes së të madhit dhe ardhjes së të voglit. “Hilafet” është shkëmbimi i çështjeve të kësaj bote dhe udhëheqjes së saj, siç thotë dhe profeti Muhamed (a.s.): “Kjo botë është e ëmbël dhe tërheqëse dhe Zoti jua ka besuar juve mbarëvajtjen e saj, prandaj shihni se çfarë veproni.”¹⁴

Me këtë shtrirje të konceptit “hilafet - mëkëmbësi”, njeriu mund të arrijë gjëra madhështore, që as në mendje nuk i kanë shkuar. Brezat e ardhshëm mund të arrijnë atje ku brezave të mëparshëm as që u ka vajtur në mendje. Falë ndërveprimit

12. Lukman 31/20.

13. En'am 6/133.

14. Muslimi.

mes brezave, që nga Ademi (a.s.) njeriu i parë në tokë e deri kur t'i vijë fundi jetës, plotësohet mesazhi i njeriut mbi tokë, përmbushet dhe realizohet "hilafeti" i tij.

Njeriu është nga ai lloj që trashëgon njëri-tjetrin dhe ai të cilit iu besua mbarëvajtja (hilafeti) e jetës në tokë. Atij iu besua ky amanet sipas një sistemi/rregulli, i cili akumulon informacionin dhe e integron dijen nga një brez te tjetri, atë dije e cila burimin e ka te Zoti i Lartësuar. Çdo dije që ekziston në univers dhe që zbulohet dhe përdoret nga njeriu, besimtar apo jo besimtar, origjina e saj është nga Zoti. Ajo gjendet te shpalljet hyjnore me të cilat është nderuar njeriu ose tek udhëzimi i brendshëm me të cilin Zoti e ka pajisur atë. **"Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar"**.¹⁵

Zoti i mësoi njeriut ato gjëra që nuk i dinte, falë shpalljeve, por edhe formave të tjera, edhe pse dija e shpalljeve është nëna e dijeve, pasi ajo është dija e ekuilibrave. **"Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjta) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejtë."**¹⁶

Si depërton te ne shpirti i Kur'anit?

Ne duhet të bëjmë çmos që

shpirti i Kur'anit të depërtojë në qenien tonë dhe kjo nuk mund të ndodhë veçse duke iu kthyer Librit të Zotit, lexim, veprim sipas tij dhe komunikim të mesazhit të tij. Kjo, sepse shpëtimi i njeriut nuk mund të garantohet veçse nëpërmjet katër pikave:

"Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje."¹⁷

Po, është një humbje e vazhdueshme dhe e përhershme, një rënie e pandërprerë në nivelin fillestar të krijimit: "U krijua në formën më të mirë" dhe që bie në nivelet më të ulëta, por: **"përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin."**¹⁸

Nëse njerëzit veprojnë vetëm njërin komponent nga katër komponentët e lartpërmendur, pra nëse vetëm "besojnë" pa bërë vepra të mira, pa u këshilluar në të vërtetën dhe pa e këshilluar njëri-tjetrin me durim, nuk i shpëtojnë dot humbjes. Pasazhi e refuzon diçka të tillë dhe nuk e pranon, ashtu siç e refuzon dhe aktualiteti. Nëse njeriu nuk lëviz drejt rrezatimit të mirësisë, duke u shndërruar në një burim vërshues mirësie, padyshim që, herët a vonë, do të ndotet dhe e keqja do të zërë vend në një formë a në një tjetër. Por nëse ai përcjell mirësi gjatë gjithë kohës, shndërrohet në burim mirësie,

15. Taha 20/50.

16. Hadid 57/25.

17. Asr 103/1-2.

18. Asr 103/3.

fton për mirësi dhe e praktikon atë, ai bëhet i padepërtueshëm nga e liga, pasi gatishmëria barazohet me zero. Ky njeri është i angazhuar dhe i zënë gjatë gjithë kohës me prodhimin e mirësisë për të tjerët. Ai është si uji, nëse nuk lëviz qelbet dhe prishet, por kur rrjedh pastrohet dhe bëhet i dobishëm. Edhe besimtari, nëse thjesht beson dhe vepron punë të mira, por pa këshilluar të tjerët për të vërtetën dhe pa i këshilluar ata për durim, është si uji që nuk rrjedh dhe uji që nuk rrjedh, nuk është i pastër.

Kriza e dëshmisë për njerëzit

Ne jemi një umet jo si të gjithë umetet (bashkësitë) e tjera, jemi një umet i një lloji të veçantë: **“Ju jeni umeti më i mirë i nxjerrë për njerëzit!”**¹⁹

Pra, jemi një umet i nxjerrë jo nga vetvetja, por i nxjerrë nga Krijuesi dhe fakti që jemi për njerëzit, do të thotë që jemi umet i ftesës dhe i thirrjes. Që këtu, disa dijetarë mendojnë se te përkufizimi i myslimanit duhet të shtohet fjala “thirrës-ftues”. Kështu, kur themi “mysliman”, kemi për qëllim atë njeri që beson te Zoti dhe fton tek Ai. Të qenët mysliman është një cilësi e cila në thelbin historik dhe tekstual ka të bëjë me ftesën për te Zoti. Ne jemi umeti i dëshmisë se mesazhi hyjnor u ka mbërritur njerëzve. **“O besimtarë! Përkuluni dhe përlununi në sexhde** (para

19. Imran 3/110.

Allahut)! **Adhuroni Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira për të arritur shpëtimin! Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar.”**²⁰

Kur thuhet luftoni, duhet të kemi parasysh se lufta fillon me ftesë. Në suren Furkan thuhet: **“Luftoji ata me forcë nëpërmjet këtij (Kur’ani).”**²¹

“Ai ju përzgjedhi” përbën pikën e startit për t’i shërbyer misionit të njeriut në tokë. Realisht, a mund të thuhet se jemi udhëzuar dhe kemi besuar vetëm falë punës sonë? E çfarë të mire mund të bëjë dikush që të meritojë mirësinë e besimit? Të gjithë ata që besojnë, besojnë falë mirësisë së Zotit. **“Ai të gjeti të humbur dhe të udhëzoi”**²² **“Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur!”**²³

Vetëm falë këtij rahmeti (mëshire) të pastër mbërriti ky besim dhe kjo mirësi te secili. **“Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh më parë (në Shkrimet e Shenjta) dhe në këtë (Kur’an), me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë**

20. Haxh 22/17-18.

21. Furkan 25/52.

22. Duha 93/7.

23. Bekare 2/198.

mbi njerëzit e tjerë.²⁴ Pra, qëllimi është: “me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë.” Ky funksion ka qenë dhe funksioni i vetë të dërguarit të Zotit (a.s.) dhe mbetet funksioni i ndjekësve të tij.

“Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?”²⁵

“që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit.”²⁶

Çdo brez është dëshmitar për brezin që pason, secili sipas nivelit. Më të diturit që kanë përfituar më së shumti nga trashëgimia profetike, do të dëshmojnë më shumë.

Një nga sociologët myslimanë të ditëve tona, ka futur dhe tiparin thirrës teksa përkufizon myslimanin. Sipas tij, mysliman i vërtetë nuk mund të jesh veçse duke qenë përcjellës dhe komunikues i kësaj të mire dhe duke duruar vështirësitë e kësaj rruge. Prandaj, është obligim për secilin prej nesh, që të bëjë çmos që ta përhapë këtë mirësi, me qëllim që ky shpirt të zërë vend tek të gjithë myslimanët për të ndryshuar gjendjen tonë. Ne synojmë që nga njëri cep i botës në cepin tjetër, të bëhemi dhe të ndjehemi si një umet i vetëm, ashtu siç na do Zoti, gjë të cilën nuk mund ta përmbushim pa shpirtin e vetëm që na bashkon,

24. Haxh 22/78.

25. Nisa 4/41.

26. Bekare 2/143.

shpirtin e Kur’anit, i cili duhet të zërë vend tek individët dhe komuniteti mysliman kudo që të jetë.

Rëndësia e të kuptuarit të mesazhit të Kur’anit

Nëse e ndiejmë siç duhet, detyra jonë e parë është që të fokusohemi tek të kuptuarit e drejtë të fesë dhe të këtij Kur’ani, i cili është mesazhi që na është përcjellë nga Profeti (a.s.).

“Ky Kur’an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet.”²⁷

Ky mesazh vjen nga Zoti i njerëzve, e nëse nuk e lexojmë e nuk e kuptojmë siç duhet, si do të mund ta kuptojmë qëllimin e tij? Sa mund ta zbatojmë atë? E nëse mjaftohemi vetëm me leximin e këtij mesazhi, pa e kuptuar atë, si do të mund ta zbatojmë? Sigurisht që në një rast të tillë kemi të bëjmë me një problematikë madhore. Zoti e dërgoi këtë mirësi për lumturimin e njerëzimit, me qëllim që njerëzit të bëjnë një jetë të mirë. **“...të cilëve engjëjt ua marrin shpirtat, duke qenë të pastër. U thonë atyre: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!”²⁸** Po, ata ishin të pastër në të ushqyer, në të folur, në të menduar, në të vepruar dhe në çdo gjendje, prandaj dhe merituan urimin e engjëjve: **“Kur t’i afrohen atij**

27. En’am 6/19.

28. Nahl 16/32.

(xhenetit), **dyert e tij do të hapen e rojtarët e tij do t'u thonë atyre: “Shpëtimi qoftë mbi ju! Ju keni qenë njerëz të mirë, andaj hyni në të dhe qëndroni përgjithmonë!”**²⁹

Njohja e arabishtes për kuptimin e Kur'anit

Nëse nuk do të mund të perceptojmë drejt qëllimin e këtij mesazhi hyjnor, nuk do të mund të përfitojmë prej tij. Prandaj dhe kërkohet prej çdo myslimani ta njohë gjuhën në të cilën është shpallur Kur'ani. **“Gjuhë arabe e qartë”**³⁰. Çfarëdo devijimi i myslimanëve për ta shmangur këtë gjuhë, konsiderohet i papranueshëm. Myslmanët duhet t'i japin kësaj çështjeje të gjithë vëmendjen e nevojshme, ta mësojnë gjuhën arabe, t'ua mësojnë dhe të tjerëve dhe t'u mundësojnë njerëzve që t'i shijojnë sekretet e saj, sepse dera kryesore për të kuptuar Kur'anin është gjuha në të cilën është shpallur.

Institucionet e arsimit në botën islame kanë një përgjegjësi të madhe në këtë drejtim, pasi gjithçka duhet ndërtuar mbi Kur'anin dhe me objektivat e tij madhore. Fëmijëve tanë u duhet kultivuar që në moshë të hershme shpirti i Kur'anit dhe vlerat e tij. Vetëm duke i kuptuar objektivat e Kur'anit, mund të arrijmë te zbatimi i tij, gjë e cila është dhe shkak i shpalljes. Nëse

Kur'ani nuk kuptohet dhe nuk vihet në praktikë, si mund të përfitohet prej tij? Nëse një person të kërkon ndihmë për lokalizimin e një vendi dhe ti ia përshkruan me detaje dhe koordinata të sakta, por ai ndjek një drejtim krejt tjetër, nuk ka përfutuar fare nga këshillat dhe ndihma jote, ai kurrë nuk mund të arrijë te destinacioni që kërkon. Kur'ani është udhëzim. **“Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”**³¹

Ai që nuk i ndjek udhëzimet e tij është pa orientimin e duhur. Prandaj dhe lipset që të largohen të gjitha pengesat e akumuluar mes nesh dhe Kur'anit, pengesa e gjuhës, leximit, kuptimit dhe zbatimit. Njëkohësisht, duhet të heqim dorë edhe nga gjithçka tjetër që na largon nga Kur'ani, siç është ndjekja e pasionit.

“Ka disa njerëz që sajojnë tregime të kota, për të shmangur (të tjerët) nga rruga e Allahut me paditurinë e tyre e për t'u tallur me të.”³²

Ka njerëz që e prodhojnë të kotën, e shesin, e blejnë, e shpërndajnë etj...

29. Zumer 39/73.

30. Shuara 26/195.

31. Maide 5/15-16.

32. Lukman 31/6.

Frytet nga shpirti i Kur'anit në nivel umeti

Falë këtyre përpjekjeve të pandërprera mund të arrijmë - në dashtë Zotit - që umetit t'i kthehet shpirti i Kur'anit, e nëse ndodh kjo, do të shfaqen shenjat e para të jetës, ajo ndjesi për njëri-tjetrin, ku nëse një vend mysliman lëngon, të gjitha vendet brofin për t'iu gjendur pranë. Kur shpirti i Kur'anit depërton në trupin e umetit, të gjithë organet e tij fillojnë aktivitetin sipas funksioneve,

funksioni i jetës, i dritës, i udhëzimit, nxjerrjes nga errësirat në dritë, shërimit, mëshirës etj. Prandaj dhe na lipset që të punojmë fort për largimin e pengesave që na ndajnë nga Kur'ani dhe të bëjmë çmos për ta kuptuar dhe për t'ua sqaruar dhe të tjerëve.³³

Përktheu: Elmaz Fida

33. Marrë nga Revista El-Hira, nr. 41, viti XIX (mars – prill), Stamboll, Turqi, 2014:10-15.

**Hafiz Bajram ef. Agani,
nismëtar dhe projektues i riorganizimit të
Bashkësisë Islame të Kosovës
pas Luftës së Dytë Botërore (1947-1951)**

**Ramadan Shkodra
Bashkësia Islame e Kosovës**

Abstrakt

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe njëherë ndahet padrejtësisht nga e ëma e saj, Shqipëria, dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajës artificiale të quajtur Jugosllavi. Me këtë akt edhe Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë detyrimisht do të ndryshojë qendrën nga Tirana në Sarajevë dhe, që nga viti 1945 e deri më 1990, do të veprojë si Bashkësia e Fesë Islame për Serbinë, respektivisht për Kosovën, Serbinë dhe Vojvodinën, me seli në Prishtinë, në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të Federatës Jugosllave me qendër në Sarajevë.

Në këto rrethana të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, në organizimin, funksionalizimin, strukturimin në terren dhe drejtimin e Bashkësisë Islame, kontribut determinues ka dhënë brezi i ulemasë shqiptare, në mesin e tyre edhe vizionari i shquar Hafiz Bajram ef. Agani, të cilit do t'i binte barra kryesore, sepse do të vihej në krye të këtij institucioni dhe strukturave të tij.



Hyrje

Organizimi i jetës fetare islame në Kosovë zë fill që nga koha e administrimit të Perandorisë Osmane në këto anë. Gjatë asaj kohe, organizimi i jetës fetare islame, në çdo anë të Perandorisë, ka qenë i rregulluar nëpërmjet autoritetit fetar dhe politik, sipas të cilit, organizimin fetar islam dhe funksionet shtetërore, i ka ushtruar një strukturë unike (din ue deule), kurse bashkësitë e tjera fetare kanë pasur organizimet e veta të veçanta.

Në kuadër të Perandorisë Osmane, në kuptimin organizativ fetar islam, të gjithë myslimanët në Ballkan kanë qenë pjesë përbërëse e Bashkësisë Unike Myslimane, në krye të së cilës ka qëndruar Sulltani në funksionin e Kalifit. Kompetencat dhe prerogativat e kalifit në kohën e qeverisjes së sulltan

Muratit II (1421-1451), janë bartur në myftiun kryesor, kështu që nga atëherë, myftiu kryesor në kuadër të Perandorisë Osmane ka bartur titullin Shejhul-islam, i cili ishte edhe autoriteti më i lartë fetar islam në gjithë Perandorinë. Këtë post e kanë pasur edhe tre shqiptarë: Ali efendi Zembili (1503-1526), Ibrahim Bej efendi Ajvaz Pasha-zade (1719-1797) dhe Abdurrahman Nesip Efendiu (1842-1914). Ndërkaq, në nivelin lokal, autoritetin qendror të Shejhul-islamit e kanë pasur myftinj të rretheve.

Me tërheqjen e Perandorisë Osmane nga trojet shqiptare, për dallim nga Komuniteti Mysliman Shqiptar, i cili u themelua në Tiranë më 1923, në Kosovë u krijuan rrethana të reja shoqërore-politike të pafavorshme për shqiptarët dhe për bashkësinë e tyre fetare islame, sidomos në ato troje që u pushtuan nga okupatori sllav.

Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë, siç quhej asokohe, që nga largimi i osmanëve është angazhuar dhe ka luftuar të ketë autonominë fetare dhe të gëzonte të drejtat dhe statusin e saj, por kjo nuk ishte e mundur dhe në ato rrethana as që mund të ndodhte ndryshe.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Bashkësia e Fesë Islame, në kuadër të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (1918-1929), ka qenë e organizuar në atë mënyrë që myslimanët e Bosnjës

dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë kanë pasur një bashkësi, me në krye Reis-ul-ulemanë me seli në Sarajevë, ndërsa myslimanët në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe në Mal të Zi kanë pasur bashkësi të veçantë me në krye myftiun suprem me seli në Beograd.

Ndryshimet e mëdha që ndodhën me vendosjen e diktaturës së Mbretërisë Jugosllave (6 janar 1929), do ta godisnin edhe Bashkësinë e Fesë Islame, e cila do të pësonte ndryshime të dukshme, ngase vendet që deri atëherë vareshin nga ish-Myftinia Supreme e Beogradit, pra edhe Kosova, do të kalonin në vartësi të Ulema Mexhlsit të sapoformuar në Shkup, që, së bashku me Ulema Mexhlsin e Sarajevës, përbënin Rijasetin e Bashkësisë Islame me seli në Sarajevë.

Gjatë periudhës 1941-1944, Bashkësia e Fesë Islame e Kosovës, me dy Kryemyftinitë e saj (Kryemyftininë e Prizrenit dhe Kryemyftininë e Prishtinës), do të lidhej me Komunitetin Mysliman me qendër në Tiranë. Organizimi i saj ishte i ndarë në Kryemyftini dhe Nënmyftini. Në krye të këtyre institucioneve qenë vënë personalitete kompetente, të cilët ishin dalluar, përveç të tjerash, edhe në planin kombëtar, mes dy luftërave botërore, siç ishin myftinjët: Hasan Islami-Nahi në Prizren, Rexhep Remziu në Prishtinë, nënmyftiu Mulla Idris Gjilani në Gjilan,

nënmyftiu Ahmet Hasani në Ferizaj, nënmyftiu Fahri ef. Iljasi në Gjakovë etj. Dekretimi i nëpunësve fetarë që nga myezinët e deri te myftinjtë bëhej nga Komuniteti Mysliman në Tiranë, që udhëhiqej nga Dr. Behxhet Shapati e më pastaj edhe nga Hafiz Sherif ef. Langu.

E veçanta e kësaj periudhe ka të bëjë me faktin se administrata e këtyre institucioneve vepronte ekskluzivisht në gjuhën shqipe. Në këtë kohë në Kosovë, në mënyrë të lirë dhe haptazi, shpërndahej literatura islame nga Shqipëria, si revistat: “Kultura Islame”, “Zani i Naltë”, “Mevludi” i Hafiz Ali Riza Ulqinakut, veprat e Hafiz Ibrahim Dallit, veprat e Hafiz Ali Korçës, Haki Sharofit, Hafiz Abdullah Zëmlakut etj.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova ndahet edhe njëherë padrejtësisht nga mëma e saj, Shqipëria, dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajësës artificiale të quajtur Jugosllavi. Me këtë akt edhe Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë detyrimisht do të ndryshojë qendrën nga Tirana në Sarajevë dhe që nga viti 1945 e deri më 1990 do të veprojë si Bashkësia e Fesë Islame për Serbinë, respektivisht për Kosovën, Serbinë dhe Vojvodinën, me seli në Prishtinë, në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të Federatës Jugosllave me qendër në Sarajevë.

Në këto rrethana, të krijuara pas Luftës së Dytë Botërore në

Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare ish-Jugosllavi, në organizimin, funksionalizimin, strukturimin në terren dhe drejtimin e Bashkësisë Islame, kontribut determinues ka dhënë brezi i ulemasë shqiptare, në mesin e tyre edhe vizionari i shquar Hafiz Bajram ef. Agani, të cilit do t'i binte barra kryesore, sepse do të vihej në krye të këtij institucioni dhe strukturave të tij.

Para së të flasim për kontributin e Hafiz Bjaram Aganit në riorganizimin e BIK-së, e shohim me vend që të japim një pasqyrë të shkurtër të gjendjes shoqërore e politike në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.

Gjendja politiko-shoqërore pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë

Pas Luftës së Dytë Botërore, rrjedha objektive e ngjarjeve që çonte drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, u ndërpre. Popullsia shqiptare e Kosovës u përball me presionet, me mashtrimet dhe me dhunën e udhëheqësve komunistë jugosllavë, sidomos të atyre serbë. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës, u harruan. Në të njëjtën kohë kur brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrah popujve jugosllavë për çlirimin e plotë të Jugosllavisë, mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi u ushtrua

një shtypje e egër kombëtare, pati arrestime, terror e persekutime të shqiptarëve (kujtojmë këtu plojën e Tivarit, Luftën e Drenicës, masakrën e Gjilanit etj.), u ndalua përdorimi i flamurit kombëtar, nëpunësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me ata serbë.

Goditjet që u ndërmorën mbi popullsinë shqiptare menjëherë pas luftës e gjatë Administratës Ushtarake ishin në përputhje me Elaboratin e Vasa Çubrilloviqit “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re”, dërguar qeverisë së re jugosllave ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor të vitit 1944.

Përballë gjithë këtyre, popullata shqiptare nuk ndenji duarkryq, por u organizua kundër riokupimit të Kosovës nga Serbia, përkatësisht Jugosllavia. Në ballë të këtyre revoltave dhe rezistencës shqiptare, pa dyshim u gjend edhe ulemaja shqiptare dhe në shërbim të tyre u vunë edhe institucionet islame, si xhamitë, medresetë etj.

Pas shtypjes së revoltave masive popullore nga ana e pushtetit komunist, qëndresa kundër pushtetit jugosllav vazhdoi në rrugë ilegale. U krijuan disa organizata të fshehta. Më e rëndësishmja ndër to ishte Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare (ONDSH), e cila në radhët e saja kishte shumë imamë e hoxhallarë që ndihmuan në drejtimin, strukturimin por edhe në masivizimin e kësaj lëvizjeje.

Duhet thënë se, qëndrimi i sistemit komunist që po instalohej në përfundim të Luftës së Dytë Botërore në një pjesë të madhe të Evropës, e fatkeqësisht edhe në Shqipëri dhe në viset tona, për sa i përket fesë, ishte armiqësor. Kjo sepse, sipas pikëpamjeve komuniste, feja shihej si pengesë kryesore për jetësimin e platformës ideologjike komuniste, ngaqë feja kishte rol të rëndësishëm dhe ishte e shtrirë në gjithë popullin.

Në Kosovë dhe në Maqedoni, sistemi komunist që po instalohej, përveç arsyeve etnike dhe fetare, kishte edhe një arsye më tepër që të vihej në ndjekje të ulemasë shqiptare dhe atakimin e institucioneve islame, sepse këta bënë rezistencë të fortë dhe qenë angazhuar me gjithçka patën kundër ripushtimit sllav dhe mbrojtën vatanin dhe fenë e tyre. Është e tepërt të përmendet këtu roli i mulla Idriz Gjilanit, Ibrahim Lutfiut, Haki ef. Sermaxhës, Iljaz ef. Brojës, Asim ef. Luzhës e shumë të tjerëve.

Angazhimi i imamëve dhe hoxhallarëve në radhët e NDSH-së është vazhdimësi e kontributit të ulemasë shqiptare në lëvizjet e mëdha për popullin tonë, që nga Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës, pastaj kontributi i ulemasë gjatë Rilindjes Kombëtare, si dhe përkrahja dhe mbështetja për formacionet patriotike që ishin në shërbim të vetëdijes për kombformim dhe shtetformim.

Riorganizimi i Bashkësisë Islame në Kosovë dhe roli i Hafiz Bajram ef. Aganit

Ulemaja shqiptare, e vetëdijshme për peshën që ka mbi vete dhe duke parë rrethanat e reja që tash e tutje nuk i lejonin që të vazhdonin të ishin të lidhur me qendrën në Tiranë, me qëllim që të ruante mëvetësinë, filloi të riorganizojë institucionalisht. Kështu, në Prizren, më 11-12 korrik 1945, mbajtën Kongresin e Parë të Ulemave të Kosovës. Si rezultat i këtij Kuvendi - Mexhlisi të ulemasë kosovare, doli edhe udhëheqja e re - Kryesia e saj, me përbërje Rexhep ef. Remziun-kryetar, Fahri ef. Iljazin - nënkryetar, Sheh Hasanin - nënkryetar, Jusuf ef. Imamin, Hasan ef. Islamin-Nahin, Haki ef. Taipin (Sermaxhaj), Mustafë ef. Hoxhën dhe Avdurrachim Kuçanin - sekretar.

Në këtë përbërje, organizimi i Bashkësisë Islame funksionoi deri më 26-27 gusht 1947, kur të gjithë përfaqësuesit e myslimanëve të federatës së asaj kohe, si nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi, miratuan një rezolutë me të cilën shprehnin gatishmërinë për organizimin dhe funksionalizimin e bashkësisë islame, rezolutë e cila realisht hyri në fuqi në vitin 1948.

Këtë vit, pra më 1947, miratohet edhe kushtetuta e Bashkësisë së Fesë Islame në ish-Jugosllavi dhe kështu krijohen bazat ligjore për organizimin e Bashkësive Islame në nivelin qendror dhe në atë lokal.

Sipas kësaj Kushtetute formohet edhe Bashkësia e Fesë Islame me seli në Prishtinë, ndërsa kryetar i parë i saj emërohet Hafiz Bajram ef. Agani, i cili udhëhoqi BFI-në e Kosovës gjatë viteve 1948-1959.

Rregullimi i brendshëm i këtyre bashkësive ndërkaq bëhej mbi bazën e statuteve. Kështu, Bashkësia Islame në Kosovë, në vitin 1948, kishte miratuar statutin e saj, sipas të cilit (neni 17), kjo bashkësi kishte këtë organizim:

- *Imami i xhematit*
- *Këshilli i Vakëfit të Rrethit*
- *Kryesia e Fesë Islame dhe*
- *Kuvendi i Vakëfit me Këshillin e*

Kuvendit dhe Drejtorinë e Vakëfit.

Ky statut shënon aktin e parë të organizimit të BFI-së së Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. Ky dokument është i shkruar në gjuhën shqipe dhe përmban 13 faqe, i ndarë në 16 njësi me 43 artikuj, përkatësisht nene. Ky statut është aprovuar me vendimin e Vakëfit nr. 696/48, datë 10 korrik 1948 dhe është i firmosur nga Hafiz Bajram ef. Agani.

Angazhimi i Hafiz Bajram Aganit në konsolidimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, shtrirjen e saj në këshillat e vakëfit, siç quheshin asokohe, pastaj strukturimi i BI në nivel të Rijasetit etj., është tepër vendimtar dhe domethënës. Kjo më së miri shihet në raportet e punës, në procesverbalet, qarkoret dhe relacionet e Bashkësisë Islame të Kosovës që mbajnë firmën e Hafiz Bajram ef. Aganit, qoftë më këshillat

e vakëfit, qoftë me Kryesinë Supreme të Bashkësisë Islame në Sarajevë, qoftë me organet e atëhershme krahinore.

Themelues, myderriz dhe udhëheqës i Medresesë

Përveç konsolidimit dhe strukturimit të BI në Kosovë, Bajram ef. Agani i kushtoi një rëndësi të veçantë edhe themelimit të institucioneve arsimore e kulturore në kuadër të BI-së si nevojë e domosdoshme për funksionimin normal dhe ngritjen e saj në nivel të përgjegjësisë dhe misionit.

Pasi pushteti monist kishte mbyllur të gjitha medresetë në Kosovë, popullatës myslimane iu bë e pamundur që të shkollohej në ndonjë shkollë fetare të sajën. Duke e ndier këtë nevojë dhe duke ditur rëndësinë e hapjes së një shkolle fetare islame në gjuhën shqipe, Hafiz Bajram ef. Agani, do të angazhohej me mish e me shpirt që një e tillë të hapej në Kosovë.

Kështu, me iniciativën dhe punën e tij të pashoqe, më 1 nëntor 1951, do të nisë punën Medreseja e Ulët Shqiptare e Prishtinës, me myderrizët e parë të saj mësuesin e shkollës kombëtare myderrizin Ahmed ef. Mustafën, që ishte edhe drejtues i parë i saj, pastaj Hafiz Ishak Saidin, veteranin e arsimit kombëtar Haki Krasniqin etj. Ndërsa Hafiz Bajram ef. Agani do të ligjëronte lëndët gjuhë arabe, akaid, ahlak dhe husni hat/kaligrafi.

Kjo lirisht mund të konsiderohet një ndër arritjet më të mëdha dhe më të rëndësishme të periudhës së Hafiz Bajram ef. Aganit në krye të BI-së.

Përveç si pedagog në medrese nga 1 janar 1953 deri më 15 dhjetor 1956, Hafiz Bajram ef. Agani ka qenë dhe drejtor i saj. Gjatë kohës si myderriz në medrese dhe për katër vjet si drejtues i saj, Hafiz Bajrami dha një kontribut të çmueshëm në arsimimin dhe edukimin e nxënësve të medresesë dhe shquhej sidomos për dijet e tij të thella dhe metodologjinë e avancuar pedagogjike-didaktike.

Themelues i Bibliotekës së Vakëfit

Krahas udhëheqjes së Bashkësisë Islame dhe medresesë, Hafiz Bajram Efendiu, në vitin 1951 do të themelonte “Bibliotekën Qendrore të Vakëfit” në Prishtinë. Meqë Kosova kishte trashëguar një fond librar shumë të pasur me dorëshkrime e libra në gjuhët orientale, duke ditur rëndësinë e vlerat e tyre dhe nga frika e shkatërrimit e humbjes së kësaj pasurie, Hafiz Bajram ef. Agani, më 24 shtator 1951, do të themelonte “Bibliotekën Qendrore të Vakëfit” në Prishtinë, që njihej edhe me emërtimet “Kutubhaneja e Vakëfit” ose shkurt “Biblioteka e Vakëfit”. Dhe jo vetëm kaq, por Bajram ef. Agani ishte angazhuar personalisht edhe në pasurimin dhe mbushjen me libra e dorëshkrime të kësaj biblioteke, duke pasuruar kështu

fondet e saj me një numër të madh librash e dorëshkrimesh islame dhe kishte punësuar edhe bibliotekarin e saj, Faik Hamdibegollin nga Prishtina. Për më tepër, duke qenë një dashamir i madh i librit, një dijetar dhe intelektual i mirëfilltë, Hafiz Bajram ef. Agani, më 2 shtator 1958, kishte hartuar edhe një katalog me 256 faqe të dorëshkrimeve dhe librave që posedonte kjo bibliotekë, që përfundon me numrin 2092 njësi-qitape. Kjo ishte një arritje tjetër e BFI-së së Kosovës me Hafiz Bajram ef. Aganin në krye.

Nismëtar i literaturës islame në gjuhën shqipe

Bajram ef. Agani u dallua edhe si iniciator dhe nismëtar i literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë. Ai duke parë mungesën e literaturës islame në gjuhën shqipe dhe nevojën e besimtarëve për të njohur fenë e tyre, më 1957 së bashku me Mehmet Gjevorin botuan të përkthyer Ilmihalin dhe Jasini Sherifin, botime këto që shënjuan fillimin e veprimtarisë botuese islame në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi.

Në vitin 1954 Hafiz Bajram efendiu në përgjigje të nevojave të kohës dhe kërkesave të besimtarëve, kishte hartuar edhe një “Takvim” për llogaritjen e kohëve të namazit dhe festave fetare, por i cili mbeti në dorëshkrim.

Ai qe edhe nismëtar i kultivimit të gjuhës shqipe edhe në hytbet, vazet e nasihatet që mbanin imamët

gjithandej nëpër xhamitë e Kosovës.

Për këtë qëllim, ai, që atëkohë, kishte përgatitur 52 hytbe tematike dhe shumë ligjërata të shtypura me makinë shkrimi dhe ua kishte dërguar të gjithë imamëve të Kosovës, duke vënë kështu një bazë të mirë në gjuhën e ligjërimit shqip nëpër xhamitë e Kosovës.

Përfundim

Nga sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se, riorganizimi dhe konsolidimi i BI të Kosovës, themelimi i medresesë dhe i bibliotekës, nismat për përkthimin e literaturës në gjuhën shqipe dhe një sërë ndërmarrjesh të tjera, shënojnë epokën e Hafiz Bajram ef. Aganit dhe

kur kësaj ia shtojmë edhe rrethanat e vështira në të cilat ai veproi, lirisht mund të themi se Hafiz Bajram ef. Agani mbetet personaliteti më emblemantik në historinë e re të BI të Kosovës.

Angazhimi, puna, kontributi e përkushtimi i Hafiz Bajram Aganit për Bashkësinë Islame në Kosovë dhe për institucionet e saj, e bëjnë atë një strateg të pasqor, një vizionar të thellë e largpamës, një personalitet që në kohë të vështira e plot kthesa, diti dhe arriti të vinte themele të forta e të qëndrueshme, që i bënë ballë stuhisë së monizmit e komunizmit.

Frytet e punës së nisur nga Hafiz Bajram ef. Agani vazhdojnë të korren edhe sot.

Burimet dhe literatura:

- Arkivi i Kosovës, *Fondi Bashkësia e Fesë Islame - Drejtoria e Vakëfjeve - Prishtinë*, viti 1951-1954.
- Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, *Katalogu i dorëshkrimeve të bibliotekës së Vakëfit*, libri nr. 1, viti 1958.
- *Koleksioni i hytbeve të Bajram ef. Aganit*, (dorëshkrim), pronë e Ferat ef. Gërgurit dhe Mustafë ef. Dervishollit, ish-nxënës të myderriz Bajram Aganit.
- Revista “Glasnik Vrhovnog Islamskog Starjesinstva” FNRJ, nr. 7-9, 1951, Sarajevo.
- Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë 1945 - 1980*, Prishtinë, 1988.
- Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike (studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2010.
- Sadik Mehmeti, *Hafëz Bajram ef. Agani ishte edhe “Hafëz-i kutub”*, “Dituria Islame”, nr. 200, mars, 2007, Prishtinë, (f. 41-42).
- Ramadan Shkodra - Aziz Pireva, *Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë 1957-1997*, Prishtinë, 1998.
- Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2013.

Abstracts in English

Islamic Sciences

1. An overview on belief in afterlife

Ali Zaimi

Abstract

It is quite impossible for an individual who doesn't believe that he/she will be taken into account for his/her deeds, to have a regular and honest life. On the other hand, the life of an individual who keeps always in mind that one day he/she will face Allah and will give account for everything he/she has done, accompanied by the awareness of accountability and therefore right. Of course, the human will be such even in his/her relation regarding the awareness on the account he/she will face beyond. The belief that one day he/she will be rewarded motivates a good individual to do good deeds; the idea of punishment for his/her sins deters him/her from being violent and thoughtless; fear of accountability deters him/her from doing evil even where no one can see him/her; the belief that they will meet again in another world comforts a child who has lost a relative or an elderly person who is, as they say, with one foot in the other world, etc.

2. Abu Hanifa's attitude during political developments of his time Dorian Demetja

Abstract

Great people that history marks, emerge at a time when disorders in society reach their peak. To put some order in the external world, one must first establish order and balance within himself. In this respect, Abu Hanifah was a man of the middle way and foremost a man of a highly balanced personality and great determination. If we consider the time in which he lived, we will observe severe political and social problems and furthermore, a lot of clashes and conflicts between groups of different religions and religious sects. He could simply choose the shortest way, i.e., becoming partial from the beginning, but he never changed his attitude, sacrificing much for the right path, and trying to make possible even to the others experiencing the justice. Given this, it is not wrong to say that Abu Hanifa lived as he thought and believed and believed as he lived and thought.

3. Hz. Muhammad a.s. – an example to follow Imam Muhamed Sytari

Abstract

His traditions in speech and in action complement one another. It seems as every requirement regarding spiritual aspect is predetermined and precalculated. Everything, the humans face in their life, appears in the examples of his life a.s.

Meanwhile, the Lord of Universe through His goodness to us, blasted Hz. Muhammad a.s. as the Seal of His good messengers, the guide and the complement of His blessings, for whom today's world is really in need.

Studies

4. The stain in the biography Nga Fatos A. Kopliku MS/MA Washington, DC

Abstract

The dictatorship of the proletariat had plenty of absurdities, and the “blot in biography” was for sure one of them. As it is well known, the “blot” was a 20th century branding that followed the “blotted” for all their life, including relatives and children, and deprived them of the basic rights as a citizen. The blot in biography could be in different forms: having graduated abroad, knowledge of foreign languages, expression of “retrograde” or “backwards” thoughts in a book or article... and of course, the family lineage.

Yet, why is it this important to talk about this practice of the past? The reason is because the biography “blot” hunt is still on and their story has not come to an end; something that bears witness to the fact that Albanians are still confronted with the consequences of the mentality carved during decades of systematic massive indoctrination. As a result, there is more than a quarter of a century that we are being asked to distance ourselves from another blot, that of Islam. The narrative has been passed on with few changes in form but none in essence, telling us that Islam is the reason of the backwardness, mentality, lack of civilization, even the perturber of the purity of the Albanian blood... Such rhetoric leads one to believe that the “new man, the greatest work of the party” is still alive and well among Albanians, and the vigilance against blots has not ceased; it has simply changed form. Of course, this cannot not be a cause for concern.

Literature

5. Poem “ERVEHEJA” – A fourth world that sublimated the lack of albanian life

Prof. dr. Rahim Ombashi
Responsible of Communication Sciences Department
Full Moon - Bedër University

Abstract

The masterpiece “Ervebeja” of poet Mubammad Kycyku (1784-1844) continued for a long time to be the most popular work in the Albanian Renaissance’s literature, after its first publication in 1888 at Bucharest by Jani Vreto. Although the number of those who read the Arabic alphabet was very low, this narrative poem of only 214 Octosyllable quatrains was tasted, understood and appreciated by a large number of fans. The cause of its massive spread must firstly be seen in the simplicity of this poetry work, especially after its two reviews: “Completed from Haydar Argirokastriti and the cleanse of foreign words by J. Vreto”, but also in the social utopian mission of this kind of literature. Being an intentional literature, its socio-cultural context impacted more the listener - which became determinant - rather than its text. After the discovery and publication of the original text of “Ervebeja,” a kind of criticism woke up because the yeast of how semantically an artistic work must be read, is hidden within the creation itself, which is to be interpreted through the semiotic method. The stress was put to the source, bypassing the universal thematics as a field in which its literary content is found, approaching closer its cultural thematics that is related to the Islamic faith and Muslim culture. Its prevailing idea appears of individual nature, and the topic is related to the pain of life and several subthemes and motifs derived from it. After collecting the information, one will shift into a reflective analysis, which helps in accessing the dream, whim and fantasy to the social reality.

Interreligious studies

6. Freedom of religion and interfaith dialogue in Albania
Vlash Plepi, Orthodox Theological Academy, Durrës

Abstract

Conversation and communication with the followers of other religions becomes easier when we accept the others as our brothers and sisters while respecting their freedom, particularly the freedom of conscience. We accept them as they are, with sincere love, sharing together their religious experiences that have been most important in our researches on the meaning of life and death and in our desire for the eternal God.

The development of dialogue and religious tolerance doesn't impose any common agreement, but only respect for religious freedom and the right of every person to choose the vision and the way he agrees to follow in his approach to the Divine.

Communication science

7. The image of Islam in the Albanian media, *Charlie Hebdo case* MSc. Qani Sulku

Abstract

How easy or difficult it is to maintain or improve the image after a rightly or wrongly slur? What role did Albanian Muslim Community (MCA) - the only representative institution of the Muslims in the Republic of Albania - had in the preserve of Islam and Muslims' image, through the participation of its representatives in TV programs during the discussions on various topics, which focused on Charlie Hebdo issue? How professional the program managers appeared in dealing with such topics, in not being one-sided, or in not creating wrong perceptions and attitudes? Did in these analytical programs, appear any of those who came with the intention to desecrate Islam and Muslims? Were the titles and core topics of these TV shows relevant and carefully selected, or they had topics labels that violate the religious affiliation of Muslim believers? These are some of the questions on which I will try to shed light in this paper, by observing, studying and comparing the Albanian media programs dated January 7, 2015 onwards, which had as their focus the Charlie Hebdo issue and topics that were related to the causes that led to this tragic act.

History

8. Modernity and ideology in the Ottoman Empire textbooks (-Albania and Albanians in Ottoman school textbooks -) Dr. Hasan Bello Albanological Studies Center, Institute of History -Tirana

Abstract

It can not be said that in Ottoman textbooks were openly mentioned races and nations, but there were times when while handling certain aspects within any particular geographic nature, details of interest to our nation were also described. Thus, in the text "the Ottoman geography" ("Coğrafya-yı Osmani") in which some provinces and characteristics of the Empire's peoples were described, Albanian people was taken as an example of hospitality and generosity. Author explained the lack of hostels (guesthouses) in Albanian cities through the fact that the tradition of this people occupied an important place. According to him, anyone traveling around the country who hadn't a place to reside - whether Muslim or Christian - if he knocked on the door of any Albanian family, became immediately a guest in their house. The host was obliged to provide food and hospitality to the guest for the entire period of his stay.

9. Role of Muslim clerics in the formation of the first Albanian state

Dr. Mois Kamberi

“Aleksandër Moisiu” University, Durrës

Abstract

All the historical events, political movements and the diplomatic development leading to the declaration of the independence and the creation of the first Albanian government cannot be properly appreciated without a note on the major contribution of the Albanian clerics who were considered the most important intellectuals in Albania. Many crucial historical moments in the Albanian National Movement involving the Albanian League of Prizren, League of Peja, the Congress of Manastir, the Congress of Dibra and the Congress of Elbasan, and the major uprisings of Albanians during 1910-1912, were led by the Albanian members of the clergy. Their patriotic contribution and their nationalistic ideals and thoughts exerted a great influence in the Albanian National Movement for they were chosen and elected as important representatives in the assemblies and congresses which were influential for the destiny of Albania as a country. Their contribution paved the way for their participation in the governing structures; e.g. Haxhi Ymer Prizreni was Chairman of the Provisional Government of the League and Haxhi Zeka was Chairman of the League of Peja, Vehbi Dibra was Chairman of the Congress of Dibra, etc. The contribution of the Albanian members of the clergy pervaded as the uprisings of Albanians proved successful in their endeavors against the policies of the Balkans' monarchies or Great Powers. These uprisings led to the summoning of the National Assembly to lay the ground for the declaration of Albania's Independence and the creation of the first Albanian government headed by Ismail Qemali. The good patriotic contribution of the clerics led to their election as chairmen of the highest position in the first Albanian government such as: Vehbi Dibra (Agolli), who was chairman of the Albanian Assembly of the Seniors and Dom Nikoll Kaçorri, who was vice-chairman of the Provisional Government of Vlora. They laid heads together and set forth the idea of creating a pan-Albanian government.

Translation

10. The Quran, the soul of the Muslim Ummah

Prof. Dr. Shahid Bushihi

Morocco

Abstract

As this transformation occurs in individuals, it occurs to communities too. Even when it comes to a community, the Qur'an causes the same change and transformation that does the soul to the body. It brings together the separate parts of society and provides a unique and collaborative model of it. The body of the dead, already abandoned by his soul and

decomposed begins to return to its first elements of which it was created, where each element is then returned to the land of its origin. But what happened to the body in case of death? Someone dies and we see that nothing has changed in him, he is the same as was before he has died. On the other hand, everything has changed to him. And what was left of him since aparencial aspect has not changed at all, but on the other hand everything has changed? That thing we know as spirit has gone away. It was the spirit that had unified existence and its physical structure. Was the spirit the one that deterred the decay and disintegration of his body, but also helped his recovery from sickness. It was the spirit the one which had given senses and abilities to him.

Personalities

11. Hafiz Bajram ef. Agani, initiator and designer of the Kosovo Islamic Community reorganization after World War II (1947-1951)

Ramadan Shkodra

Kosovo Islamic Community

Abstrakt

After the end of World War II, Kosovo once again was unfairly separated from its motherland, Albania, and was violently inserted under the administration of the artificial and fictional stucture called Yugoslavia. Due to this act, the Association of Islamic Religion in Kosovo necessarily changed its center from Tirana to Sarajevo, and from 1945 to 1990, it would act as the Association of Islamic Religion of Serbia, namely for Kosovo, Serbia and Vojvodina, with ts headquarters in Prishtina, but operating within the jurisdiction of Islamic community of the Yugoslav federation, based in Sarajevo.

In these circumstances created after the Second World War in Kosovo and other Albanian territories in former Yugoslavia, a determinant contribution in the organization, functioning, structurization and the direction of the Islamic Community was given by the time generation of Albanian ulama-s, among whom the remarkable visionary Hafiz Bajram ef. Agani, on whose shoulders the main burden would fall, because he was appointed to guide this institution and its structures.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtreron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.